


IX 9Marks SI TË NDËRTOJMË KISHA TË SHËNDETSHME

UNGJILLËZIMI

SI FLET
E GJITHË
KISHA
PËR
JEZUSIN

J. MACK STILES

Parathënia nga David Platt



“Kushdo që e njeh Mack Stiles-in, e di se ai e ka të vështirë të jetë i mërzitshëm, edhe nëse do të provonte. Libri që mbani në duar, i nxit të krishterët dhe sidomos pastorët që të digjen nga dëshira për ta parë ungjillëzimin të bëhet pjesë e kulturës së kishave të tyre vendore, që ai të kthehet në një përbërës vendimtar të ADN-së së tyre frymërore. Ky libër është i pasur me rrjedhoja praktike, jo pavarësisht nga përqendrimi i tij i vazhdueshëm te Jezusi dhe ungjilli, por pikërisht për shkak të një përqendrimi të tillë. Ky libër meriton që ta lexojmë, të meditojmë për të dhe ta zbatojmë.”

D. A. Carson, profesor i hulumtimit të Besëlidhjes së Re, Trinity Evangelical Divinity School

“Libri më i mirë mbi ungjillëzimin do të ishte një libër që shkon drejt e në zemër të çështjes dhe që është shkruar nga dikush që është vetë ungjilltar. E thënë ndryshe, ky është ai libër. Mack Stiles-i është një nga ungjilltarët më të natyrshëm, më të efektshëm, më të vendosur dhe më të palodhur që njoh. Do të doja të dija mendimin e tij për ungjillëzimin, pavarësisht nëse kjo bëhet në një bisedë, në një letër ose në një libër të tërë. Në këtë vëllim të shkurtër, Mack-u bën një eksplorim të qartë dhe biblik për mënyrën se si bashkësia e kishës e shumëfishon ungjillëzimin personal. Çdo lexues do të frymëzohet, do të inkurajohet dhe do të pajiset për të qenë një ungjilltar i bashkësisë. Për hir të kishës, ungjillit dhe botës, ky libër meriton të jetë në krye të listës suaj të leximit.”

R. Albert Mohler, Jr., president dhe profesor i teologjisë së krishterë në katedrën “Joseph Emerson Brown”, The Southern Baptist Theological Seminary

“Perëndia i ka dhënë Mack Stiles-it dhuntinë e ungjilltarit, dhe ky libër është shprehja e asaj dhuntie. Të pakta janë veprat që njoh, të cilat ndërthurin përpikërinë teologjike, urtësinë pastorale dhe përjetimin personal me të cilat Mack-u e ka mbushur këtë libër. Në disa vende u inkurajova, në vende të tjera u sfidova. U kënaqa duke e lexuar këtë libër dhe e rekomandoj me gjithë zemër.”

J. D. Greear, pastor kryesor, The Summit Church, Durham, North Carolina; autor, *Stop Asking Jesus into Your Heart: How to Know for Sure You Are Saved*

“Mack Stiles-i shkruan për kultivimin e një kulture ungjillëzimi në një mënyrë që i jep lexuesit mundësi për ta parë atë! Në këtë libër jo vetëm që lexojmë të vërtetën, por, gjithashtu, zhytemi në një vizion për mënyrën se si familjet e kishave tona mund të jetojnë në një mënyrë të begatë dhe dinamike. Ky mund të jetë libri më i shkurtër, e megjithatë, më i rëndësishmi që mund të lexoni ndonjëherë për jetën e kishës dhe përhapjen e ungjillit.”

Thabiti M. Anyabwile, pastor kryesor, First Baptist Church of Grand Cayman; autor, *What Is a Healthy Church Member?*

“Misioni i lashtë i kishës për të bërë dishepuj nga të gjitha kombet është ende përparësia jonë edhe sot. Nuk ka dyshim që nevoja jonë për t’u pajisur që ta shpallim besimin tonë është urgjente. Ky është një libër për njerëz realë që mësojnë ta shpallin lajmin e mirë për një Mesia real. Udhëzues, inkurajues dhe bindës — nuk do të donit të prisnit për t’i zbatuar mësimet që do të merrni në faqet e këtij libri. Nëse ekziston dikush që e di se si t’i pajisë njerëzit për të folur për Jezusin, ky është Mack Stiles-i!”

Gloria Furman, bashkëshorte pastori, Redeemer Church of Dubai; nënë e katër fëmijëve; autore, *Glimpses of Grace* dhe *Treasuring Christ When Your Hands Are Full*

“Jam vërtet i ngazëlluar për këtë libër. Librat e Mack Stiles-it për ungjillëzimin janë të shkëlqyer, pasi ata ndërthurin ndihmën praktike me pjekurinë teologjike. Ai, në fakt, e praktikon vetë atë që na mëson.”

Kevin DeYoung, pastor kryesor, University Reformed Church, East Lansing, Michigan

“Mack Stiles-i ka shkruar një libër të shkëlqyer jo vetëm për shpalljen e ungjillit (edhe pse flet për këtë gjë) ose për të qenët një ungjilltar personal (edhe pse e trajton edhe këtë). Ai ka shkruar një libër për mënyrën se si kisha vendore, në fakt, na ndihmon që ta shpallim ungjillin — se si e lehtëson barrën, udhëzon, ngazëllon dhe nxit bashkëpunim. Lexoje këtë libër të shkurtër dhe inkurajohu!”

Mark Dever, pastor kryesor, Capitol Hill Baptist Church, Washington, D.C.; president, 9Marks

“E lexova këtë libër tërheqës brenda një dite, pasi u rrëmbeva nga përmbajtja dhe fryma e tij. Libri *Ungjillëzimi* shërben si një abetare për mënyrën se si Bibla e trajton temën thelbësore të shpalljes së ungjillit. Pres që ky libër të pranohet gjerësisht dhe me entuziazëm.”

Daniel L. Akin, president, Southeastern Baptist Theological Seminary

“Më pëlqen shumë vizioni i Mack Stiles-it për një ‘kulturë ungjillëzimi’ që i përshkon kishat tona. Punoftë Perëndia fuqishëm për ta kthyer këtë vizion në realitet! Ky libër të inkurajon dhe të sfidon, dhe ashtu si librat e tjerë të Mack-ut, edhe ky është një dhuratë dhe bekim shumë i madh për popullin e Perëndisë.”

Randy Newman, profesor i ftuar, C. S. Lewis Institute; autor, *Questioning Evangelism*, *Corner Conversations* dhe *Bringing the Gospel Home*

“Në shumë libra diskutohet për ungjillëzimin personal. Megjithatë, ky libër përqendrohet në një kulturë të tërë. Jo te metodat dhe programet, por te shpirti i ungjillëzimit. Shpërndajeni këtë libër në kishën tuaj dhe shihni se çfarë do të ndodhë.”

John Folmar, pastor kryesor, The United Church of Dubai

“Ndryshe nga çdo libër tjetër, ky është një libër mbi ungjillëzimin që lartëson Krishtin dhe është i zhytur në ungjill. Në vend që t’ju japë një metodologji personale, ky libër ju motivon që, si bashkësi kisha, të shpallni lajmin revolucionar të Jezusit dhe të jepni frytin e tij në jetën tuaj. Ajo që e bën edhe më të vlefshëm, është se e kam parë Mack Stiles-in ta modelojë në disa kontinente kulturën e qëndrimit për të cilën ai shkruan për lavdinë e Perëndisë. Ai është pa diskutim ungjilltari më i talentuar që kam parë të përdorë Perëndia (deri më tani). *Ungjillëzimi* duhet të lexohet nga çdo pastor dhe anëtar kisha.”

Richard Chin, drejtor kombëtar, Australian Fellowship of Evangelical Students; South Pacific Regional Secretary, International Fellowship of Evangelical Students

“Nuk u desh shumë kohë që ky libër të bëhej i preferuari im mbi temën e ungjillëzimit — pjesë e arsyes ishte fakti që nuk mund ta lija dot mënjane! Ungjilli është shumë i qartë dhe ndihma që më dha është shumë e prekshme. Megjithatë, lexuesi duhet ta llogaritë vetë çmimin. Ky libër mund të trazojë

brenda jush diçka së cilës nuk mund t'i shpëtoni dot. Nuk do të kënaqem më kurrë me ndonjë gjë më pak se kultivimi i një kulture ungjillëzimi në kishën ku jam pastor. E lavdëroj Perëndinë për atë që më dha përmes këtij libri dhe lutem për më tepër.”

Jason C. Meyer, pastor i predikimit dhe vizionit, Bethlehem Baptist Church

“Përfytyroni një kishë vendore ku çdo anëtar e njeh ungjillin dhe ecën në një hap me të, ku të gjithë interesohen për njerëzit që nuk besojnë, ku është diçka e natyrshme si për udhëheqësit, ashtu edhe për anëtarët, që të flasin për mundësitë ungjillëzuese, dhe ku anëtarët i ftojnë rregullisht jobesimtarët që ta lexojnë Biblën bashkë, të marrin pjesë në studimet e Biblës në grupe të vogla ose në takimet e së dielës. Nëse kjo gjë ju tingëllon inkurajuese, atëherë do të doni ta lexoni këtë libër dhe ta lejoni Mack-un t’ju udhëzojë hap pas hapi drejt një kulture ungjillëzimi në të cilën ungjillëzimi është thjesht rezultat i natyrshëm i jetës së ungjillit.”

Juan R. Sanchez, Jr., pastor, High Pointe Baptist Church, Austin, Texas

SI TË NDËRTOJMË
KISHA TË SHËNDETSHME

UNGJILLËZIMI



SI FLET
E GJITHË
KISHA
PËR
JEZUSIN

J. MACK STILES

Parathënia nga David Platt

Titulli në origjinal:

Evangelism: How the Whole Church Speaks of Jesus

Copyright © 2014 by J. Mack Stiles

Published by Crossway

a publishing ministry of Good News Publishers

Wheaton, Illinois 60187, U.S.A.

This edition published by arrangement
with Crossway.

All rights reserved.

Për më shumë materiale të tjera nga qendra "IGNIS",
vizitoni faqen www.dritez.al

Përktheu: Asim Hamza

Redaktoi: Rudina Boçe-Le Clus

Arti grafik i kopertinës: Dual Identity Inc.

Imazhet e kopertinës: Wayne Brezinka për brezinkadesign.com

Përshtatja e faqesjes në gjuhën shqipe: IGNIS

Citimet biblike nga Besëlidhja e Re, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla PRO, 2025. Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Citimet biblike nga Besëlidhja e Vjetër, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS, 2009. Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

9Marks ISBN: 979-8-89218-233-1

Dedikuar fëmijëve të mi:
Tristan-it, David-it, Isaac-ut dhe Stephanie-së
Psalmi 127:3–5

9Marks: Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme

Redaktuar nga Mark Dever dhe Jonathan Leeman

Expositional Preaching: How We Speak God's Word Today,
David Helm

Sound Doctrine: How a Church Grows in the Love and Holiness of
God, Bobby Jamieson

Ungjilli: Si e portretizon kisha bukurinë e Krishtit, Ray Ortlund

Ungjillëzimi: Si flet e gjithë kisha për Jezusin, J. Mack Stiles

Anëtarësia e kishës: Si e kupton bota se kush e përfaqëson Jezusin,
Jonathan Leeman

Disiplina e kishës: Si e ruan kisha emrin e Jezusit,
Jonathan Leeman

Pleqësia e Kishës: Si ta baritoni grigjën e Perëndisë si Jezusi,
Jeramie Rinne

PËRMBAJTJA

Dy fjalë për serinë	11
Parathënie	13
Hyrje	17
1 Daljet para altarit dhe dritat e lazerit	21
2 Një kulturë ungjillëzimi	43
3 Lidhja e kishës me një kulturë ungjillëzimi	67
4 Ungjilltarë të qëllimshëm në një kulturë ungjillëzimi	85
5 Ta shpallim realisht besimin tonë	109
Shtojcë	127
Shënime	131
Treguesi i shkrimeve	133

DY FJALË PËR SERINË

A besoni se është përgjegjësia juaj të ndihmoni në ndërtimin e një kishe të shëndetshme? Ne besojmë se, nëse jeni të krishterë, është edhe përgjegjësia juaj.

Jezusi ju urdhëron të bëni dishepuj (Mateu 28:18-20). Juda thotë se duhet ta ndërtoni veten mbi besimin tuaj (Juda 20-21). Pjetri ju bën thirrje t'i vini në shërbim të të tjerëve dhuntitë tuaja (I e Pjetrit 4:10). Pali ju thotë të shpallni të vërtetën me dashuri, në mënyrë që kisha juaj të rritet në çdo gjë (Efesianëve 4:13, 15). A e dalloni se ku po e marrim këtë ide?

Pavarësisht nëse jeni anëtar ose udhëheqës i kishës, seria e librave *Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme* synon t'ju ndihmojë të përmbushni këto urdhërime biblike dhe, si rrjedhojë, të luani rolin tuaj në ndërtimin e një kishe të shëndetshme. Një mënyrë tjetër për ta thënë këtë mund të jetë kjo: “Ne shpresojmë që këta libra do t'ju ndihmojnë të rriteni në dashurinë për kishën tuaj, një dashuri e ngjashme me atë të Jezusit për të.”

9Marks ka botuar një libër të shkurtër dhe të lexueshëm për secilën prej atyre që Mark Dever-i i quan *nëntë shenjat e një kishe të shëndetshme*, edhe një tjetër mbi doktrinën e shëndoshë. Kërkoni libra mbi predikimin shtjellues, teologjinë biblike, ungjillin, kthimin në besim, ungjillëzimin, anëtarësinë e kishës, disiplinën e kishës, dishepullimin dhe rritjen, si dhe udhëheqësinë e kishës.

Kishat vendore ekzistojnë për t'ua shfaqur kombeve lavdinë e Perëndisë. Ne e bëjmë këtë duke i ngulitur sytë tek ungjilli i Jezu Krishtit, duke i besuar atij për shpëtim dhe mandej duke e dashur njëri-tjetrin me shenjtërinë, unitetin dhe dashurinë e vetë Perëndisë. Lutemi që libri që po mbani në duar t'ju ndihmojë.

Me shpresë,
Mark Dever dhe Jonathan Leeman
Redaktorët e serisë

PARATHËNIE

Më kujtohet hera e parë kur e takova Mack Stiles-in. Ishim që të dy folës në një konferencë në Shtetet e Bashkuara dhe ndërkohë që unë dhe folësit e tjerë e kalonim pjesën më të madhe të kohës duke folur me njëri-tjetrin, Mack-u zor se dukej mes nesh. Vrisja mendjen pse, derisa zbulova që Mack-u e kalonte pjesën më të madhe të kohës së tij duke folur për Jezusin me njerëzit që punonin pas skene, në mjediset ku mbahej konferenca. Nga ai ndërveprim i parë me këtë vëlla, e dija që kisha shumë për të mësuar prej tij.

Nuk kaloj shumë kohë dhe unë pata privilegjin të shkoja jashtë Shteteve të Bashkuara, në qytetin ku Mack-u udhëheq një shërbesë me studentët e universitetit dhe shërben si një nga pleqtë e një kishe. Një mëngjes po predikoj në kishë dhe pasi mbarova, Mack-u nisi të më prezantonte me lloj-lloj njerëzish. Ja një përshkrim i përgjithshëm për mënyrën se si shkuan ato biseda (edhe pse emrat i kam ndryshuar).

“Përshëndetje, mua më quajnë Abdul”, më tha njëri nga burrat. “U rrita si mysliman, por, dy vjet më parë, Perëndia më shpëtoi me hirin e tij nga mëkatet e mia dhe nga vetvetja përmes Krishtit.”

“E mrekullueshme”, iu përgjigja unë. “Si dëgjove për ungjillin?”

“Përmes miqësisë sime me Mack-un”, tha Abdul. “Një ditë

ai më pyeti nëse doja ta lexoja bashkë me të Ungjillin sipas Markut. I thashë se isha i gatshëm dhe, brenda disa muajve, Fryma e Shenjtë ma hapi zemrën për të besuar.”

Pastaj u ktheva nga një burrë tjetër, i cili u prezantua vetë. “Hej, unë jam Rajesh-i. Kam qenë hindu gjithë jetën time, derisa dikush më ftoi në këtë kishë. Nuk e kisha fare idenë në lidhje me krishterimin derisa erdha këtu, por Mack-u dhe të tjerët filluan të takoheshin me mua dhe më treguan se kush është Krishti dhe çfarë ka bërë ai. U mahnita dhe, pasi diskutova lloj-lloj pyetjesh me Mack-un, i besova Krishtit për shpëtimin tim.”

Pas Abdul-it dhe Rajesh-it ishte Matthew. Ky i fundit më tha: “Unë u rrita si i krishterë sa për emër, pa pasur një marrëdhënie me Krishtin, por, vitin e kaluar, Perëndia m’i hapi sytë për të kuptuar se çfarë është besimi i vërtetë në Krishtin. U pendova për mëkatet e mia dhe i besova atij.”

“Lërmë të hamendësoj”, i thashë. “Të udhëhoqi Mack-u te Krishti, apo jo?” “Jo”, tha Matthew. “Abdul-i dhe Rajesh-i. Ata kaluan orë të tëra me mua duke lexuar Shkrimet, duke më treguar se çfarë do të thotë ta ndjekësh Krishtin.” Pastaj Matthew më pyeti: “A mund të të prezantoj me Stephen-in? Ai është një miku im që po e shqyrton krishterimin tani, dhe erdhi me mua në takimin e kishës këtë mëngjes.”

Këto biseda vazhduan kështu njëra pas tjetrës edhe me persona të tjerë. Isha me të vërtetë i mahnitur nga hiri i Perëndisë, jo vetëm mbi një të krishterë që kishte pasion për ta shpallur ungjillin, por mbi një komunitet të tërë që ishte pasionant për ta shpallur ungjillin. Teksa po shihja përreth, dallova në të gjithë kishën një kulturë ngjitetëse për ungjillëzimin. Kjo është

një kulturë ungjillëzimi që, në fund të fundit, nuk varet nga ngjarjet, projektet, programet dhe profesionistët në shërbesë. Përkundrazi, kjo është një kulturë ungjillëzimi që ndërtohet mbi njerëz të mbushur me fuqinë e Frymës së Perëndisë, të cilët e shpallin ungjillin e hirit të Perëndisë në kontekstin e jetës dhe marrëdhënieve të tyre të përditshme.

Prandaj, nuk mund të mendoj dot për dikë më të përshtatshëm për të shkruar një libër që flet jo vetëm për kultivimin e disiplinës së ungjillëzimit si i krishterë, por edhe për krijimin e një kulture ungjillëzimi në kishë. Kur e lexova këtë libër, nisa t'i nënvizoja fjalitë dhe paragrafët njëri pas tjetrit, ndërkohë që lutesha për mënyrën në të cilën Zoti mund të më përdorë mua për të krijuar një kulturë të tillë ungjillëzimi në kishën ku jam pastor.

Ky është një libër biblik dhe praktik. Është i mirë për anëtarët dhe për udhëheqësit e kishës, dhe mbi të gjitha i jep lavdi Perëndisë. Dashtë Zoti që ta bëjë këtë libër të jetë bekim edhe në jetën dhe kishën tuaj — si dhe në shumë jetë dhe kisha — me qëllim që kisha e tij të mund të shohë edhe më shumë njerëz si Abdul-i, Rajesh-i, Matthew dhe Stephen-i të kthehen në besim në Krishtin këtu dhe përreth botës.

David Platt
Pastor kryesor, Kisha në Brook Hills
Birmingham, Alabama

HYRJE

“Për çfarë bën fjalë libri yt, i dashur?”

Kjo ishte pyetja e zonjës që erdhi të merrte vjehrrën time për lojën e tyre të përjavshme me letra. Teksa po i vendosja patericat në ndenjësen e pasme, po vrisja mendjen se çfarë të thosha. Doja të thosha: “Nuk është thjesht një libër mbi ungjillëzimin, por është një libër që tregon se si të kultivojmë një kulturë ungjillëzimi.” Ajo e ndjeu hezitimin tim, hodhi vështrimin nga vjehrra ime dhe tha: “E po, si e ka titullin, i dashur?”.

Sërish ndalova dhe po shihja drejt qiellit. Vjehrra ime më shpëtoi dhe tha: “Ka të bëjë me ungjillëzimin.” Ajo i tha këto fjalë me tonin e zërit që përdoret me njerëzit dëgjimi i të cilëve nuk është më aq i mirë.

“Oh”, tha shoqja e saj. Dukej që kishte një lloj pikëpyetjeje pas pasthirmës së saj. Mbylla derën e makinës.

“E po, ka të bëjë më tepër me mënyrën se si ta bësh *të gjithë kishën* ta shpallë besimin e vet”, i thashë unë.

Shoqja e vjehrrës dukej edhe më e pështjelluar. “Hëm”, tha ajo. Pastaj u kthye nga vjehrra ime. “E po, Ann-a, e di që je *shumë* krenare për dhëndrin”, teksa më ra mbi sup, pavarësisht se vetë autori dukej sikur nuk po e shprehte dot se për çfarë bënte fjalë libri i tij.

Më lejoni të përpiqem ta paraqes më mirë për ju. Ky libër

ka të bëjë me *ungjillëzimin* biblik. Nuk e di nëse të krishterët nisen me synimin për të shkruar libra mbi ungjillëzimin duke u bazuar mbi parime jobiblike. Mirëpo kjo ndodh. Ndodh sepse ka ide të gabuara në lidhje me përbërësit thelbësorë të ungjillëzimit. Zakonisht idetë e gabuara bazohen mbi parimet e marketingut ose mbi kuptimin njerëzor se si ta sjellim dikë në mbretërinë e Perëndisë përmes argumenteve. Nëse nuk e kemi kuptuar qartë ungjillëzimin biblik, mund të mos jemi duke ungjillëzuar.

Për shembull, një amvisë që takohet me një shoqe për kafe, mund të jetë duke ungjillëzuar, ndërsa një apologjet i shkëlqyer i krishterë që flet para mijëra personave në një sallë kishe mund të mos jetë duke ungjillëzuar. Të paktë janë njerëzit që e shohin kështu, por kjo ndodh për shkak se kemi kuptime të gabuara për atë që është ungjillëzimi. Mbrojtja e besimit është diçka shumë e mirë që duhet bërë, mirëpo është e lehtë të ofrojmë mbrojtje të krishterimit pa e shpjeguar ungjillin — dhe pa ungjillin nuk mund të ungjillëzojmë.

Kemi nevojë që të dimë se për çfarë po flasim kur themi “ungjillëzim”, “kthim në besim” apo madje edhe “ungjill”. Fjalë të tilla sjellin përkufizime të ndryshme në mendjet e njerëzve dhe shpesh ngrenë edhe dyshime. Nëse të krishterët nuk i kuptojnë këto koncepte bazë, shumë shpejt do të dalim nga orbita biblike. Prandaj, ne do të kalojmë ca kohë duke u përleshur me përkufizimet në kapitullin e parë.

Meqë ra fjala, shumë mund të duan të përdorin fjalën *misionale* për atë që unë e quaj një “kulturë ungjillëzimi”. E kuptoj pse mund ta kenë këtë prirje, por unë dëshiroj ta ruaj

fjalën *ungjillëzim*. Kjo është një fjalë e rëndësishme biblike, dhe kjo është fjala që do të përdor në këtë libër.

Ky libër ka të bëjë me ungjillëzimin, por, më shumë se kaq, ai ka të bëjë edhe me kultivimin e një kulture ungjillëzimi. Për këtë gjë flet kapitulli e dytë. Kur them “një kulturë ungjillëzimi”, nuk e kam fjalën për shumë programe për ungjillëzimin. Në fakt, ju mund të habiteni që unë i inkurajoj shumë kisha që t’i ndërpresin programet e tyre ungjillëzuese. Do t’jua them psenë më vonë, por tani mjafton të them që dua të shqyrtoj më se si mund ta përfshijmë përgjegjësinë që ka çdo i krishterë për ta shpallur besimin në jetën e bashkësive të kishave tona, duke i shumëfishuar kështu përpjekjet individuale.

Pjesa më e madhe e problemit tonë me ungjillëzimin është që nuk kemi një pikëpamje mjaft të madhe për kishën. Unë besoj që Perëndia e do botën dhe ka një plan të mrekullueshëm për ungjillëzimin: plani është kisha e tij. Për këtë flitet në kapitullin e tretë.

Përderisa ky libër ka të bëjë me ungjillëzimin dhe me një kulturë ungjillëzimi në jetën e kishës, ai, gjithashtu, përshkruan platformat — të cilat shpesh shpërfillen — që të krishterët duhet t’i ndërtojnë për të pasur përpjekje të shëndetshme ungjillëzuese. Kjo është tema e kapitullit të katërt. Ja disa shembuj:

- Përgatitje e qëllimshme për ungjillëzim;
- Një mënyrë jetese e formuar nga ungjilli;
- Moshamendësimi i ungjillit;
- Ungjillëzimi si një disiplinë frymërore;
- Lutja;
- Udhëheqja ungjillëzuese.

Pastaj, sigurisht që kemi nevojë të eksplorojmë parimet bazë të cilat i japin formë praktikës reale të shpalljes së besimit tonë, gjërave që duhet të bëjmë për të jetuar si ambasadorë të Krishtit në botën reale. Kjo trajtohet në kapitullin e pestë.

Kam miq të mirë të cilët më konsiderojnë si ungjilltar; unë vetë nuk jam dhe aq i sigurt për këtë. Dëshiroj fort që njerëzit ta njohin Jezusin, dhe ndihem sikur jam dikush që po përpiqet të jetë besnik në ungjillëzim. Megjithatë dua që njerëzit ta dinë që me të vërtetë përballem me frikëra se çfarë mendojnë të tjerët për mua kur flas për çështje frymërore. Jam tepër i vetëdijshëm për dështimet dhe kufizimet e mia në ungjillëzim. Kur hedh vështrimin përreth, dalloj shumë të tjerë të cilët janë ungjilltarë edhe më të mirë se unë. Nëse jam ungjilltar, jam një ungjilltar mesatar.

Megjithatë, ka një gjë të cilën, me anë të hirit të Perëndisë, mendoj se e bëj mirë: besoj se Perëndia më ka përdorur për të zhvilluar kultura ungjillëzimi. Me kalimin e viteve, teksa kam ndihmuar për të themeluar shërbesa me studentët ose për të mbjellë kisha, kam dashur të sigurohem që ato komunitete ta kishin ungjillëzimin si pjesë të ADN-së së tyre, ta kishin si shpirtin dhe kulturën e tyre.

Ky është pasioni që më motivon, prandaj dhe jam i ngazëlluar për këtë libër. Kjo është një mënyrë për t'i marrë ato gjëra të cilat i kam grumbulluar me dashuri dhe për t'jua treguar juve.

DALJET PARA ALTARIT DHE DRITAT E LAZERIT

Në vitet 1970, unë isha një radikal i ri fringo për Jezusin. Gjatë muajve të parë në universitet, e udhëhoqa te Jezusi John-in, mikun dhe shokun tim të dhomës. Një të diel, pas jo shumë kohësh, ne vendosëm të shkonim në kishën e madhe baptiste në qendër të Memphis-it.

Unë kisha një paraqitje shumë të veçantë: flokët i mbaja në një model afrikan, xhinse të gjera nga poshtë dhe një xhaketë prej leshi ngjyrë të purpurt. Kishim shkuar në një kishë ku njerëzit visheshin me kostume.

Predikuesi bëri predikimin, të gjitha strofat u kënduan dhe pastaj u bë ftesa. Predikuesi shpalli me seriozitet se do të ishte më mirë që dikush të largohej gjatë predikimit të tij sesa gjatë ftesës, “pjesës më të rëndësishme të takimit”.

U bë ftesa që njerëzit t’ia jepnin jetën e tyre Jezusit. Duart u ngritën. Na falënderuan dhe pastaj na thanë që thjesht të ngriheshim nga vendet ku ishim ulur dhe të dilnim përpara. “Nëse nuk mund të çoheni publikisht për Jezusin në kishë, nuk do të çoheni kurrë për të jashtë këtyre mureve”, tha predikuesi. Logjika më dukej e pakundërshtueshme.

John-i, i cili kishte ulur kryet, por sytë i kishte të hapur (në kundërshtim me udhëzimet), më pëshpëriti: “A mendon se duhet të dal përpara?”.

“E po, s’ka asgjë të keqe”, i pëshpërita unë, “do të vij edhe unë me ty.” John-i doli nga radha e ndenjësve dhe unë e ndoqa.

Dhjetëra të tjerë dolën nga radhët e ndenjësve të tyre dhe shkuan përpara. Pa e ditur ne, shumica prej tyre ishin mikpritës të kishës. Dolëm përpara dhe aty ishim të rrethuar nga radhët gjysmërrethore të ndenjësve. Bashkësia, e cila tani dukej edhe më e madhe në numër nga sa dukej nga ndenjëset tona në fund, ngjante sikur ishte zgjatur përpara dhe ishte e fokusuar te ne, duke buzëqeshur.

Sa hap e mbyll sytë, predikuesi erdhi përkrah meje dhe më tha me një zë të dashur: “Bir, pse ke ardhur këtu sot?”. Ai po e mbante mikrofonin poshtë, ngjitur me këmbën e tij dhe kabllon e gjatë e kaloi pas këmbëve me një të lëvizur të kyçit të dorës.

“E po”, ia ktheva unë, “ky shoku im, John-i, e pranoi Jezusin para disa javësh dhe donte që të çohet për Jezusin.” Pastori i hodhi një vështrim John-it, jeta e të cilit ishte rrëmujë, ama vishej në mënyrë konservative. Miratoi me kokë nga John-i dhe i tha: “E mrekullueshme, bir.” Pastaj duke u kthyer nga unë, ai tha: “Po ti, pse ke dalë përpara?”.

Unë kisha hedhur vështrimin sipër nga ballkoni dhe nga dritat e forta pak a shumë me një shikim të mahnitur në sytë e mi, si ai i një djali fshati që ka ardhur në qytetin e madh. “E po, unë... doja të mbështesja John-in”, belbëzoja unë.

“E kuptoj”, tha ai, duke tundur kokën, dhe krahu i tij tani ishte hedhur mbi supin tim. “Bir, po ti, a je i krishterë?”.

“Jam”, i thashë unë.

“A dëshiron që t’ia ripërkushtosh jetën tënde Jezusit?” Nuk i dalloja hollësitë teologjike të kësaj pyetjeje, prandaj thashë: “E po, sigurisht, kështu mendoj.”

Pastaj predikuesi e afroi mikrofonin te buzët e tij dhe e hodhi vështrimin nga ballkoni edhe ai. E gjeti ku ishte vendosur kamera e televizionit dhe tregoi nga ajo me dorën e hapur. “Dëshiroj t’ju them të gjithëve ju që po na ndiqni në televizor se këta dy djem të rinj kanë ardhur t’ia japin jetën e tyre Jezusit. Ju mund ta bëni këtë gjë në shtëpinë tuaj, tani, aty ku jeni ulur...”

M’u deshën vite për ta kuptuar atë që sapo kishte ndodhur.

ÇFARË ËSHTË UNGJILLËZIMI?

Kur mendoj për atë takim para kaq shumë vitesh, dua të pyes: A ndodhi ungjillëzimi atë mëngjes në atë kishë?

Duhet të kemi kujdes se si përgjigjemi. Shumë njerëz janë bërë të krishterë kur kanë dalë përpara si reagim ndaj një ftese të tillë. Kohët e fundit, në një takim pastorësh në Seminarin Juglindor (Southeastern Seminary), presidenti i tij, Danny Akin, vuri re se pastorët që ishin mbledhur, në fakt, ishin të sofistikuar nga ana kulturore, të arsimuar mirë dhe shumë të përgatitur nga ana teologjike. Asnjëri prej tyre nuk do ta çonte nëpër mend të bënte një ftesë për të dalë përpara altarit si ajo që përjetova unë në Memphis. Por pastaj Akin-i pyeti: “Sa prej jush u kthyen në besim në një kishë që ungjillëzonte në mënyra të cilat tani ju i refuzoni?”. Pothuajse të gjithë pastorët e ngritën dorën.

Ky reagim duhet të na bëjë që të mendojmë me kujdes. Ka shumë vend për përrulësi kur bëhet fjalë për ungjillëzimin.

UNGJILLËZIMI

Kemi nevojë të pranojmë që Perëndia është sovran dhe mund të bëjë si t'i pëlqejë për t'i sjellë njerëzit te vetja e tij. Nuk ka formula të cilat diktojnë se si duhet të punojë Perëndia në ungjillëzim. Edhe pse mund të mos biem dakord me praktikat ungjillëzuese të individëve, shërbesave ose kishave, duhet që gjithashtu të dallojmë se kur njerëzit zhvillojnë përkushtime me zemër të mirë ndaj ungjillëzimit, Perëndia mund të prodhojë fryt të vërtetë.

Unë për vete i pranoj njerëzit që e praktikojnë ungjillëzimin në mënyrën më të mirë që munden, më shumë se ata që e lënë mënjanë ungjillëzimin derisa të kenë arritur praktikën e përsosur. Mbani mend se me sa butësi e udhëzuan Apolin, Priskila dhe Akuili në përpjekjet e tij ungjillëzuese (Veprat e Apostujve 18:26)? Madje Pali u ngazëllua për ungjillëzimin e nxitur nga egoizmi, gjë që i shkaktoi probleme (Filipianëve 1:17-18). Prandaj, kur njerëzit kthehen në besim përmes mjeteve dhe metodave të çuditshme, duhet që, së pari, të marrim zemër që Perëndia mund t'i marrë edhe farat më të vogla të së vërtetës së ungjillit dhe t'i bëjë ato të rriten dhe të sjellin frytin e madh të pajtimit që sjell ungjilli në zemrat e njerëzve.

Më lejon të tregohem i qartë: Nuk mendoj se thirrjet për të dalë përpara altarit janë kategorikisht të gabuara. Megjithatë, kur mendoj në lidhje me përjetimin tim në Memphis, është e lehtë të shohësh se si metodat e atyre kohëve ishin të nxitura më së shumti nga një dëshirë për rezultate të menjëhershme: kishte një theks të fortë mbi një vendim ose te dalja përpara, kishte shumë interesim për audiencën që e ndiqte takimin nga televizori dhe shumë pak interesim për gjendjen reale të shpirtit tim dhe për mëkatin tim.

Shumë njerëz kanë reaguar ndaj ftesave për të dalë përpara altarit gjatë dekadave të fundit. Por pavarësisht atyre që me të vërtetë janë kthyer në besim kur kanë reaguar, ka pasur shumë herë më tepër njerëz që thjesht kanë dalë përpara një salle kishe me një shtysë tjetër — ashtu siç ndodhi me John-in dhe mua. Më e rëndësishmja është që edhe pse njerëzit erdhën te Jezusi përmes mjeteve të ndryshme, Bibla nuk i përdor *kurrë* rezultatet për të drejtuar ose për të justifikuar praktikën ungjillëzuese.

Prandaj, kur nisemi për të praktikuar ungjillëzimin, ne duhet të fillojmë me themelet biblike. Duhet t'i lejojmë këto parime që t'i japin formë, ta ruajnë dhe ta përcaktojnë mënyrën se si e shpallim besimin, në vend që të fillojmë duke kërkuar një mënyrë për të fituar ndikim maksimal. Duhet të tregohemi tepër të kujdesshëm që t'i përshtatim praktikat tona ungjillëzuese me Biblën, pasi kjo e nderon Perëndinë.

Fatkeqësisht, ajo që i përcakton shpesh praktikat tona ungjillëzuese është bota — ndoshta bota e biznesit ose kategoria e librave që na mësojnë se si ta ndihmojmë veten — në vend që të përcaktohen nga Shkrimet. Satani e shfrytëzon dëshirën tonë për rezultate duke na ofruar një shërbesë më të madhe në televizor ose përfitime financiare. Ai madje na tundon me dëshira që duken si me zemër të mirë, të tilla si puna e zgjerimit të anëtarësisë ose besimi i pavdekshëm që, nëse një fëmijë e ka bërë lutjen e mëkatarit, ai ose ajo është bërë një besimtar i përkushtuar pavarësisht se si jeton. Në të gjitha këto gjëra, njerëzit i këmbëjnë parimet biblike me dëshirat e botës, dhe kështu praktikat tona ungjillëzuese shtrembërohen.

Pali mund të gëzohej për ungjillin që po predikohej pa-

varësisht nga motivi, për shkak se e dinte që Perëndia do t'i përmbushte qëllimet e tij përmes Fjalës së tij. Mirëpo Pali, gjithashtu, i korrigjon praktikën e shtrembra ungjillëzuese: ai theksoi që nuk duhet të manipulohet, të ndryshohet mesazhin ose të mashtrohet (p.sh., II Korintasve 4:1-2). Përkundrazi, ne duhet të përpiqemi të kemi motive të pastra në dashurinë për njerëzit dhe Krishtin, duke treguar një përkushtim të thellë ndaj së vërtetës (II Korintasve 5:11-15). Ne duhet të besojmë që Zoti do t'i shtojë bashkësisë sonë njerëzit që shpëtohen (Veprat e Apostujve 2:47).

Mendoni pak se sa gjëra ishin duke shkuar shumë afër gabimit në atë takim kishe në Memphis:

- A besonte me të vërtetë pastori se pjesa më e rëndësishme e takimit ishte ftesa dhe jo Fjala e Perëndisë e predikuar siç duhet?
- Ku i shohim njerëzit në Bibël të ngrenë duart për t'i kërkuar Jezusit të hyjë në zemrat e tyre? Kur u zëvendësua pagëzimi si shenja e shpalljes publike të besimit me daljen përpara kishës — madje në një kishë *baptiste*? Ky është kulmi.
- A nuk ishte një gjest manipulues fakti që mikpritësit dolën nga vendet e tyre si një reagim në dukje ndaj ftesës? A nuk dështoi pastori për ta shpallur qartë të vërtetën biblike (II Korintasve 4:2) duke përdorur terma jobiblikë si “t’ia ripërkushtosh jetën tënde Jezusit”?
- A kishte për qëllim pastori që të gënjente publikisht kur tha se John-i dhe unë sapo ia dhamë jetët tona Jezusit, edhe pse ne nuk e kishim bërë këtë? Apo mos ishte aq i verbuar nga lentet kulturore, sa që nuk i njohu dy vëllezër në Krishtin, të cilët qëndronin përpara tij? Mos vallë ishim ne thjesht njëfarë kontrasti për t'i treguar botës efektshmërinë e përpjekjeve të tij ungjillëzuese?

Në fakt, dy djemtë që po qëndronin përpara tij ishin gjëja më e madhe të cilën ai nuk e vuri re, dhe kjo mungesë vëmendjeje më bën që të dua të hidhem përpjetë dhe të ulërij. Atij i shpëtoi një shembull i gjallë i llojit më të mirë të ungjillëzimit: një djalosh tetëmbëdhjetëvjeçar, i cili nuk e gjente dot Librin e Markut në Bibël pa parë përmbajtjen, sapo e kishte udhëhequr shokun e tij te Jezusi, thjesht duke e dashur aq sa t'i shpjegonte atë që dinte vetë për mesazhin e ungjillit. Mendoj se bashkësia ishte aq e verbuar nga shfaqja e një programi të hollësishëm dhe nga audienca e televizionit, sa që as ata nuk menduan për këtë gjë.

NJË PËRKUFIZIM PËR UNGJILLËZIMIN

Prandaj, si ta kuptojmë se kur po ndodh ungjillëzimi? E po, përgjigjja varet nga mënyra se si e përkufizojmë ungjillëzimin. Përkufizimi i ungjillëzimit në një mënyrë biblike na ndihmon që ta përshtatim praktikën tonë ungjillëzuese me Shkrimet. Ja një përkufizim i cili më ka shërbyer mjaft mirë për shumë vjet:

Ungjillëzimi është dhënia mësim e ungjillit me synimin për ta bindur dikë.

Shkurt, apo jo? Them se shumica e njerëzve do të prisnin shumë më tepër nga një fjalë kaq e rëndësishme teologjike. Megjithatë, ky përkufizim, pavarësisht se është i shkurtër, na ofron një peshore shumë më të mirë, në të cilën të vlerësojmë praktikën tonë ungjillëzuese, sesa thjesht duke parë se sa njerëz kanë reaguar ndaj një thirrjeje.

Pak a shumë në të njëjtën kohë që John-i dhe unë shkuam

UNGJILLËZIMI

në atë kishë në Memphis, i bleva atij një Bibël. Ky ishte versioni *Amplified* i Biblës (*Amplified Bible*), i cili, nëse nuk e keni parë, ofron shumë sinonime për fjalët kyç. Ja se si mund ta kishte zgjeruar përkufizimin tim versioni *Amplified* i Biblës:

Ungjillëzimi është dhënia mësim (lajmërimi, shpallja, predikimi) i ungjillit (lajmit nga Perëndia që na çon në shpëtim) me synimin (shpresën, dëshirën, qëllimin) për ta bindur (për t'ia mbushur mendjen, për ta kthyer në besim) dikë.

Vini re se përkufizimi nuk kërkon një reagim të menjëherëshëm dhe të jashtëm. Dalja përpara kishës, ngritja e duarve ose bërja e një lutjeje mund të na thonë se ungjillëzimi ka ndodhur, por veprime të tilla në vetvete nuk janë ungjillëzim. Gjithashtu, vini re se, po të mungojë cilido nga të katër përbërësit, ka të ngjarë që po bëjmë diçka të ndryshme nga ungjillëzimi.

Nëse do të mundesha, do të doja të kthehesha në kohë dhe t'i mësoja asaj kishe në Memphis se çfarë është me të vërtetë ungjillëzimi. Do të jepja paralajmërimin se ka shumë sëmundje në kishën në mbarë botën, për shkak të kishave që e quajnë ungjillëzim një gjë të caktuar kur nuk është. Do t'ju përgjerohesha duke thënë: "Ju lutem, kur jepni mësim, mos u mësoni njerëzve se si të sillen kur bëhet një ftesë. Jepni mësim qartë se çfarë është ungjilli dhe se çfarë kërkohet që dikush të kthehet te Krishti."

Do ta nxisja kishën që të synojë t'i bindë njerëzit pa përdorur manipulimin. Do t'i inkurajoja që të mos e lënë mënjane atë që është e vështirë në jetën e krishterë, pavarësisht se sa i fortë mund të jetë tundimi; të mos e ngatërrojnë reagimin

njerëzor me një veprimtari të Frymës; dhe të mos gënjejnë për rezultatet. Do të thosha gjithashtu: “Ju lutem, kini kujdes që të mos i quani njerëzit të krishterë pa ndonjë provë që ata me të vërtetë janë ndjekës të Krishtit që janë kthyer në besim.”

Sigurisht, sipas standardeve të kohës së sotme, është e lehtë që t’i përçmosh ato praktika të vjetra të kishës. Mirëpo, nëse tregohemi të sinqertë, na duhet të themi se përballemi me të njëjtin tundim për t’i sakrifikuar parimet biblike për hir të rezultateve dhe “suksesit”. Teksa hedh vështrimin përreth, nuk shoh që të kenë ndryshuar shumë gjëra, përveç formës në të cilën e praktikojmë ungjillëzimin jobiblik. Shpesh ungjilli nuk jepet mësim, dhe fjalët jobiblike e hollojnë kuptimin e vërtetë dhe të mprehtë të mëkatit, vdekjes dhe ferrit, ose i ngatërrojnë ata që po e kërkojnë sinqerisht të vërtetën.

Premtimet e shëndetit dhe pasurisë i mashtrojnë më të cenueshmit: të varfrit, të paprivilegjuarit dhe të sëmurët. Shumë kisha ofrojnë një “ungjill” që nuk na kushton, të rehatshëm dhe që sjell përfitim, i cili, në fakt, nuk gjendet askund në Shkrime. Në fakt, ungjilli minohet nga ata që Pali i quan “[ungjij të] ndryshëm”, të cilët nuk janë fare ungjill (Galatasve 1:6-7). Duke reaguar ndaj dëshirave të njerëzve, kishat komunikojnë që fokusi i tyre është te jobesimtarët dhe jo te lavdia e Perëndisë, e cila shfaqet nga njerëzit e tij që e adhurojnë.

Refrenet e larta të koreve janë zëvendësuar nga shfaqjet me drita lazer, dhe kështu takimi i kishës kthehet në një mjet për argëtim në vend të adhurimit. Jezusi përfshihej me njerëzit, por ai kurrë nuk argëtoi; ka një dallim shumë të madh, dallim që ka humbur në kishën moderne. Po kështu të bërët thirrje për miq, ndjekës dhe të kthyer në besim përmes medias sociale

UNGJILLËZIMI

ngjan shumë me kamerat e televizionit në vitet e shkuara në ballkonet e kishave: të dyja mund t'i tundojnë udhëheqësit e kishës për të mos i vënë re njerëzit që janë përpara tyre. Puna me trysni e një shitësi është zëvendësuar me ndjelljen e butë për të ndihmuar veten.

Gjëra të tilla janë rezultati i të njëjtave tundime të botës që e minojnë ungjillëzimin biblik, aq sa atyre që i përçmojnë praktikatat e vjetra mund t'u duhet t'i kërkojnë falje asaj kishe në Memphis.

Megjithatë ka një përgjigje për tundime të tilla. Përgjigjja është e njëjtë sot, ashtu si atëherë kur unë isha në vitin e parë të universitetit ose në kishat e shekullit të parë në kohën e Palit. Zgjidhja është që ta ngulitim në mendjen dhe zemrën tonë ungjillëzimin me ungjillin në qendër dhe sipas parimeve biblike. Zgjidhja është që të mësojmë se si ta japim mësim ungjillin me integritet dhe ta ruajnë para syve tanë synimin e tablosë së madhe të kthimit të vërtetë në besim.

Prandaj, le t'i "theksojmë" me kujdes katër pjesët e përku-fizimit tim: "dhënia mësim", "ungjilli", "synimi" dhe "bindja".

DHËNIA MËSIM

Së pari, nuk ka ungjillëzim pa fjalë. Në fund të fundit, Jezusi është Fjala, dhe Fjala ishte me Perëndinë (Gjoni 1:1).

Përdorimi më i rëndësishëm i fjalëve në ungjillëzim është duke dhënë mësim. Nëse mendoni për këtë gjë, kjo, në fakt, ka kuptim. Ne njerëzit nuk jemi në gjendje të gjejmë një udhë shpëtimi për veten tonë. Prandaj, shpëtimi duhet të na zbulo-het nga Perëndia përmes fjalëve të tij.

Mësimdhënia është gjithashtu modeli i Biblës. Bibla është

një libër mësimdhënieje. Nga Zanafilla te Zbulesa, Bibla na mëson. Bibla na thotë që t'i japim mësim njëri-tjetrit: fëmijëve tanë, fqinjëve tanë, si dhe të huajve që janë mes nesh. Gratë e moshuara duhet t'i udhëzojnë të rejtat. Kriteri i vetëm për pleqtë, përveçse të jenë ndjekës të kujdesshëm të Jezusit, është që ata të jenë në gjendje të japin mësim.

Ndoshta për shkak se mësimi është kudo në Shkrime, mund të na shpëtojë rëndësia e tij. Jezusi e pa që turmat ishin si dele pa bari, prandaj ushqeui mijëra vetë me pesë bukë dhe dy peshq (Marku 6:34-44; Luka 9:10-17). Këto mrekulli na mahnitin, sikurse edhe duhet të ndodhë. Megjithatë, gjëja interesante është që, në secilin rast, veprimi i *parë* i dhembshurisë së Jezusit ishte që t'u jepte mësim.

Shumë nga ne mendojnë për predikimin kur mendojnë për ungjillëzimin, sikurse edhe duhet të mendojnë. Unë për vete dëshiroj që çdo predikim që bëj të përmbajë ungjillin. Sigurisht që Pali bëri pjesën e tij në predikimin ungjillëzues. Mirëpo shpesh kur Pali e përshkruan shërbesën e tij, ai thotë se ajo është një shërbesë mësimdhënieje (I Timoteut 2:7; II Timoteut 1:11). J. I. Packer-i, në hetimin që i bën praktikës ungjillëzuese të Palit, thotë se metoda e ungjillëzimit të Palit ishte së pari një metodë mësimdhënieje.¹

Ky është lajm i mirë për ne që nuk na jepet mundësia për të predikuar çdo të diel. Nuk mund të jemi të gjithë predikues, megjithatë, ne të gjithë mund të japim mësim ungjillin kur na jepet mundësia. Shpesh vras mendjen nëse shumica e njerëzve janë kthyer në besim gjatë një vakti dreke, kur dikush tha: "Çfarë mendove për predikimin e sotëm?", sesa gjatë vetë

UNGJILLËZIMI

predikimit. Gjëra të mëdha ndodhin kur ne japim mësim ungjillin.

Të jesh në gjendje të japësh mësim ungjillin është gjë e dobishme për jetën tonë frymërore, pasi na siguron se po jetojmë sipas temave të ungjillit. Një nga gjërat e para që duhet të bëjmë në tryezën e Darkës së Zotit është që të kontrollojmë nëse jetët tona janë të përputhura me ungjillin. Pyete veten: A po jetoj një jetë besimi në veprën e Krishtit? A po e zbatoj hirin e ungjillit ndaj njerëzve përreth meje? A po u jap falje sakrifikuese atyre që më bëjnë keq?

Nëse nuk di se si ta japësh mësim ungjillin, ka të ngjarë që të mos jesh duke e kuptuar atë me të vërtetë. Dhe nëse nuk e kupton, mund të mos jesh i krishterë i vërtetë. Njoh shumë njerëz që mendonin se ishin besimtarë, por kur filluan ta studionin ungjillin për ta dhënë atë mësim, kuptuan se nuk ishin penduar kurrë për mëkatën dhe nuk e kishin vendosur besimin e tyre në Jezusin.

Mirëpo gjëja më e rëndësishme është që të mbani mend se ungjilli duhet të jepet mësim përpara se dikush të bëhet i krishterë.

Kur i kam udhëhequr njerëzit të Krishti gjatë viteve, zakonisht ka qenë për shkak se një jobesimtar ishte i gatshëm për t'i studiuar Shkrimet bashkë me mua. Ndoshta ishte një grup studentësh që po lexonte Ungjillin sipas Markut në një kamp ose konferencë. Mund të kenë qenë dy persona në një kafene ose thjesht një person gjatë pushimit të drekës. Pavarësisht nga vendi apo se me kë jeni, procesi është i thjeshtë: ne lexojmë pasazhin dhe diskutojmë se çfarë kuptimi ka ai. Me kalimin e kohës, tek e tek ose në dyshe, njerëzit kthehen të Jezusi ngaqë

u është mësuar ungjilli. Një mësim i tillë mund të mos jetë aq ngazëllues sa një rizgjim i madh, por nëse çdo i krishterë do ta bënte këtë me miqtë jobesimtarë, kjo do të kishte një ndikim dhe vërtetësi shumë herë më të madhe.

UNGJILLI

Ne nuk japim mësim matematikë ose biologji. Ne japim mësim ungjillin. Është e rëndësishme që ta japim mirë mësim ungjillin, pasi ka shumë pështjellim në lidhje me të përreth botës.

Ekzistojnë dy gabime që mund të bëjmë në lidhje me ungjillin. Ne mund ta bëjmë ungjillin tepër të vogël ose tepër të madh. Të dyja gabimet varen nga diçka shumë e vogël: ato varen nga keqkuptimet në lidhje me rrjedhojat e ungjillit. Këto rrjedhoja dalin nga besimi ynë në mesazhin e ungjillit.

Një ungjill i tkurrur

Ne e bëjmë ungjillin tepër të vogël duke menduar se ai thjesht “na shpëton”, që ai është pak a shumë një lloj siguracioni në rast zjarri, pa kuptuar se ungjilli ka rrjedhoja për të gjithë jetën.

Përderisa ungjilli manifeston zemrën e Perëndisë, ka kuptim që temat e ungjillit duhet t’i japin formë mënyrës se si jetojmë — tema si dashuria, pajtimi, falja, besimi, përlësia, pendimi dhe shumë të tjera. Atëherë shohim se ungjilli bëhet njëkohësisht dera e shpëtimit dhe modeli për jetën tonë.

Tim Keller-i ka shkruar në mënyrë të mrekullueshme për të jetuarin me ungjillin në qendër, se si ungjilli nuk është thjesht ABC-ja e jetës së krishterë — udha e shpëtimit — por është nga A-ja te Zh-ja e jetës së krishterë.² Ungjilli i jep formë

UNGJILLËZIMI

mënyrës se si jetojmë. Në kapitullin e katërt do të flasim më tepër në lidhje me jetën që ka në qendër ungjillin.

Një ungjill i fryrë

Ne e bëjmë ungjillin tepër të madh kur themi se ungjilli është gjithçka. Këtë e bëjmë kur mendojmë se jemi të shpëtuar me anë të besimit *dhe* nga rrjedhojat e ndryshme të ungjillit. Për shembull, një pjesë e madhe e botës së krishterë beson se jemi shpëtuar me anë të besimit dhe veprave të mira. Të tjerët, që ndoshta janë shumica, besojnë se jemi të shpëtuar me anë të besimit dhe ligjit.

Shumë gjëra i janë shtuar ungjillit gjatë historisë. Gjithmonë bëhet i njëjti gabim. Njerëzit shtojnë gjëra të cilat mund të jenë të mira, madje edhe fetare, si puna e të jetuarit të një jete të moralshme, kujdesi për të varfrit apo të parët e sakramenteve të pagëzimit dhe Kungimit si thelbësore për shpëtimin. Të gjitha këto janë pjesë të rëndësishme të jetës së krishterë dhe privilegje për të krishterët. Mirëpo, edhe pse burojnë nga ungjilli, ato nuk mund të na shpëtojnë.

Shtesat që i bëhen ungjillit, pavarësisht se sa të mira apo me qëllim të mirë në zemër, e prishin ungjillin.

Një përkufizim i mirë i ungjillit

Prandaj, kur flasim për të jetuarit e jetës së krishterë, ne po flasim për të jetuarit e temave dhe rrjedhove të ungjillit. Mirëpo, kur flasim për shpëtimin, ne përqendrohemi te mesazhi i ungjillit. Kur e shpallim besimin tonë, ne përqendrohemi në atë *mesazh* që të çon në shpëtim. Është e rëndësishme të vëmë re se, kur Bibla përdor fjalën *ungjill*, në Besëlidhjen e

Vjetër³ sikurse edhe në të Renë, gjithmonë e bën këtë në lidhje me shpëtimin.

Ja një përkufizim i mirë për t'u përdorur:

Ungjilli është lajmi i gëzueshëm nga Perëndia që na çon në shpëtim.

Ky është një përkufizim tjetër që duket si tepër i thjeshtë, pasi duhet të pyesim: “Atëherë, cili është mesazhi i shpëtimit?”.

Mesazhi i ungjillit u përgjigjet katër pyetjeve të rëndësishme: Kush është Perëndia? Pse jemi në një rrëmujë kaq të madhe? Çfarë bëri Krishti? Dhe si mund të kthehemi te Perëndia? Në botë nuk ka pyetje më të rëndësishme se këto, dhe përgjigjet janë të përmbledhura në këtë përvijim: Perëndia, Njeriu, Krishti, Reagimi (Shih shtojcën për pasazhet e ndryshme nga Shkrimi i Shenjtë që e mbështesin këtë përvijim):

- Perëndia është Krijuesi ynë. Ai është i dashur, i shenjtë, i drejtë. Një ditë ai do të ushtrojë drejtësinë e tij të përsosur kundër çdo mëkati.
- Njerëzit janë krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë. Ne jemi krijesa të bukura dhe të mahnitshme, me dinjitet dhe vlerë. Mirëpo, përmes rebelimit tonë të vullnetshëm dhe të mëkatshëm kundër Perëndisë, nga fëmijë të tij jemi bërë armiq të tij. Megjithatë, të gjithë njerëzit kanë kapacitetin për të qenë në një marrëdhënie të dashur dhe të ripërtërirë me Perëndinë e gjallë.
- Krishti është Biri i Perëndisë, jeta e pamëkatë e të cilit i dha atij aftësinë për t'u bërë flijimi i përsosur. Përmes vdekjes së tij në kryq, ai i shpengoi njerëzit mëkatarë. Vdekja e Krishtit pagoi për të gjitha mëkatet e atyre që vijnë tek ai me besim.

UNGJILLËZIMI

Ringjallja e Krishtit prej të vdekurish është lartësimi përfundimtar i së vërtetës së këtyre deklaratave.

- Reagimi që kërkon Perëndia nga ne është që ta pranojmë mëkatin tonë të mosbesimit dhe të kthehemi te Perëndia me besim, duke kuptuar që do ta ndjekim atë gjithë ditët e jetës sonë.

Një mënyrë tjetër për ta treguar të njëjtën histori është përmes përvijimit të Krijimit, Rënies, Shpengimit dhe Ripërtëritjes. Ka edhe shumë përmbledhje të tjera të mira të ungjillit. Përvijimi i veçantë që përdorni nuk ka rëndësi, për aq kohë sa jepni mësim mesazhin që njerëzit duhet ta dinë përpara se të pajtohen me Perëndinë.

Shpresa në ungjillëzim është që ta zhytim veten aq thellë në të vërtetën dhe jetën e ungjillit, dhe ta studiojmë aq fort ungjillin, sa që ai nuk ka se si të mos rrezatojë prej nesh.

SYNIMI

Ndërsa e japim mësim ungjillin, ne kemi një synim. *Synimi* është një fjalë e vogël dhe mund të jetë e lehtë që ta shpërfillim teksa e analizojmë përkufizimin e ungjillit. Mirëpo synimi mund të jetë ai që na pengon më shpesh në ungjillëzim, dhe kjo ndodh sidomos me të krishterët më të pjekur.

Synimi ynë buron nga të kuptuarit se kushdo me të cilin flasim, po shkon drejt njërës prej dy vendmbërritjeve: jetës së përjetshme ose dënimit të përjetshëm. Prandaj, nuk është se thjesht i paraqesim faktet e ungjillit nga ana akademike apo pa ndonjë qëllim. Ne kemi një synim ose një qëllim kur japim mësim ungjillin.

Synimi na kujton gjithashtu që njerëzit kanë nevojë për më tepër sesa për një transferim informacioni. Disa njerëz që e mendojnë ungjillëzimin vetëm si mësim, bëjnë një punë të mirë në shpjegimin, sqarimin dhe përgjigjen e pyetjeve, si-kurse duhet të veprojmë të gjithë ne. Të gjithë ne të krishterët duhet të stërvitemi për të menduar për arsyet e shpresës që kemi në Krishtin, arsye që i heqin tej kundërshtimet dhe pyetjet. Megjithatë, ndërsa i paraqesim faktet e ungjillit, të mbajturit mend të synimit të ungjillëzimit na ndihmon për të qenë më të dhembshur, më mirëkuptues, më të dashur (I e Pjetrit 3:15).

Të pasurit e një synimi na ndihmon ta ruajmë këndvështrimin tonë për atë që po bëjmë. Synimi na shtyn drejt një rezultati. Synimi ynë na ndihmon të kujtojmë që kjo është një gjë shumë e rëndësishme: t'i shohim njerëzit të kalojnë nga errësira në dritë, nga skllavëria në liri. Synimi drejt diçkaje më të madhe na ndihmon të dimë se cilat beteja të luftojmë dhe cilat të shmangim.

Isha në një emision radiofonik kur një grua telefonoi dhe tha: “A të shkoj në një pagëzim katolik për djalin e vogël të motrës sime?”. Pastaj ajo shpërtheu në zemërim, madje edhe urrejtje, për faktin që motra e saj mendonte se kjo gjë do ta “shpëtonte” djalin e saj.

Unë e ndërpreva dhe i thashë: “Mendoj se duhet të shkosh, por jo për të mbështetur një kuptim jobiblik për kthimin në besim. Mendoj se duhet të shkosh pasi po synon diçka më të madhe se korrigjimi i keqkuptimit teologjik të motrës sate në lidhje me pagëzimin. Duhet të shkosh dhe të tregohesh mbështetëse, e mbushur me dashuri, pasi ti dëshiron fort që

UNGJILLËZIMI

të kesh një zë për të folur në jetën e motrës sate për mënyrën e vetme se si ajo mund të shpëtohet... si edhe në jetën e nipit tënd, meqë ra fjala.”

Doja që ajo të kishte një synim më të mirë, në mënyrë që të mos i shpëtonte shënjestra e ungjillëzimit.

BINDJA

Në ungjillëzim nuk mjafton të kemi një synim çfarëdo. Synimi ynë është shumë specifik: t'i bindim njerëzit që të kthehen në besim, të bëhen ndjekës të Jezusit.

Pali thotë që ne i bindim të tjerët ta ndjekin Jezusin (II Korintasve 5:11). Fjala *bindim* më duket e dobishme, pasi ajo na ruan nga gabimi: ne bindim, por nuk manipulojmë; ne bindim, por nuk jemi ne ata që sjellin pendim ose kthim në besim. Sigurisht që ne dëshirojmë fort t'i shohim njerëzit të kthehen në besim, pasi e kuptojmë se kjo është e domosdoshme që ata të bëhen të krishterë. Mirëpo kthimi i vërtetë në besim është vepër e Frymës së Shenjtë.

Kthimi në besim, në fakt, është ajo çështje e besimit të krishterë e cila keqkuptohet më shpesh. E tillë ishte edhe kur Jezusi ia mësoi një udhëheqësi fetar të kohës së tij (Gjoni 3). Kthimi në besim është i ngatërruar për të krishterët dhe jobesimtarët edhe sot. Prandaj, është mirë që të kalojmë pak kohë për ta shpjeguar atë.

Në kontekstin mysliman ku jetoj unë, shumë njerëz nga sfonte të tjera besimi shastisen kur unë predikoj dhe them që askush nuk lind i krishterë, që të gjithë të krishterët, në fakt, janë të kthyer në besim. Madje edhe ata që janë nga sfontet e krishtera, janë të ngatërruar në lidhje me kthimin në besim,

pasi shumë prej tyre vijnë nga tradita që theksojnë se dikush është i krishterë për shkak të arsyeve të jashtme. Mirëpo Bibla na mëson qartë se kthimi në besim nuk është rezultat i fesë së prindërve tuaj, i kishës së cilës mund t'i bashkoheni ose i asaj që thuhet në pasaportën tuaj. Nuk bazohet mbi arritjet tuaja akademike, edhe nëse ato janë nga një institucion fetar. Ky kthim vjen nga besimi i vërtetë, i vetëdijshëm dhe real në Jezusin. Kjo, gjithashtu, është pjesë e veprimtarisë së Frymës së Shenjtë.

Shoku im Jeff-i po fliste me kolegun e tij në lidhje me krishterimin gjatë pushimit të drekës. Ndërsa bisedës po i vinte fundi, kolegu i Jeff-it tha me një ton begenisës: “Po, Jeff, do të doja të kisha besimin tënd.”

Jeff-i iu përgjigj: “E po, besimi është një dhuratë. Në fakt, nuk ka të bëjë fare me ty. Perëndia është ai që e jep këtë dhuratë, prandaj do të lutem që të të jepet dhurata e besimit.” Kjo nuk ishte përgjigjja që priste ai burrë, por ishte përgjigjja e saktë. Kthimi në besim është i domosdoshëm, por kjo është rezultat i besimit të vërtetë, i cili jepet nga Fryma e Shenjtë.

Megjithatë, ndoshta gjëja më e rëndësishme që duhet të kuptojmë në lidhje me kthimin në besim është se si duket ai pasi ka ndodhur.

ZJARR NË SINAGOGË:

SI DUKEN ATA QË JANË KTHYER ME TË VËRTETË NË BESIM

Kthimi në besim nuk ka të bëjë thjesht me ndjenjat e mira. Nuk është thjesht një ndryshim i mendjes. Nuk është kthimi i një faqeje të re. Këto gjëra mund të ndodhin, por ato mund të ndodhin për arsye të ndryshme nga kthimi në besim. Kthimi i

vërtetë në besim është unik. Ai lind nga pendimi dhe besimi, dhe fryti i tij është një jetë e ndryshuar.

Kohët e fundit shkova të dëgjoja James McPherson-in, historianin që ka fituar çmimin “Pulitzer”, i cili mbajti një leksion mbi betejat detare gjatë Luftës Civile. Leksioni, i cili sponsorizohej nga shoqëria vendore e historisë, u mbajt në një sinagogë të madhe. Salla ishte mbushur plot e përplot. Kishte një atmosferë të gjallë në ajër teksa po prisnim të dëgjonim nga një profesor i mirënjohur nga Universiteti i Princeton-it.

Ndërsa dr. McPherson-i doli në skenë, ai e mbërtheu edhe audiencën.

Zëri i tij kumbues, humori i tij i hollë dhe zotërimi i jashtëzakonshëm i materialit e magjepsën audiencën. Mirëpo aty nga mesi i leksionit, u dëgjua alarmi i zjarrit. Ky ishte një alarm serioz. Nuk u dëgjua thjesht një tingull i fortë nga alto-parlantët elektronikë; kishte edhe drita sinjalizuese të cilat nisën të ndizeshin e të fikeshin në intervale të çuditshme.

Dr. McPherson-i ngriu në vend. Vështrimi i tij me sytë e zgurdulluar më kujtoi një buf që zgjohet krejt papritur nga dremitja e tij. Ai po kthente kokën sa majtas djathtas, duke mos ditur se çfarë të bënte. Meqë askush nga audienca nuk dukej se e frekuentonte sinagogën, askush nuk e mori në dorë situatën. Ne thjesht po shihnim përreth, po u buzëqeshnim fqinjëve që ishin ulur pranë nesh dhe po vrisnim mendjen se çfarë të bënim. Alarmi vazhdoi të binte aq gjatë, sa na u duk si një përjetësi. Njerëzit e ulur nëpër karrige nisën të flisnin në grupe të vogla teksa prisnin që alarmi të pushonte.

Unë po mendoja me vete: “Ndoshta ka rënë me të vërtetë zjarr.” Megjithatë, shumë shpejt e braktisa këtë ide: alarmet

e rreme janë bërë të zakonshme; mendova se alarmi thjesht duhej të rivendosej. Përveç kësaj, dukej se askush tjetër nuk mendonte se kishte një problem — me përjashtim të një burri që u çua, doli jashtë me qetësi dhe u largua nga ndërtesa. Nuk jam i sigurt nëse e vunë re shumë të tjerë. Shumë shpejt alarmi ndaloi dhe dr. McPherson-i vazhdoi aty ku e kishte lënë.

Nëse kjo është një shëmbëlltysë për kthimin e vërtetë në besim, atëherë në atë sallë kishte vetëm një person që vërtet u kthye në besim, kishte vetëm një besimtar të vërtetë; ne të tjerët ishim robër të arsyesimit tonë. Disa mund të kenë menduar se kishte zjarr, por ata nuk besuan me të vërtetë dhe aq sa të dilnin jashtë. Ne nuk jemi bindur në kuptimin biblik nëse nuk pendohejmë, nuk e vendosim besimin tonë në Jezusin dhe nuk ecim me të.

Kjo është e gjitha: katër pjesët e përkufizimit tim për ungjillëzimin.

ÇFARË NDODH NËSE E KEQKUPTOJMË UNGJILLËZIMIN?

Ungjillëzimi është dhënia mësim e ungjillit (mesazhit nga Perëndia që na çon në shpëtim) me synimin për t'i bindur njerëzit. Nëse një kishë nuk e kupton ungjillëzimin biblik, me kalimin e kohës ajo do të dobësohet. Nëse nuk praktikojmë ungjillëzim të shëndetshëm, efekti do të jetë si ai i dominove që bien njëra pas tjetrës:

- Fokusi i predikimit dhe mësimdhënies kalon te të jetuarit e një jete të moralshme dhe jo te një jetë që ka në qendër ungjillin.

UNGJILLËZIMI

- Jobesimtarët mashtrohen të mendojnë se janë në rregull në gjendjen e tyre të humbur.
- Të krishterët mendojnë se jobesimtarët janë besimtarë, për shkak se kanë marrë një zotim sipërfaqësor dhe të jash-tëm.
- Kisha pagëzon ata që nuk janë besimtarë.
- Kisha i lejon jobesimtarët të bëhen pjesë e anëtarësisë.
- Në fund, jobesimtarët bëhen udhëheqës në kishë.
- Dhe kisha bëhet një nënkulturë nominalizmi.

Ungjillëzimi jobiblik është një metodë vetëvrasjeje e asis-tuar për kishën, prandaj ungjillëzimi duhet kuptuar ashtu si duhet, pasi ka shumë rrezik.

Ungjilltarët janë si këshilltarët e trajnuar të cilëve u kër-kohet të flasin me njerëzit që kërcënojnë se do të vrasin veten. Synimi i tyre është që t'ua mbushin mendjen njerëzve të cilët po mendojnë të vrasin veten, që të largohen nga “buza e gre-minës”. Këshilltarët nuk përdorin forcë dhe nuk gënjejnë. Ata përdorin të vërtetën, shpresën dhe arsyen për të bindur. Ata qëndrojnë të qetë dhe gjakftohtë; përveç kësaj, ata janë dashamirës, pasi e dinë që po rrezikohet një jetë.

Ashtu sikurse ata, edhe ne përdorim shpresën e ungjillit për të arsyetuar. Edhe ne e ruajmë gjakftohtësinë dhe trego-hemi mirëdashës, pasi kujtojmë se sa të rëndësishme janë gjërat për të cilat bëhet fjalë. Synimi ynë është që t'i bindim njerëzit të largohen nga buza e greminës. Ne përjetojmë një lehtësim të madh kur dikush *bindet* dhe i jepet përqaftimit të sigurt të Shpëtimtarit.

NJË KULTURË UNGJILLËZIMI

Në Letrën e tij drejtuar Filipianëve apostulli Pal shkroi:

...unë ju kam në zemër, sepse si në prangat e mia, edhe në mbrojtjen dhe vërtetimin e ungjillit, të gjithë ju jeni bashkëpjesëmarrës *me* mua të hirit. Se Perëndia *është* dëshmitari im se sa shumë mall kam *për* të gjithë ju me përzemërsi të Krishtit Jezus. (Filipianëve 1:7-8)

Identifikohem shumë fort me dashurinë e Palit për miqtë e tij në Filipi. Për aq sa më kujtohet mua, kam jetuar gjithmonë me miq. Kur isha fëmijë, sillja në shtëpi shokët e mi. Kujtimet e mia më të hershme janë ato të kopshtit pas shtëpisë të mbushur me shokë — për kënaqësinë e nënës sime miqësore.

Kur isha në universitet rrallëherë studioja vetëm — dakord, rrallëherë studioja, por kur studioja, kjo ndodhte me një grup vëllezërish dhe motrash.

U martova me shopen time më të ngushtë.

Në punën time kënaqem më tepër me ato gjëra që më bëjnë bashkë me njerëz të cilët i admiroj dhe i quaj miq.

Kam marrë me vete shokë për të jetuar me mua në vende

të ndryshme rreth botës dhe jam bërë shok edhe me njerëz që jetonin atje.

Sigurisht që ka edhe vështirësi. Për shembull, jam përleshur (pa sukses) të kuptoj se si të shkruaj një libër me miqtë e mi. Mirëpo pavarësisht nga veprimtaria e domosdoshme individuale dhe me raste, dëshira e jetës sime, nga kopshti pas shtëpisë e deri në vendet më të largëta të botës, është që të jem me miq. Këtë dëshirë e kam pasur gjithmonë; kështu jam brumosur.

Pse, pra, një tip ekstrovert si unë mendon për ungjillëzimin vetëm në terma individualë? Ndoshta për shkak se të gjitha udhëzimet që kam dëgjuar në lidhje me ungjillëzimin kanë qenë për ungjillëzimin personal. Madje edhe mësimi që kam dhënë përgjatë viteve, ka qenë më së shumti për ungjillëzimin personal. Kjo është e çuditshme për mua, sidomos për faktin se ungjillëzimi është i frikshëm, dhe nuk më pëlqen që të bëj gjëra të frikshme vetëm. Mendoj se as juve nuk ju pëlqen.

Sigurisht që ekziston një person i rrallë i cili nuk njihet asnjë pengesë për ta shpallur besimin. Mirëpo, nëse i pyesni shumicën e njerëzve se çfarë e pengon ungjillëzimin e tyre, pjesa më e madhe do t'ju thonë se është frika: frika e refuzimit ose frika se mund të duken të pamend, apo se do të shihen si pjesë e grupit të çuditshëm të ungjilltarëve. Duke i kërkuar ndjesë G. K. Chesterton-it, nuk është se ungjillëzimi është provuar dhe ka dalë i mangët; përkundrazi, ungjillëzimi është parë si i vështirë dhe është lënë mënjanë pa u provuar.

Prandaj, përse ta bësh vetëm diçka të frikshme dhe të vështirë? Besimtarë, lidhuni ngushtë së bashku! Ungjillëzoni me miq besimtarë të cilët do t'ju inkurajojnë.

E vlerësoj ungjillëzimin personal, dhe ne kemi nevojë që të pajisemi për të. Mirëpo, përderisa unë besoj te kisha si lokomotiva e ungjillëzimit, ne kemi nevojë që të zhvillojmë kultura ungjillëzimi edhe në kishat tona vendore. Ne duam që e gjithë kisha të flasë për Jezusin.

Mendoni pak në lidhje me përfitimet e ungjillëzimit të përbashkët:

- Ne e mbajmë njëri-tjetrin përgjegjës.
- Ne forcojmë vendosmërinë e njëri-tjetrit.
- Ne mësojmë nga njëri-tjetri.
- Ne gëzojmë së bashku në sukses dhe vajtojmë së bashku në dështim.
- Ne lidhemi edhe më fort përmes përjetimeve të përbashkëta në situata të vështira.

Thjesht ka kuptim që ta shpallim besimin tonë përkrah miqve.

Në fakt, nuk duhen shumë përpjekje për t'i bindur shumicën e të krishterëve që ungjillëzimi i përbashkët është shtegu që duhet të ndjekim. Madje nuk është e vështirë t'i shohësh njerëzit të mblidhen bashkë për të përmbushur një detyrë ungjillëzuese.

Megjithatë, zakonisht, kur mendojmë për ungjillëzimin e përbashkët, ne mendojmë për programet ungjillëzuese, dhe kjo nuk është e njëjta gjë. Me termin “program” e kam fjalën për ngjarjen e madhe të rastit me një folës të mirënjohur ose për një temë interesante. Në një çast gjatë asaj ngjarjeje bëhet një prezantim i ungjillit. Ose ndoshta programi nuk bie aq shumë në sy, dhe është i përgatitur për kërkuesit, si një projekt

UNGJILLËZIMI

shërbimi ose një program sportiv, me shpresën se kjo mund të hapë një derë për një bisedë frymërore.

Perëndia mund t'i përdorë programet. Njoh njerëz që janë kthyer në besim në ngjarje ungjillëzuese. Meqë ra fjala, unë shpesh promovoj programe ungjillëzuese dhe flas në to. Megjithatë, nuk mendoj se programet janë mënyra më e efektshme dhe as parësore se si duhet të ungjillëzojmë.

NJË SHFAQJE PËR PASHKË

Një kishë në qytetin tim vendosi të organizonte një shfaqje për Pashkë. Ideja ishte që ta merrnin historinë e mahnitshme të Pashkës dhe ta paraqisnin si një shfaqje, për t'u bërë thirrje njerëzve të ktheheshin te Krishti. Shfaqjet për Pashkë nuk janë gjë e re, por pleqtë e kësaj kishe donin që ungjilli të ishte i qartë në këtë shfaqje. Në fund të shfaqjes, njerëzve do t'u jepej mundësia për të reaguar ndaj lajmit të mirë.

Kjo gjë kërkonte zgjuarsia në përgatitjen e skenarit për t'i tejkaluar kufizimet e skenës. Sigurisht që shfaqja duhej të ishte argëtuese. Prandaj, kishte këngë dhe aktrim shumë të mirë. Anëtarëve të kishës iu kërkua që të ndërtonin elemente shumë të detajuara për skenën dhe ata punuan pa u lodhur për t'i bërë gjërat gati brenda afatit. Kopshtet zoologjike dhe fermat u zbrazën nga kafshët dhe nga kujdestarët. Mes radhëve të karrigeve kaluan deve, dele dhe lopë për të dalë në skenë dhe kjo i pëlqeu së tepërmi audiencës. Pëllumbat fluturuan në kohën kur u dha sinjali në të shumtën e rasteve.

Kjo shfaqje jepej çdo vit dhe, me kalimin e viteve, popullariteti i saj u rrit përtej asaj që pritej. Duke qenë se u bë edhe më e famshme, u morën në punë producentë nga Hollivudi.

Madje edhe roli i “Jezusit” po luhej nga një aktor (jobesimtar) i Hollivudit. Edhe pse kisha kishte një nga sallat më të mëdha në atë zonë, kërkesa për vende ishte shumë herë më e madhe se kapaciteti. Për ta kontrolluar turmën, u shpërndanë bileta falas; shfaqja jepej për disa javë me radhë, dhe pastaj u shtuan edhe shfaqje të veçanta me pjesëmarrjen e njerëzve të famshëm. Turma njerëzish vinin nga qytezat përreth dhe nga vende të largëta. Programi kishte identitetin e vet.

Kur gjithçka u vu në skenë, doli një shfaqje e jashtëzakonshme! Asnjëri nuk e zuri gjumi gjatë *këtij* prezantimi të ungjillit! Aktrimi ishte i shkëlqyer, këngëtarët ishin profesionistë. Kafshët i magjepsën fëmijët. Pjesa më e bukur, të paktën për fëmijët e mi, ishte kur kali i bardhë shfaqej në skenë ndërsa kryeqindësi vringëllinte shpatën e tij. (Nuk e kuptova kurrë se si e nxorën atë skenë nga Ungjijtë.) Pas kryqëzimit, i cili u bë me më tepër shije dhe në mënyrë më “teatrale” sesa vetë ngjarja reale, “Jezusi” u ngrit lart me anë të litarëve pothuajse të padukshëm. Gjithçka ishte me të vërtetë e mahnitshme!

Vetëm se kishte një problem: kur kisha e pa atë që kishte ndodhur me kalimin e viteve, pavarësisht nga popullariteti i programit, ajo zbuloi se pothuajse askush nuk ishte kthyer te Jezusi.

Pavarësisht nga paratë e shumta që u shpenzuan, gjithë koha që u harxhua për të ndërtuar objektet e skenës, punësimi i njerëzve dhe respektimi i rregullave strikte të qytetit për varjen e njerëzve nëpër kavo, gjithë ata mijëra e mijëra njerëz që e ndoqën shfaqjen dhe gjithë jashtëqitjet e kafshëve që duheshin pastruar, njerëzit nuk po ktheheshin te Jezusi — të paktën jo në numra më të shumtë nga sa do të pritej gjatë

predikimit të rregullt të Fjalës së Perëndisë. Prandaj, pleqtë e kishës u treguan të mençur dhe i dhanë fund shfaqjes.

Them se ky ishte një vendim i vështirë. Njerëzve u pëlqejnë programet — thjesht shihni pjesëmarrjen në këtë shfaqje. Megjithatë, në fund, kisha vendosi që, nëse anëtarët do të kalonin qoftë edhe gjysmën e kohës duke bërë biseda ungjillëzuese me fqinjët, bashkëpunëtorët ose bashkëstudentët, ata do të shihnin një reagim më të mirë ndaj ungjillit dhe do të arrinin më tepër njerëz. Nëse e mendoni këtë, është e pamundur që të akomodoni në sallën e kishës suaj të gjithë jobesimtarët me të cilët anëtarët e kishës suaj janë në kontakt çdo javë — pavarësisht se sa e madhe është salla.

Realiteti është që shumica e njerëzve vijnë në besim përmes ndikimit të anëtarëve të familjes, studimeve të Biblës në grupe të vogla ose përmes një bisede me një mik pas takimit të kishës: të krishterë të cilët flasin qëllimisht për ungjillin.

Por kur u hidhni një vështrim serioz dhe të vëmendshëm programeve, gjërat thjesht nuk kanë atë rezultat. Së pari, ka një raport të dobët mes investimit dhe rezultatit: sa më shumë para që harxhohen në programe, aq më pak fryt del nga ungjillëzimi. Për shembull, kur njerëzit nën moshën 21-vjeçare (mosha para së cilës kthehen në besim shumica e njerëzve) u pyetën se si u lindën sërish, vetëm 1 për qind thanë se kjo ndodhi përmes televizorit ose mediejeve të tjera, kurse shumica që përbëhet nga 43 për qind thanë se u kthyen në besim përmes një miku ose anëtari të familjes.¹ Thjesht mendoni për krahasimin e kostove mes një filxhani kafeje dhe një programi televiziv. Ose mendoni për efektin: nënat udhëheqin më shumë njerëz te Jezusi sesa programet.

Është e çuditshme pasi duket se programet ungjillëzuese bëjnë gjëra *të tjera* më mirë se ungjillëzimin: ato krijojnë komunitet mes të krishterëve që marrin pjesë në to, ato i inkurajojnë besimtarët të qëndrojnë për Krishtin, dhe mund t'i aftësojnë kishat për të hyrë në vende të reja shërbese.

Megjithatë, duket se ne kemi një uri të pashuar për ta përbushur ungjillëzimin me programe. Pse? Programet janë si sheqeri. Ato shijojnë dhe madje krijojnë varësi. Por kjo na e heq dëshirën për ushqime më të shëndetshme. Edhe pse kjo siguron një hov të shpejtë energjie, me kalimin e kohës ju bën të squllët, dhe një dietë e vazhdueshme me programe do t'ju vrasë.

Një dietë strikte me programe ungjillëzuese prodhon ungjillëzim të kequshqyer. Ashtu si të ngrënë e sheqerit mund të na bëjë të ndihemi sikur kemi ngrënë ushqim kur, në fakt, nuk kemi ngrënë, programet shpesh mund të na bëjnë të ndihemi sikur kemi bërë ungjillëzim kur nuk kemi bërë. Prandaj, ne duhet të ndiejmë një parehati të shëndetshme ndaj programeve. Ne duhet t'i përdorim ato në mënyrë strategjike dhe të përkorë, duke kujtuar që Perëndia nuk dërgoi një ngjarje, ai dërgoi Birin e tij.

Çfarë duhet të bëjmë? Ne duam të bëjmë ungjillëzim të përbashkët. Ne digjemi nga dëshira për të pasur miq përkrah nesh kur e shpallim besimin tonë. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ne i dallojmë caqet, madje edhe rreziqet e programeve. A ka ndonjë mundësi tjetër?

Do të doja të argumentoja për diçka krejtësisht të ndryshme, diçka që është personale dhe e përbashkët: një kulturë ungjillëzimi.

ÇFARË ËSHTË NJË KULTURË UNGJILLËZIMI?

Kam jetuar në kultura të ndryshme gjatë një pjese të madhe të jetës sime, dhe nëse ka një gjë të cilën e kam mësuar, është kjo: është pothuajse e pamundur për ta kuptuar një kulturë, çdo kulturë, thjesht duke lexuar një libër. Kështu ndodh edhe me përkufizimet dhe udhëzimet për një “kulturë ungjillëzimi”. Çdo shpjegim i saj nuk bën punë pa pasur një përjetim real të saj, gjë që do t’i japë kuptim.

Sigurisht që kultura ka të bëjë me idetë e përbashkëta, gjuhën e përbashkët dhe kuptimin e përbashkët se si të vep-rosh. Ka shumë shprehje të kulturës: aq të gjera sa kultura ki-neze dhe aq të vogla sa kultura e një familjeje. Kultura shpesh është e padukshme, sidomos për ata që janë pjesë e saj. Po kështu edhe një “kulturë e ungjillit” nëpër kisha ose bashkësi ka ide, gjuhë dhe veprime të përbashkëta biblike. Edhe kjo kul-turë shpesh është e padukshme për ata që janë pjesë e saj.

Mirëpo kur flas me udhëheqës të kishës përreth botës dhe u them atyre se dëshiroj fort të shoh një “kulturë ungjillëzimi”, unë nuk kam nevojë që ta përkufizoj atë. Edhe ata e dëshirojnë fort diçka të tillë. Ata dëshirojnë fort që kishat e tyre të jenë komunitete plot dashuri dhe të përkushtuara për ta shpallur ungjillin si pjesë të një stili të vazhdueshëm jete dhe jo përmes një ngjarjeje ungjillëzuese të rastit.

Edhe pse është e pamundur ta udhëzosh dikë për çdo vep-rim që nevojitet në një kulturë të shëndetshme ungjillëzimi, mendoj se mund t’i përshkruajmë ëndjet që ndiejmë për këtë gjë. Prandaj, le ta kalojmë pjesën tjetër të këtij kapitulli duke i shqyrtuar ato ëndje. Ja ku janë dhjetë ëndjet e mia kryesore për një kulturë ungjillëzimi:

1. Një kulturë e motivuar nga dashuria për Jezusin dhe për Ungjillin e Tij

Sepse dashuria e Krishtit na kontrollon, ngaqë kemi arritur në këtë përfundim: se një vdiq për të gjithë, kështu që të gjithë vdiqën. Dhe ai vdiq për të gjithë, me qëllim që ata që jetojnë, të mos jetojnë më *për* veten e tyre, po *për* atë që vdiq dhe u ngjall për ta. (II Korintasve 5:14-15)

Ungjillëzimi shpesh na duket sikur jemi duke shtyrë një shkëmb përjetë kodrës. Mirëpo kur jam me njerëz motivimi i të cilëve për ungjillëzimin e ka burimin te Jezusi, perceptimi që kam për ungjillëzimin ndryshon. Të motivohesh nga dashuria për ta shpallur ungjillin individualisht, është gjë e bukur, por kur kjo gjë ndodh në komunitet, atëherë është diçka e lavdishme dhe e gëzueshme. Nevoja për t'i ngacmuar njerëzit që ta shpallin besimin e tyre zhduket. Kjo bëhet diçka që ne dëshirojmë fort ta bëjmë. Shpallja e besimit bëhet mendësia jonë.

Kohët e fundit isha me disa nga miqtë e mi të cilët ishin të inkurajuar për disa besimtarë të rinj dhe për mënyrën se si ata po rriteshin frymërisht. Brian-i u kthye nga Shanyl-i dhe tha: "Shanyl, më duhet të të përgëzoj. Danny ishte aq zemërngurtë ndaj ungjillit, saqë shumica e njerëzve do të kishin hequr dorë, por ti këmbëngule me një dashuri të mahnitshme, si për Danny-n, ashtu edhe për Jezusin. Ti nuk u dorëzove, dhe Perëndia të përdori. Tani është e mahnitshme të shohësh se si e ka ndryshuar ungjilli jetën e Danny-t."

Teksa po e dëgjoja Brian-in që po inkurajonte Shanyl-in, edhe unë u inkurajova të kujtoja dashurinë që kam për Jezusin dhe për ungjillin e tij. Po ashtu u kujtova se sa shumë dëshiroj

UNGJILLËZIMI

që t'ua shpall ungjillin të tjerëve me besnikëri. Bota, mishi dhe Djalli gjithmonë na kundërshtojnë në ungjillëzim. Mirëpo, në një kulturë ungjillëzimi, e cila është e rrënjësuar në zemra plot dashuri për Jezusin dhe për ungjillin e tij, të duket sikur mali anohet paksa dhe ne tani e ndjekim shkëmbin, në vend që ta shtyjmë.

2. Një kulturë plot siguri në Ungjillin

Se unë nuk kam turp për ungjillin, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtim... (Romakëve 1:16)

“Vras mendjen se kur e humbën sigurinë e tyre në ungjillin”, pyeti shoku im britanik.

Kjo ishte një gjuhë të cilën nuk isha mësuar ta përdorja. “Çfarë do të thuash?” e pyeta unë.

Ishim duke folur për një shërbesë parakishtare që dikur kishte qenë një qendër e gjallë për dëshminë e ungjillit, por kohët e fundit kishte rënë në vaktësi — fatkeqësisht, historia është plot me ndodhi të tilla.

Ai kapi mjekrën me gishtin e madh dhe me atë tregues, pastaj tha: “Dua të them se kur filluan të kishin besim te marifetet dhe metodat e botës dhe jo në mesazhin e qartë të ungjillit?”.

E dëshiroj fort një kulturë ungjilli e cila nuk e këmben kurrë sigurinë në ungjillin me sigurinë në teknikat, personalitetet ose marifetet e argëtimit. Ata që e kundërshtojnë ungjillin gjithmonë u thonë të krishterëve se bota moderne e ka bërë atë të parëndësishëm. Ata e copëtojnë pak e nga pak sigurinë e të krishterit në fuqinë e ungjillit. Këtë gjë e bënë shumë shekuj

më parë, në një botë që nuk duket më moderne, e bëjnë edhe sot, dhe do të vazhdojnë ta bëjnë derisa Jezusi të kthehet. Bota i tundon të krishterët e dobët që të kenë turp për ungjillin. Unë vetë e dëshiroj fort një kulturë ungjillëzimi në të cilën e ndërtojmë njëri-tjetrin dhe i kujtojmë njëri-tjetrit që t'i lëmë mënjanë praktikën dhe teknikat e botës për ungjillëzimin, duke e vendosur sigurinë tonë të plotë në fuqinë e mesazhit të qartë të ungjillit.

3. Një kulturë që e kupton rrezikun e argëtimit

Sa për ty, bir njeriu, bijtë e popullit tënd flasin për ty pranë mureve dhe te pragu i shtëpive të tyre, i flasin njëri-tjetrit, duke i thënë secili vëllait të tij: “Eja të dëgjosh cila është fjala që vjen nga ZOTI”. Kështu vijnë te ti ashtu si bën njerëzia, ulen para teje si populli im dhe dëgjojnë fjalët e tua, por nuk i vënë në praktikë; me gojën e tyre, pra, tregojnë dashuri të madhe, por zemra e tyre shkon pas fitimit të tyre të padrejtë. Ja, ti je për ta si një këngë dashurie e dikujt që ka një zë të bukur dhe di t'i bjerë mirë një vegle; ata dëgjojnë fjalët e tua, por nuk i vënë në praktikë. (Ezekieli 33:30–32)

Njerëzit flisnin për Ezekielin, profetin e lashtë të Izraelit, në rrjetet sociale të kohës së tij (pranë mureve dhe te pragu) dhe i thoshin njëri-tjetrit: “Le të shkojmë e të shohim atë shfaqjen e re që po jepet në qytet: predikimin e Ezekielit!”. Ata duan ta dëgjojnë atë sikur ai të ishte një “këngëtar me zë kumbues” apo një muzikant shumë i zoti. Ata nuk e shihnin Ezekielin si profet që u liste për shpëtimin e tyre, por si humorist. Pavarësisht nga gjithë entuziazmi i tyre për shfaqjen, ajo që ata kishin në mendje ishte seksi dhe paraja, jo bindja ndaj Perëndisë.

A nuk tingëllon kjo si një problem modern? Për t'i bërë njerëzit që të vijnë në një takim kishe, mjafton vetëm që të bëjmë një postim me tematikë gudulisëse në rrjetin X, të organizojmë një performancë muzikore që prek emocionet ose të gjejmë një folës karizmatik që di se si t'ua prekë njerëzve telat e shpirtit — aq më mirë nëse ai është tip humoristi. Nuk është e vështirë. Megjithatë, Perëndia e paralajmëroi Ezekielin dhe na paralajmëron edhe ne sot që të kemi kujdes: ju mund të mbledhni një turmë me anë të metodave të tilla, por nuk do t'i fitoni dot zemrat e tyre. Fitimi i zemrave është një punë të cilën mund ta bëjë vetëm Fryma e Shenjtë.

Në një kulturë ungjillëzimi nuk e ngatërrojmë argëtimin me shërbesën ose shërbesën me argëtimin. Ne shpallim së bashku të vërtetat e mrekullueshme të Perëndisë. Ne i tregojmë njëri-tjetrit për shpëtimin e tij të madh, për lavdinë e tij mes kombeve dhe për veprat e tij të mrekullueshme (Psalmi 96:2-3). E dëshiroj fort një kishë që i kupton rreziqet e argëtimit dhe e sheh se çfarë është ai realisht: një luan që po afrohet te porta e ungjillorëve, gati për të na gllabëruar. Kemi nevojë për një kulturë ungjillëzimi që nuk ofron kurrë flajime mbi altarin e idhullit të argëtimit, por, përkundrazi, shërben ushqimin e shëndetshëm dhe të shijshëm që gjendet në ungjillin e Krishtit.

4. Një kulturë që i sheh njerëzit qartë

Prandaj ne, tani e tutje, asnjë *nuk* e njohim sipas mishit. (II Korintasve 5:16a)

Sa e lehtë është që të përqafosh kulturën e botës dhe t'i vlerësosh njerëzit bazuar në pikëpamje seksiste, raciste ose në pikë-

pamje të tjera sipërfaqësore. Ne kemi prirjen të harrojmë që njerëzit përreth nesh janë njerëz prej mishi dhe gjaku, me lëndime, përlëshje dhe dashuri reale. Mirëpo Pali thotë se mënyra se si i shikojmë njerëzit ndryshon kur njohim Krishtin. Ne nuk i shohim njerëzit përmes syve të botës, siç bënim dikur, por i shohim përmes syve të Perëndisë.

Kur u zhvendosëm në lagjen tonë në Lexington, Kentucky, dëshironim me të vërtetë që të njiheshim me njerëzit rreth nesh. Mirëpo biseda jonë e parë në lidhje me gjërat frymërore me fqinjin tonë Tomin, i cili jetonte tri shtëpi më poshtë, nuk ishte dhe aq inkurajuese. Një ditë, ai më pa duke punuar në kopsht dhe ndaloj për një vizitë. Në njërën dorë kishte një pije alkoolike dhe në tjetrën cigaren. Po bisedonim për gjëra të ndryshme, më së shumti po flisnim për faktin se sa mirë dukej kopshti i tij, kur djali im gjashtëvjeçar na u bashkua. “Pirja e duhanit është e rrezikshme — duhet ta lësh”, shpërtheu ai me një vështrim të vrenjtur në fytyrë dhe me duart në mes. “Lutju Jezusit, dhe ai do të të ndihmojë ta lësh.”

Mbeta pa fjalë dhe më ngriu buzëqeshja në fytyrë. “Oh, fantastike!” mendova unë. “Po kjo nga doli? Ndoshta ata po mendojnë se ne jemi fanatikë fetarë që ulen rreth tryezës dhe flasin për fqinjët e tyre të ligj.” Për t’i dhënë të drejtë Davidit, halla e tij Linda, një besimtare e re, ishte zotuar që të hiqte dorë nga duhani dhe Davidi ishte lutur për të. Megjithatë, unë s’e desha veten.

Por Tomi e shkeli cigaren e tij, u ul në nivelin e djalit tim, dhe ndërsa i hodhi dorën mbi sup, i buzëqeshi dhe i tha: “E di çfarë, David? Ndoshta ke të drejtë, ndoshta ke të drejtë.”

Sa përgjigje e hirshme dhe e mrekullueshme që ishte kjo

UNGJILLËZIMI

nga ana e Tomit! Kjo më bëri të mendoja në lidhje me opinionin tim për të. Kuptova se kisha nevojë të pendohesha që e kisha parë Tomin thjesht si një burrë në rrugën tonë, dhe ta shihja për atë që ishte realisht. Prezantimi i Davidit mund të ketë qenë i pasjellshëm, megjithatë ishte më i mirë se mosveprimi im, dhe kjo, në fakt, çoi në fillimin e marrëdhënies sonë me Tomin, e cila nuk e di nëse do të kishte ndodhur po të mos kisha filluar ta takoja atë si një person real.

Kur Pali thotë se duhet t'i shohim njerëzit përmes syve të Krishtit, ai do që ne të kemi për ta një pikëpamje sipas ungjillit. Ne, pra, i shohim njerëzit si krijesa të bukura dhe të vlefshme, të krijuara në shëmbëllimin e Perëndisë. Secili nga ne mbart vulën e Perëndisë. Ja pse të krishterët besojnë se të gjithë njerëzit kanë dinjitet dhe vlerë.

Në të njëjtën kohë, ne pranojmë që çdo person është i rënë, mëkatar dhe i ndarë nga Perëndia. Të gjithë njerëzit e kanë shtrembëruar shëmbëllimin e Perëndisë dhe i kanë dhënë formë të tmerrshme. Ja pse të krishterët as nuk magjepsen së tepërmi me njerëzit.

Megjithatë, në një kulturë ungjillëzimi, më së shumti i kushtojmë rëndësi asaj që njerëzit mund të bëhen: krijime të reja në Krishtin, të rimëkëmbura dhe të ripërtërira nga fuqia transformuese e Perëndisë (II Korintasve 5:17). Dëshiroj fort të jem me të krishterë të cilët e mbajnë mend që njerëzit janë shëmbëllimbartës të Perëndisë. Dëshiroj fort të jem me të krishterë të cilët mbajnë mend që njerëzit janë të ndarë nga Perëndia. Mbi të gjitha, dëshiroj fort një kulturë që e mban mend se çfarë mund të bëhen njerëzit përmes ungjillit.

5. Një kulturë e lidhur bashkë si një trup

E falënderoj Perëndinë tim sa herë që ju kujtoj, duke u përgjyruar gjithmonë me gëzim në çdo përgjyrim timin për të gjithë ju, për pjesëmarrjen tuaj për ungjillin nga dita e parë e deri tani. (Filipianëve 1:3-5)

Pali i shkroi kishës në Filipi dhe u tregoi mirënjohjen e tij për ta, pasi kishin qenë bashkëpunëtorët e tij në shërbesën e ungjillit. Kjo është një tablo e një kulture ungjillëzimi. Ata u bashkuan për hir të ungjillit. Të gjithë ishin të përfshirë.

Kur isha trajneri i ekipit të futbollit të djalit tim pesëvjeçar, e mblidhnim ekipin (kjo ishte diçka shumë e lezetshme) dhe pyesnim: “Dakord, ekipi, kur topin ta ketë ekipi tjetër, cilët nga ju janë në mbrojtje?”. Ata thërrisnin me ngazëllim: “Të gjithë!”. Pastaj i pyesnim: “Po kur e kemi ne topin, cili nga lojtarët hidhet në sulm?”. Ata përgjigjeshin: “Të gjithë!”. Megjithatë, kur ishim duke luajtur një lojë reale, zbatimi i atij koncepti ishte paksa i vështirë për këta djem pesëvjeçarë.

Kështu është edhe ungjillëzimi. Megjithatë, synimi për të dy është i njëjtë: kërkohet që të gjithë të lëvizin në të njëjtin drejtim.

Në një kulturë ungjillëzimi, ka një mendësi që të gjithë janë të përfshirë. A e keni dëgjuar ndonjëherë dikë të thotë: “Ungjillëzimi nuk është dhuntia ime”, a thua se kjo gjë e liron atë nga përgjegjësia për të folur për besimin e tij? Ky është një kuptim fëmijëror i ungjillëzimit. Të gjithë të krishterët janë thirrur për ta shpallur besimin e tyre si tregues i besnikërisë dhe jo i dhuntive të tyre (Mateu 28:19).

Dëshiroj fort ta shpall besimin tim në kontekstin e një

kishe që e kupton se çfarë po bëj dhe që më bashkohet mua. Në një kulturë të tillë, kur e sjell një mik në kishë, të tjerët nuk hamendësojnë se ai person është i krishterë. Ata nuk tronditen kur e prezantoj dikë dhe them: “Ky është Bobi, ai po e shqyrton krishterimin.” Ata jo vetëm që nuk tronditen, por përgjigjen kështu: “Jam shumë i gëzuar që ke ardhur. Edhe unë kam qenë në të njëjtin vend disa vjet më parë, ndaj do të më pëlqente shumë të dëgjoja për këtë gjë. Më trego se për çfarë po mendon?”

Dëshiroj fort një kulturë ku të gjithë ne jemi duke punuar bashkë drejt një synimi për të qenë dëshmitarë për Krishtin.

6. Një kulturë në të cilën njerëzit e mësojnë njëri-tjetrin

...përherë të gatshëm për mbrojtje *ndaj* çdokujt që ju kërkon arsye rreth shpresës *që është* në ju. (I e Pjetrit 3:15b)

Mbaju standardit të fjalëve të shëndosha, të cilat i dëgjove nga unë, në besim dhe dashuri që *janë* në Krishtin Jezus. (II Timoteut 1:13)

Pjetri na udhëzon të jemi gati për të dhënë arsyet dhe përgjigjet për shpresën që kemi brenda nesh. Për të qenë në gjendje që ta bëjmë këtë, ne kemi nevojë për një trajnim të mirëmbënuar, të cilin pastaj e vëmë në zbatim. Ja pse Pali i kujtoi Timoteut që ta mbante standardin e asaj që ishte mësuar.

Do ta këmbeja me shumë dëshirë të gjithë entuziazmin e folësve të shkëlqyer, të gjithë muzikën magjepsëse, si dhe shfaqjet jashtëzakonisht popullore për Pashkë, me një kulturë ungjillëzimi në të cilën njerëzit janë trajnuar të udhëheqin një studim Bible me një jobesimtar duke përdorur Ungjillin sipas

Markut, të tregojnë mesazhin e ungjillit në tekst dhe ta nxitin jobesimtarin të vijë te Jezusi mbi bazën e së vërtetës që ka mësuar nga Shkrimet.

Në një kulturë ungjillëzimi, anëtarët i mësojnë njëri-tjetrit ato lloje gjërash të cilat i pamë në kapitullin e parë: çfarë është ungjillëzimi, çfarë është ungjilli dhe çfarë është kthimi i vërtetë biblik në besim. Ne, gjithashtu, e mësojmë njëri-tjetrin se si ta shpallim mesazhin e ungjillit. Pastaj e bëjmë këtë gjë nga e para, duke e ditur që, nëse nuk e bëjmë, nuk qëndrojmë në formë. Në një kulturë ungjillëzimi, njerëzit e mësojnë me kujdes njëri-tjetrin se si ta shpallin besimin në një mënyrë biblike.

7. Një kulturë që modelon ungjillëzimin

...dhe ato që dëgjove nga unë në praninë e shumë dëshmitarëve, këto *gjëra* besojua njerëzve besnikë, të cilët do të jenë të aftë për të mësuar edhe të tjerë. (II Timoteut 2:2)

Gjëja e bukur në një kulturë ungjillëzimi, nëse e kapim atë si duhet, është që besimtarët e rinj kanë zellin dhe kontaktet të cilat shpesh u mungojnë besimtarëve më të vjetër. Megjithatë, të krishterët më të vjetër kanë mprehtësinë dhe njohurinë për të cilat kanë nevojë të krishterët e rinj.

Tani që jam duke shkruar këto fjalë, bashkëshortja ime është ulur në divan, duke u përgatitur të takohet me Ruthin dhe Samanti-n sot pasdite. Leeann-a po i udhëheq ato në një studim përmes kursit *Krishterimi i shpjeguar (Christianity Explained)*. Ruthi është një besimtare e re; ajo është e ngazëlluar për besimin e saj dhe për të shpallur ungjillin. Ruthi dhe Sa-

manti punojnë bashkë dhe kanë shumë gjëra të përbashkëta, përderisa vijnë nga i njëjti qytet në Sri Lanka. Babai i Samanti-t është budist, nëna e saj është katolike romane dhe bashkëshorti i saj është mysliman. Kjo është gjë tipike në Dubai. Ndërsa Ruthi po i tregonte Samanti-t për besimin e saj të krishterë, Samanti i tha Ruthit se donte të mësonte më tepër. Ruthi është shumë e vetëdijshme që jeta e saj është transformuar nga Jezusi, por kur bëhet fjalë për ta shpjeguar besimin e saj, ka nevojë për pak ndihmë, sidomos me dikë që ka prejardhjen e Samanti-t. Prandaj, ajo bëri diçka me mend duke e sjellë Samanti-n te Leeann-a.

Leeann-a, nga ana e tjetër, është një ungjilltare me shumë njohuri dhe kuptim, por rrethi i miqve të saj përbëhet më së shumti nga të krishterë të pjekur. Leeann-a ishte e ngazëlluar që do ta takonte Samanti-n dhe do të fliste me të. Samanti ka nevojë për Jezusin! Të tria ato janë një shembull shumë i mirë për atë që ndodh në një kulturë ungjillëzimi. Leeann-a merr iniciativën për ta shpjeguar ungjillin. Ruthi mëson se si ta shpallë besimin e saj ndërsa merr pjesë në studim dhe vazhdon ta ushqejë miqësinë e saj me Samanti-n. Dhe dashtë Zoti, Samanti dëgjon dhe reagon ndaj mesazhit të mahnitshëm që Krishti i shpëton mëkatarët. Në një kulturë ungjillëzimi, njerëzit e modelojnë ungjillëzimin për njëri-tjetrin.

8. Një kulturë në të cilën nderohen njerëzit që e shpallin besimin e tyre

Tani, shpresoj në Zotin Jezus që t'ju dërgoj së shpejti Timoteun, që edhe unë të gjallërohem duke njohur gjërat që kanë të bëjnë me ju. Se *nuk* kam asnjë të njëjti mendjeje *me mua*, i cili vërtet

të shqetësohet *për* gjërat që kanë të bëjnë *me* ju; se të gjithë kërkojnë gjërat e veta, jo ato të Jezus Krishtit. Por *ju* e njihni të provuarit e *karakterit* të tij, se si shërbeu bashkë me mua për ungjillin, ashtu si një fëmijë i shërben të atit. (Filipianëve 2:19–22)

Më pëlqen se si Pali e nderon Timoteun për punën e tij në shpalljen e ungjillit. Në mënyrë të ngjashme, John-i, i cili është pastor i një kishe tjetër në qytetin tonë, e fillon rregullisht kohën e përbashkësisë duke u kërkuar atyre që kanë pasur mundësi të flasin për Jezusin gjatë asaj jave, që të tregojnë historitë e tyre. Pasi ata flasin, ai i kërkon dikujt që të lutet për ta.

Kjo praktikë e kremtimit të përpjekjeve ungjillëzuese është e thjeshtë dhe nuk kërkon shumë kohë, por është jashtëzakonisht e rëndësishme në kultivimin e një kulture ungjillëzimi. Nuk ka asgjë më shkurajuese se ndjenja që një kishë është më e interesuar për vullnetarë që të kujdesen për fëmijët se për të shpallur besimin.

Unë dëshiroj fort që të jem në një kishë ku kremtohen edhe përpjekjet ungjillëzuese. Edhe nëse një përpjekje ungjillëzuese nuk sjell një kthim në besim sipas ungjillit, është më mirë të dështosh në ungjillëzim, sesa të mos provosh fare të ungjillëzosh.

9. Një kulturë që di si ta afirmojë dhe kremtojë jetën e re

E falënderojmë gjithmonë Perëndinë, Atin e Zotit tonë Jezus Krisht, duke u lutur për ju, sepse dëgjuam *për* besimin tuaj në Krishtin Jezus dhe *për* dashurinë që keni për të gjithë shenjtorët ... ashtu siç mësuat nga Epafrai, i dashuri *ynë* skllav bashkë *me* ne, i cili është një shërbenjës besnik i Krishtit për ne. (Kolosi-nëve 1:3-4, 7)

Pali e dinte si t'i afirmonte besimtarët e rinj. Ai e kremtoi kthimin e tyre në besim, por e ruajti fokusin e tij — dhe të tyrin — në Krishtin. Ai nuk i lartësoi ata në mënyrë të papërshtatshme, por as nuk i shpërfilli. Një kulturë ungjillëzimi e kremton jetën e re në Krishtin në mënyrën e duhur.

Pas një serie takimesh tek për tek dhe studimesh Bible me Mark Dever-in, Rob-i e hodhi poshtë besimin e tij të mëparshëm ateist dhe i tha Mark-ut se ishte bërë i krishterë. “E po, Rob”, i tha Mark-u, “më trego se çfarë do të thuash me këtë.” Rob-i shpjegoi ungjillin dhe tregoi se si ishte penduar për mënyrën e tij të jetës pa besim dhe se e kishte vendosur besimin plotësisht në Krishtin.

Pastaj Mark-u i tha: “Vëlla, nga ajo që më the, bie dakord me ty: ti je bërë i krishterë. Le të lutemi.” Pasi u lutën, Mark-u i tha: “Ti e kupton se shenja e kthimit të vërtetë në besim nuk është një lutje, por një ecje afatgjatë me Jezusin. Prandaj, edhe pse unë besoj se ti je kthyer te Krishti, do të shohim se çfarë do të ndodhë me kalimin e kohës.”

Përgjigjja e Mark-ut është një shembull për atë që unë e quaj reagimi “‘Aleluja!’ dhe ‘Do të shohim!’”. Ne themi “Aleluja!”, sepse kthimi i vërtetë në besim është gjëja më e mirë që mund t'i ndodhë një personi. Ne themi “Do të shohim”, pasi e dimë se kthimi në besim mund të jetë fals, edhe pse kjo mund të bëhet pa dashje. Prova më e rëndësishme është e trefishtë: një kuptim i mirë i ungjillit, një jetë e ndryshuar dhe një ecje afatgjatë me Krishtin.

Mark-u nuk e mbajti të fshehtë bisedën me Rob-in, por as nuk e lartësoi atë menjëherë për ta kthyer në një vip. Në pagëzimin e tij, Rob-i e tregoi siç duhet se si u kthye në besim.

Megjithatë, sprovat do të vinin, dhe mënyra se si ai eci përmes tyre, ishte më e rëndësishme se çdo histori kthimi në besim.

Në një kulturë ungjillëzimi, të krishterët e dinë se si të reagojnë ndaj atyre që janë kthyer në besim kohët e fundit.

10. Një kulturë për të bërë shërbesë që duket se ndërmerr rreziqe dhe është e rrezikshme

Tani, dëshiroj që ju ta dini, vëllezër, se rrethanat e mia kanë ndihmuar më tepër për përparimin e ungjillit, aq sa prangat e mia në Krishtin të bëhen të njohura në tërë pretoriumin dhe për të gjithë të tjerët. (Filipianëve 1:12–13)

Shërbesa e Palit ishte aq e rrezikshme, saqë e mbyllën në burg. Ashtu si Pali, edhe unë jetoj në një pjesë të botës ku realisht njoh njerëz që janë futur në burg, për shkak se kanë jetuar me besnikëri ndaj Krishtit.

Sikurse e shohim edhe te II Korintasve 10:4-5, Pali thotë se jeta e krishterë nënkupton luftë me mendimet që shkojnë kundër Perëndisë: “...duke përmbystur arsyetime dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë, dhe duke e bërë rob çdo mendim për bindjen ndaj Krishtit.” Kjo përbën rrezik; botës nuk i pëlqen që mendimet e saj të sfidohen. A jemi të gatshëm për t’i ftuar njerëzit që të përfshihen në një ungjillëzim me rrezik? Dëshiroj fort një kulturë ungjillëzimi e cila është e rrezikshme në kuptimin që po ballafaqojmë kulturën. Kjo, më së shumti, do të thotë të mos i kushtojmë rëndësi asaj që njerëzit mendojnë për ne.

Kisha “Porta e shpresës” në Portland të Oregonit, po i arrin hipitë² me një efektshmëri shumë të madhe. Madje udhëheqja e kishës vendosi që takimin e saj të dielën mbrëma ta bënte

në një park aty pranë. Ky ishte takim i rregullt, por që tani u zhvillua në ambient të hapur. Ata u përballën me përqeshje, ngacmime, dhe madje një grua e hoqi bluzën në përpjekje për ta tronditur bashkësinë. Mirëpo të tjerët që e panë mirësinë dhe dashurinë e kishës u bashkuan me ta.

Njerëz të tjerë ndërmarrin rreziqe të llojeve të ndryshme. Shoqja ime Joanna thotë: “Unë as që e di se si të bëj një studim Bible pa pasur disa myslimanë si pjesë të grupit.” Të gjithë ne duhet të mendojmë për mënyra se si mund të ndërmarrim rreziqe në kontekstet tona të veçanta. Kur ndërmarrim rreziqe, ndodh diçka interesante: ne bëhemi të rrezikshëm — domethënë, në sferat frymërore — për ata që në mendjen e tyre janë kundërshtarë të Perëndisë.

Te Letra drejtuar Filipianëve Pali thotë se ungjilli ishte shpallur edhe mes pretoriumit, rojeve perandorake (Filipianëve 1:13). Kur ai dërgon përshëndetje në fund të letrës, shkruan: “Ju përshëndesin të gjithë shenjtorët, por veçanërisht ata prej shtëpisë së Cezarit” (4:22). Është e qartë që Pali kishte parë se si disa nga rojet e tij ishin kthyer në besim.

Pali rrezikoi dhe jeta e tij plot rrezik për ungjillin ishte shtegu që e çoi në burg. Megjithatë, gjithmonë më ka pëlqyer vëzhgimi se nuk ishte Pali ai që ishte i lidhur me zinxhirë pas një roje, por roja ishte i lidhur pas Palit.

Dëshiroj fort të shoh një kishë ku fqinjët ateistë dhe jobesimtarë të shohin ateistë dhe jobesimtarë të tjerë të kthehen në besim — ky është një tregues që jemi pjesë e një kulture ungjillëzimi që ndërmerr rreziqe.

11. Një kulturë që e kupton se kisha është metoda e zgjedhur dhe më e mirë e ungjillëzimit

Dhe çdo ditë, duke u përkushtuar me një mendje në tempull dhe duke thyer bukën shtëpi më shtëpi, merrnin ushqim me ngazëllim dhe thjeshtësi zemre, duke lavdëruar Perëndinë dhe duke pasur hir para tërë popullit. Dhe Zoti i shtonte grupit çdo ditë ata që shpëtoheshin. (Veprat e Apostujve 2:46-47)

Dakord, e di që thashë dhjetë gjëra. Mirëpo ka edhe një më shumë, e cila ka qenë pjesë e të dhjetave: unë dëshiroj fort një kishë e cila e kupton se ajo — kisha vendore — është metoda e zgjedhur dhe më e mirë e ungjillëzimit. Unë dëshiroj fort një kishë ku të krishterët e duan aq shumë Jezusin, sa që kur mbledhen bashkë për një kohë adhurimi, ata bëhen një tablo e ungjillit. Dëshiroj fort një kishë që i çarmatos njerëzit me dashuri, jo me argëtim, dhe që shfaq një siguri kundërkulturore në fuqinë e ungjillit. Dëshiroj fort një kishë në të cilën festa më e madhe bëhet për ata që e shpallin besimin, dhe heronjtë janë ata që rrezikojnë reputacionin e tyre për të ungjillëzuar.

Dëshiroj fort një kulturë ungjillëzimi me vëllezër dhe motra që mbrojnë shpinën e njërit-tjetrit në betejë; një kulturë në të cilën më mësojnë dhe jap mësim se çfarë do të thotë ta shpallim besimin tonë; dhe ku shoh udhëheqësit e kishës që i drejtojnë njerëzit te Jezusi. Dëshiroj një kishë ku mund të dallosh jetët e ndryshuara, ku mund të shohësh njerëz që ngrihen në këmbë dhe thonë: “Kur erdha në këtë kishë para dy vjetësh, nuk e njihja Perëndinë, por tani e njoh atë!”. Dëshiroj fort të

UNGJILLËZIMI

jem pjesë e një kulture të tillë ungjillëzimi. Them se edhe ju e dëshironi të njëjtën gjë.

Më sipër e përmenda që nuk mendoj se programet janë mënyra më e mirë apo parësore se si duhet të bëjmë ungjillëzim. Ajo që mendoj është se ungjillëzimi më i mirë ndodh në një kulturë ungjillëzimi brenda një kishe të shëndetshme. Kjo është një temë tepër e gjerë për të qenë thjesht një nga dhjetë më të rëndësishmet; roli i kishës dhe mënyra e ungjillëzimit janë tema e kapitullit vijues.

LIDHJA E KISHËS ME NJË KULTURË UNGJILLËZIMI

Sikurse e përmenda edhe më sipër, nëse je pjesë e një kishe të shëndetshme që ka një kulturë ungjillëzimi, je pjesë e mënyrës më të mirë të ungjillëzimit që është njohur ndonjëherë. Si zbatohet ky parim në kishë?

Lërimi mënjanë kundërshtimet pragmatike ndaj kësaj ideje; ne jemi duke trajtuar një koncept jashtëzakonisht frymëror dhe biblik. Jezusi tha: “Prej kësaj do ta kuptojnë të gjithë se jeni dishepuj të mi: po të keni dashuri ndërmjet njëri-tjetrit” (Gjoni 13:35). Pak më vonë, gjatë së njëjtës periudhe kohore që kaloi me dishepujt e tij, ai u lut që ata të ishin në unitet, “që bota të besojë se ti më dërgove” (Gjoni 17:20–21). Jezusi thotë se dashuria që kemi për njëri-tjetrin në kishë, është deklarata që ne jemi kthyer me të vërtetë në besim. Kur jemi në unitet si kishë, ne i tregojmë botës se Jezusi është Biri i Perëndisë. Dashuria vërteton dishepullimin tonë. Uniteti vërteton hyjninë e Krishtit. Çfarë dëshmie e fuqishme!

Ka shumë pasazhe nga Shkrimi i Shenjtë të cilat na udhë-

UNGJILLËZIMI

zojnë dhe u japin formë përpjekjeve tona ungjillëzuese, por këto vargje janë themelore, për shkak se na tregojnë që kisha duhet të jetë një kulturë ungjillëzimi. Këto vargje duhet t'i përdorim për t'u mësuar katekizëm fëmijëve tanë!

Pyetje: Cili veprim e vërteton kthimin tonë të vërtetë të Krishti?

Përgjigje: Dashuria për të krishterët e tjerë.

Pyetje: Si e tregojmë se Jezusi është Biri i Perëndisë?

Përgjigje: Duke qenë në unitet me besimtarët e tjerë.

KISHA VENDORE ËSHTË MËNYRA SE SI UNGJILLI BËHET I DUKSHËM

Nëse duam që ta portretizojmë ungjillin në dashurinë tonë për njëri-tjetrin, kjo gjë duhet të ndodhë në një bashkësi vendore me njerëz të cilët, në dashuri, kanë lidhur besën bashkë për të qenë një kishë. Kjo nuk është një dashuri abstrakte, por dashuri për njerëzit në botën reale. Nuk mund t'jua tregoj dot se sa herë kam dëgjuar nga jobesimtarët të thonë se kisha u dukej e çuditshme, por ajo që i tërhoqi në bashkësi ishte dashuria mes anëtarëve të saj.

Mirëpo ungjilli nuk portretizohet vetëm në dashurinë tonë. A e keni menduar ndonjëherë se sa shumë udhëzime biblike ka përfshirë Perëndia në lidhje me natyrën e kishës, të cilat nëse zbatohen si duhet, shërbejnë si shpallje të ungjillit?

Kur përpiqemi për një kulturë të shëndetshme ungjillëzimi, nuk e riformojmë kishën për ungjillëzim. Përkundrazi, ne lejojmë gjërat që Perëndia tashmë i ka përfshirë në natyrën e kishës, që ta shpallin ungjillin. Për shembull, pagëzimi portretizon vdekjen, varrimin dhe ringjalljen e Jezusit. Ai tregon

se vdekja e tij është vdekja jonë dhe jeta e tij është jeta jonë. Darka e Zotit shpall vdekjen e Krishtit derisa ai të kthehet dhe na nxit që t'i rrëfejme mëkatet tona dhe të përjetojmë sërish falje. Kur lutemi, ne lutemi sipas të vërtetave të Perëndisë. Ne këndojmë për gjërat e mëdha që Perëndia ka bërë për ne përmes ungjillit. Ne japim nga financat tona për ta çuar përpara mesazhin e ungjillit. Predikimi i Fjalës së Perëndisë është ai që e sjell ungjillin.

Në fakt, predikimi i Fjalës së Perëndisë është ai që i jep formë kishës. Sapo kisha të jetë formuar, ajo i kushtohet detyrës së bërjes së dishepujve, të cilët pastaj dërgohen për të predikuar ungjillin dhe për të formuar kisha të reja. Ky cikël ka qenë duke ndodhur që nga koha kur Jezusi u ngjit në qiell, dhe do të vazhdojë derisa ai të kthehet.

GJËJA REALISHT E RËNDËSISHME

Kohët e fundit isha në Kishën Baptiste High Pointe në Austin të Teksasit. Pastor Juan-i më kërkoi të jepja një seminar për kultivimin e një kulture ungjillëzimi. Unë fola dhe njerëzit më bënë pyetje. Pastaj dikush më bëri një pyetje përgjigjja e së cilës tashmë ishte e qartë: “Në komunitetin përreth kishës sonë po vijnë shumë vietnamezë; çfarë do të bëjë kisha për t'i arritur ata me ungjillin?”.

Nga njëra anë, kjo ishte një pyetje e mrekullueshme. Një prej anëtarëve kishte dalluar se ajo kishte privilegjin dhe përgjegjësinë për t'i arritur njerëzit me ungjillin, dhe ajo pa mundësinë për ta bërë këtë gjë.

Mirëpo kultura e ungjillëzimit është një kulturë që fillon në bazë dhe jo një hierarki. Në një kulturë ungjillëzimi,

UNGJILLËZIMI

njerëzit e kuptojnë se detyra kryesore e kishës është të jetë kisha. E kemi parë tashmë se praktikat e kishës janë në vetvete një dëshmi e ungjillit. Sigurisht që kisha i mbështet mundësitë ungjillëzuese për t'i arritur njerëzit dhe lutet për to, por roli i kishës nuk është që të organizojë programe. Kisha duhet të kultivojë një kulturë ungjillëzimi. *Anëtarët* dërgohen nga kisha për të bërë ungjillëzim. E di se kjo mund të tingëllojë paksa tekanjoze, por realisht është shumë e rëndësishme. Nëse këtë gjë nuk e kapni si duhet, mund ta dobësoni kishën — ose mund të zemëroheni gabimisht me udhëheqjen e saj.

Ja se si iu përgjigja pyetjes që m'u bë në Kishën Baptiste High Pointe: “Në fakt, gjëja më e mirë nuk është që kisha të organizojë programe për arritjen e vietnamezëve, por që ti të mendosh se si mund t'i arrish ata. Do të të rekomandoja të mësoje diçka rreth kulturës vietnameze, të provoje gatimet e tyre, të mësoje në lidhje me vështirësitë që hasin ata, për shkak se jetojnë në një kulturë në të cilën janë pakicë. Afroju njerëzve dhe ftoji miqtë e tu të rinj të vijnë në shtëpinë tënde dhe të vijnë me ty në një grup të vogël të studimit të Biblës ose në takimet e kishës. Pastaj ndoshta disa prej jush mund të mëndojnë që të vendosen në komunitetin vietnamez, me qëllim që ta shpallni ungjillin në mes të atij komuniteti.”

Nga vështrimet që mora dukej që njerëzit nuk po më kuponin. Megjithatë, u lehtësova së tepërmi kur pashë fytyrën e pastor Juan-it, i cili ishte mirënjohës që nuk kisha filluar një program ungjillëzimi që ta drejtonte ai.

Pastaj shtova: “Kur ti e sjell në kishë shoqen tënde nga komuniteti vietnamez, të gjithë ‘përfshihen’: ju të gjithë po ungjillëzoni. Kjo është një kulturë ungjillëzimi. Nuk ka të bëjë

thjesht me të qenët miqësorë, edhe pse kjo duhet të ndodhë, por ka të bëjë me të pasurit e një vetëdijeje të thellë që jemi së bashku në këtë gjë. Në një kishë të shëndetshme vizitorët e shohin ungjillin të paraqitur në gjithçka që bëjmë. Ja pse këndojmë sipas Fjalës, lutemi sipas Fjalës, e predikojmë Fjalën. Ne duam që njerëzit ta dëgjojnë ungjillin gjatë shërbesës. Kur i praktikojmë sakramentet, ne duam që njerëzit ta shohin ungjillin dhe ta dëgjojnë sërish, teksa shpjegojmë se çfarë po ndodh. Ndërsa anëtarët e kishës e jetojnë ungjillin, ungjilli përçohet prej nesh.”

Kjo është një skicë e një kulture ungjillëzimi në veprim. E di se kjo është paksa radikale — dhe madje as nuk u sugjerova që t’i regjistrojnë fëmijët e tyre në një shkollë lokale bashkë me fëmijët vietnamezë. Disa mund të më akuzojnë që nuk kujdesem për komunitetin vietnamez, pasi i thashë Kishës Baptiste High Pointe që të mos kishin një program ungjillëzues të sponsorizuar nga kisha. Megjithatë, unë jam dakord që mënyra më e mirë për t’u kujdesur për atë komunitet ose për cilindo komunitet është që t’u japim atyre ungjillin dhe kështu të kthehen në besim. Ky synim arrihet më mirë përmes dëshmisë së një kishe që ka një kulturë ungjillëzimi, kur anëtarët e saj bëhen miq me fqinjët vietnamezë, me të cilët pastaj mund ta shpallim ungjillin. Kjo qasje ka një ndikim shumë herë më të madh sesa një program kishe për shpërndaje rrobash, kujdes ditor, vizita shtëpi më shtëpi, organizim të veprimtarive argëtuese për fëmijë ose çdo gjë tjetër që kishat e bëjnë me qëllim të mirë.

Në njëfarë kuptimi, të gjitha kishat kanë një kulturë të caktuar ungjillëzimi. Edhe kishat që e refuzojnë ungjillëzimin kanë një kulturë ungjillëzimi, paçka se kjo është një kulturë

UNGJILLËZIMI

jobiblike. Pyetja nuk është: “A kemi një kulturë ungjillëzimi?”, por “A është kultura jonë e ungjillëzimit e shëndetshme apo e sëmurë?”.

Argumenti im është se arsyeja kryesore pse kulturat e ungjillëzimit nëpër kisha janë të sëmura nuk është se kemi frikë nga njeriu ose se nuk kemi strategjinë apo metodën e duhur të ungjillëzimit — pavarësisht se këto janë gjëra të rëndësishme — por se nuk e kuptojmë kishën.

DEVIJIMI NJË A DY GRADË TË ÇON SHUMË LARG VENDMBËRRITJES

Një nga gëzimet e mia më të mëdha, teksa drejtoja një udhëtim afatshkurtër për studentë në Kenia, ishte që po fluturonim me avionin e një piloti misionar, i cili na ndihmoi në programin tonë. Pete-i kishte qenë pilot që nga koha kur nuk ekzistonte GPS-i [sistemi global i pozicionimit], koha kur pilotët navigonin me një busull dhe me gjykimin e tyre.

Pete-i i çonte studentët tanë në vendet më të thella për detyrat e tyre. Ndonjëherë kishte një vend të lirë në avion dhe unë shkoja me ta. Pasi i zbrisnim studentët, unë bëhesha bashkëpiloti i tij. Pete-i e ngrinte avionin në ajër, e nivelonte atë dhe më jepte mua të dhënat e busullës. Kështu, unë e drejtoja avionin përmes luginës “Great Rift”, mbi rezervatin “Masai Mara” dhe rreth Malit Kenya, i cili ngrihej si një kullë e lartë teksa ne fluturonim me avion përkrah tij. Pete-i kënaqej duke më treguar vende të ndryshme dhe unë e shijoja së tepërmi peizazhin. Çfarë gëzimi!

Fluturimi, në fakt, nuk është dhe aq i vështirë. Zbritja është e vështirë, prandaj këtë pjesë e bënte Pete-i. Puna ime ishte

thjesht që ta mbaja avionin në lartësinë e duhur dhe ta drejtoja nga më çonte busulla. Përgjithësisht unë fluturoja në drejtimin e duhur, por zor se e bëja këtë gjë në mënyrë të shkëlqyer. Me raste Pete-i e kontrollonte drejtimin e busullës dhe dukej i bezdisur. Ai tregonte me gisht mbi xhamin e busullës dhe thoshte ashpër: “Po shmangesh nga drejtimi.” Mendova se po bënte të vështirën derisa Pete-i tha: “Mack, duhet të kuptosh, devijimi dy gradë na çon në një vend tjetër.”

Është e vërtetë. Kur shohim një hartë të globit, me lehtësi mund të dallojmë problemet e mëdha që mund të rezultojnë nga devijimet e vogla në drejtim. E njëjta gjë është e vërtetë edhe në kishë.

Problemi thelbësor me pyetjen në Kishën Baptiste High Pointe nuk ishte se ajo grua nuk kuptonte ungjillëzimin; problemi ishte se ajo nuk kuptonte kishën. Ajo nuk kishte devijuar vetëm disa gradë, por ato gradë e kishin çuar në një vend tjetër. Të kuptuarit e kishës na ndihmon të kemi drejtimin e duhur të busullës për ungjillëzimin. Prandaj, së pari, kemi nevojë që të mendojmë për kishën dhe se çfarë e bën atë të jetë e shëndetshme.

PËRKUFIZIMI I KISHËS

Le të themi se keni shkuar për të bërë pazar në një qendër tregtare dhe dikush me një bllok dhe laps në dorë ju pyet: “Ju lutem, më përkufizoni ‘kishën’ sa më mirë që të dini.” A do të mund të përgjigjeshit? Nëse personi do t’ju bënte një pyetje të dytë: “Cilët janë përbërësit e domosdoshëm dhe të mjaftueshëm për një kishë?”, a do të ngrinit në vend?

Nëse është kështu, nuk jeni të vetmit. Unë kam jetuar me

misionarë dhe i kam vizituar ata përreth botës për disa dekada. Shumë nga këta njerëz e quajnë veten kishëmbjellës. Ata janë njerëz të mahnitshëm dhe të mrekullueshëm, e megjithatë, unë jam po aq i mahnitur për faktin se sa pak prej tyre janë në gjendje për ta përkufizuar një kishë nga ana biblike. Kur ata e shpjegojnë kishën, përkufizimet e tyre bazohen mbi ndjenjat e tyre dhe mbi strategjitë njerëzore.

Më pëlqejnë shumë kishat e rrjetit “Acts 29”;¹ do të doja të kishte më tepër të tilla. Por, fatkeqësisht, ajo që shohim në shumë vende rreth botës nuk janë kishat e rrjetit “Acts 29”, por kisha të cilat unë do t’i quaja kisha “Gjyqtarët 22”: kisha të cilat bëjnë atë që u duket e drejtë në sytë e tyre (Gjyqtarët 21:25). Në vend të tyre kemi nevojë për kisha që janë rrënjësor fort në Shkrimet e Shenjta.

Isha dikur me një misionar i cili po udhëhiqte një ekip kishëmbjelljeje në Rusi. Ai ishte dhe vazhdon të jetë një vëlla i mrekullueshëm në Krishtin. Është thellësisht i përkushtuar ndaj punës së ungjillit dhe ka një zemër shërbëtori dhe sakrifikuese. Për më tepër, ai është një udhëheqës që i ndikon së tepërmi njerëzit me të cilët punon. Kur ai më tha se thirrja e tij parësore ishte të mbillte kisha, u ngazëllova. Por teksa po i bëja pyetje për kishën, dukej sikur ai nuk e kishte idenë se në çfarë drejtimi të shkonte. Në fund, në zhgënjim e sipër ai tha: “E po, dakord, si e përkufizon ti një kishë?”

“E po”, i thashë unë, “përbërësit thelbësorë të një kishe kuptohen më mirë në tri kategori: çfarë është kisha, çfarë bën kisha dhe cili është misioni i kishës.” Atë ditë folëm deri natën vonë për kishën. Me pak fjalë, ja se çfarë i thashë atij.

Besimi i krishterë nuk njih ndonjë kategori për besim-

tarët që nuk janë anëtarë të një bashkësie vendore. Kisha nuk është dhe kurrë nuk ka qenë me zgjedhje për besimtarët.² Pavarësisht nga fakti që kisha luan një rol shumë themelor në dishepullimin tonë, anëtari i zakonshëm i kishës ka një larmi të jashtëzakonshme idesh për faktin se çfarë duhet të jetë ajo — ide të cilat nuk janë të rrënjosura në Bibël.

Sigurisht që kishat kanë lirinë të bëjnë shumë gjëra. Kishat janë të lira të ngrenë ndërtesa ose të takohen në salla të marra me qira, ta lejojnë bashkësinë të ulet në radhë me stola ose në dysheme. Ato, gjithashtu, janë të lira që, nën autoritetin e Fjalës së Perëndisë, të krijojnë strategji të veçanta për t'i përmbushur urdhërimet e shumta biblike. Prandaj, ato janë të lira që të sigurojnë shërbesa muzikore, të sponsorizojnë kuzhina për nevojtarët, të organizojnë takime lutjeje për burrat, të administrojnë shkolla të krishtera ose të zhvillojnë grupe të vogla.

Megjithatë, cilët janë përbërësit thelbësorë, ato gjëra që janë të domosdoshme dhe të mjaftueshme? Nëse hiqni tej çdo gjë shtesë, cilët janë përbërësit e domosdoshëm të një kisha? Kjo është e lehtë për t'u zbuluar në shumë pika. Për shembull, hiqini shkollat e krishtera dhe ende keni kishë. Por nëse hiqni predikimin e rregullt të Fjalës së Perëndisë — nuk keni më një kishë.

Çdo i krishterë duhet ta dijë se çfarë e bën kishën të jetë kishë. Një përgjigje biblike se çfarë e bën kishën të jetë kishë është jashtëzakonisht e thjeshtë, të paktën në letër.

Çfarë është kisha

Një kishë vendore është një mbledhje e të krishterëve të rilindur dhe të pagëzuar, të cilët kanë lidhur besën bashkë në dashuri, për t'u takuar rregullisht nën autoritetin e Shkri-

UNGJILLËZIMI

meve të Shenjta dhe nën udhëheqjen e pleqve, për ta adhuruar Perëndinë, për të qenë një shenjë e dukshme e ungjillit dhe, përfundimisht, për t'i dhënë lavdi Perëndisë (Gjoni 3:1–8; 13:34–35; Veprat e Apostujve 2:41; 14:23; Efesianëve 3:10; Kolosianëve 3:16; II Timoteut 3:16–17; Hebrenjve 10:24–25).

Çfarë bën kisha

Një kishë vendore duhet të bëjë vetëm disa gjëra për të qenë një kishë: njerëzit mblidhen rregullisht në dashurinë e ungjillit për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë që predikohet, për të kënduar, për t'u lutur, për të dhuruar dhe për të praktikuar sakramentet e pagëzimit dhe të Darkës së Zotit. Anëtarët, ata që kanë lidhur besën bashkë, kujdesen me dashuri për njëri-tjetrin (I Korintasve 12:12–26), madje edhe përmes praktikës së disiplinës së kishës (Mateu 18:15–17)

Misioni i kishës

Kisha është plani strategjik i Perëndisë për ungjillëzim me një mision madhor: të shkojë në të gjithë popujt e botës dhe të bëjë dishepuj, duke i mësuar ata t'i binden gjithçkaje që Krishti na ka urdhëruar — ku përfshihet edhe formimi i kishave të reja (Mateu 28:18–20).

Ja ku e keni: katër fjali për kishën të cilat i shkrova në më pak se një faqe, por që na duhet një jetë e tërë për t'i jetuar. Mirëpo ky përkufizim lë jashtë atë që shumë njerëz mendojnë se është kisha. Ajo nuk është një ndërtesë; nuk është as thjesht një mbledhje sociale e besimtarëve. Kërkohet një përkushtim ndaj njëri-tjetrit në një komunitet vendor. Kisha nuk i bën

qëllimisht jobesimtarët anëtarë të saj. Vetëm ata që janë pagëzuar duhet të jenë anëtarë.

Kisha nuk është një tryezë idesh të mira për të jetuar mirë, por një bashkësi e nënshtruar ndaj Fjalës së Perëndisë.

NJË KISHË E SHËNDETSHME

Tani që sapo e kemi përkufizuar kishën, le të shohim se çfarë është një kishë e shëndetshme.

Është e rëndësishme të themi se shenjat e mësipërme nuk përshkruajnë një kishë të përsosur, gjë që nuk ekziston këtu mbi tokë. As nuk po përpiqemi të bëjmë dallimin mes një kishe të vërtetë dhe një kishe të rreme. Përkundrazi, ne duam të bëjmë dallimin mes kishave të vërteta që janë të sëmura dhe kishave të vërteta që janë të shëndetshme, dhe dëshirojmë që t'i ndihmojmë kishat e sëmura të rifitojnë shëndetin.³

Ka mënyra të shumta se si të krishterët mund t'i shpërfillin themelet bazë të një kishe të shëndetshme:

- Fjalimet motivuese mund të zënë vendin e predikimit të Fjalës së Perëndisë. Nëse predikimi ka të bëjë me mendimet e mira për ditën ose me të jetuarit e një jete të moralshme — apo akoma më keq, një jete të begatë — dhe nuk flasin për Biblën, njerëzit nuk do t'i kuptojnë Perëndinë dhe udhët e tij.
- Kthimi në besim mund të bëhet diçka e paqartë, e papërcaktuar dhe subjektive, që do të thotë se njerëzit që nuk janë të krishterë bëhen anëtarë. Kur kjo gjë ndodh, kisha nuk mund ta praktikojë ungjillëzimin biblik.
- Anëtarësia mund të shihet si diçka me zgjedhje. Megjithatë, unë nuk mund t'i dua njerëzit — përtej dashurisë teorike dhe të romantizuar — nëse nuk e di se kush janë ata. Duhet të përkushtohem ndaj tyre dhe ata ndaj meje.

UNGJILLËZIMI

- Jobesimtarëve mund t'u jepen pozita udhëheqjeje në një kishë. A ka nevojë të them ndonjë gjë më tepër rreth kësaj? Megjithatë, kjo ndodh rregullisht, sidomos në kishat që nuk kanë anëtarësi.
- Gjërat e vështira mund të mbeten pa u bërë. Shumë shpesh nuk u tregojmë dashuri njerëzve që nuk na pëlqejnë. Ose dështojmë të praktikojmë disiplinën e kishës me njerëzit që na pëlqejnë.

Secila nga këto praktika mund të mos na duket si ndonjë gjë e madhe, por nëse një kishë bie pre e ndonjërës prej këtyre, shumë shpejt do të jetë duke fluturuar në drejtim të *kundërt* me orientimin e busullës së saj. Këtu rreziqet janë shumë të larta, sepse ndonjëherë njerëzit me qëllime të mira bëhen udhëheqës të verbër dhe riprodhojnë kisha sipas “Gjyqtarëve 22”. Ajo që i përkeqëson edhe më tepër gjërat është që kur themelet janë shkatërruar dhe kisha bëhet e pashëndetshme, lavdia e Perëndisë mbulohet me vel. Kështu, ajo që duhet të jetë bukuria e komunitetit të Krishtit si dëshmi para botës që sheh, humbet.

Kemi nevojë të prekim edhe një problem tjetër serioz që e bën kishën të jetë e sëmurë dhe ndikon drejtpërdrejt në kulturën e ungjillëzimit. Ky problem shfaqet kur anëtarët e ngatërronjë bindjen e tyre personale në ungjillëzim me rolin e kishës.

PËRPARËSITË PERSONALE, PËRPARËSITË E KISHËS DHE KUTITË E DHURATAVE

Në një kulturë të shëndetshme ungjillëzimi kuptohet që ka një dallim mes përparësisë së kishës dhe përparësisë së individit. Diçka të cilën ti duhet ta bësh personalisht në ungjillëzim, mund të mos jetë gjëja më e mirë për t'u bërë nga e

gjithë kisha. Kjo është arsyeja themelore e përgjigjes sime ndaj pyetjes që m'u bë lidhur me ungjillëzimin në Kishën Baptiste High Pointe.

Ja një shembull për të treguar se çfarë dua të them. Pastor Jacky është një miku im i cili punon me një kishë në Dubai, e cila flet në gjuhën kineze. Ai ka bërë një punë të mahnitshme mes kinezëve të varfër të cilët vijnë në Dubai si punëtorë. Një vit, diku afër Krishtlindjes, disa perëndimorë me zemër të mirë patën idenë që t'u shpërndanin kuti dhuratash punëtorëve. Sigurisht që këtu nuk ka asgjë të gabuar. Kështu, familjet në kishat e Dubait përgatitën kutitë e dhuratave, në të cilat vendosën sapunë dhe peshqirë të vegjël për të larë trupin, parfum, krehra, bashkë me disa artikuj të tjerë për higjienën personale, si dhe disa veshje të vogla. Ata vendosën edhe fletëpalosje për takimet e kishave dhe i mbështollën kutitë me fjongo për Krishtlindje. Sërish, këtu nuk ka asnjë problem.

Pastaj rekrutuan njerëz për t'i mbledhur kutitë dhe — këtu qëndron problemi — për t'ia dorëzuar ato Jacky-t. Më kujtohet që kalova nga zyra e Jacky-t dhe nuk kisha mundësi të hyja brenda, për shkak të gjithë atyre kutive të dhuratave të stivuara nga dysHEMEJA në tavan.

Lërinin mënjane pyetjet në lidhje me bazat biblike për ungjillëzimin dhe se sa e efektshme ishte kjo; lërinin mënjane pyetjet në lidhje me dobinë afatgjatë apo se çfarë po komunikonin perëndimorët duke u dhënë artikuj të higjienës personale punëtorëve të varfër. Çështja themelore ishte që Jacky nuk mund të përgatiste dot predikimin e tij. Ai nuk mund të takohej dot me njerëz që donin të flisnin me të në lidhje me Jezusin. Ai nuk mund ta përmbushte dot shërbesën e tij dhe t'i

pajiste anëtarët e kishës për shërbesën e tyre, pasi njerëzit nuk e kuptuan që roli i tyre ishte të ungjillëzonin dhe roli i Jacky-t ishte që të predikonte, të përkujdesej dhe të lutej. Njerëzit e ngatërruan rolin e tyre në kishë me rolin e kishës.

Le të themi se shërbesa e dhuratave arriti gjënë më të mirë të mundshme dhe njerëzit erdhën te kisha kineze. Kur erdhën, me çfarë lloj kishe shpresoni se u ballafaquan? Me një kishë të shëndetshme ku e dëgjuan ungjillin të predikohej nga Fjala e Perëndisë, ku anëtarët ishin të disiplinuar dhe ishin “të përfshirë” në ungjillëzim, ku ungjilli u paraqit në pagëzim, në Darkën e Zotit dhe në shumë gjëra të tjera? Apo u ballafaquan me një kishë të sëmurë, ku udhëheqësit e kalonin gjithë kohën e tyre duke shpërndarë kuti dhuratash?

Nëse Jacky do ta kalonte të gjithë kohën e tij duke shpërndarë kuti dhuratash dhe jo duke iu kushtuar punës që i ishte caktuar për të ushqyer një kishë të shëndetshme, do ta linte kishën si një tokë djerr. Kjo është e vërtetë jo vetëm për Jacky-n, por edhe për çdo plak kishe. Anëtarët janë të lirë të bëjnë shumë gjëra të tjera, por ata duhet të tregojnë kujdes që ta mbështesin udhëheqjen, në mënyrë që kisha të shkojë në drejtimin e duhur.

Besimtarët që kishin qëllim të mirë në Dubai, nuk e bënë dallimin mes përgjegjësisë së kishës dhe përgjegjësisë së tyre. Ata besuan se kisha duhet të shkojë te punëtorët në të njëjtën mënyrë siç dëshironin ata që të shkonin personalisht. Duke vepruar sipas këtij supozimi, ata, në fakt, e dobësuan kishën.

Një shembull biblik i kësaj çështjeje gjendet te Veprat e Apostujve 6, ku mësojmë se vejushat greke ishin lënë mënjanë në shpërndarjen e përditshme të ushqimit nga ana e kishës.

Mund të dyshojmë që vejushat hebreje po e merrnin ushqimin për shkak se kishin lidhjet e tyre judease, të cilat vejushat greke nuk i kishin. Megjithatë, kjo situatë kishte nevojë për vëmendje. Prandaj, apostujt u kërkuan *anëtarëve të shqetësuar* të zgjidhnin shtatë burra të perëndishëm për ta trajtuar këtë rast.

Të gjithë këta burra ishin grekë, sikurse vërtetohet nga emrat e tyre, dhe kjo ishte një mënyrë e sigurt për t'i dhënë fund mbajtjes me hatër ose racizmit. Megjithatë, vini re arsyen pse apostujt e trajtuan këtë padrejtësi ashtu siç e bënë. Ata thanë:

...“Nuk është e pëlqyeshme që ne, duke lënë *mënjatë* fjalën e Perëndisë, të shërbejmë në tryeza. Por, vëllezër, përzgjidhni prej *mesit* tuaj shtatë burra që kanë dëshmi të *mirë*, të mbushur me Frymën dhe me urtësi, të cilët do t'i caktojmë për këtë nevojë. Ndërsa ne do t'i përkushtohemi lutjes dhe shërbimit të fjalës”.

(Veprat e Apostujve 6:2-4)

Prandaj, çdo anëtar i kishës iu bë thirrje të çohet dhe ta zgjidhte vetë problemin, që kështu të mbrohej shërbesa parësore e udhëheqësve të kishës: shërbesa e Fjalës së Perëndisë dhe lutjes.

Anëtarët e kishës duhet t'i kuptojnë përparësitë që apostujt i mbrojtën. Edhe pse ka shumë gjëra të rëndësishme që trupi i kishës mund t'i bëjë — po aq të rëndësishme sa edhe të ushqyerit e vejushave — asgjë nuk duhet ta pengojë thirrjen parësore të kishës: predikimin e Fjalës së Perëndisë. Si anëtarët, ashtu edhe pastorët duhet të dalin përkrah njëri-tjetrit dhe ta mbrojnë thirrjen unike dhe parësore të kishës.

SI LIDHET NJË KULTURË E SHËNDETSHME UNGJILLËZIMI ME NJË KISHË TË SHËNDETSHME

Pra, si funksionon një kulturë e shëndetshme ungjillëzimi? Ja një shembull:

Abigaili, një nënë që punon me kohë të plotë, ishte ulur në autobus për në Washington, D. C., nga aeroporti “Dulles”. Kishte qenë udhëtim i gjatë nga një funeral në Teksas, dhe ajo mezi po priste të ishte bashkë me familjen e saj. Ajo ishte ulur pranë një vajze të re aziatike. Por, në vend që të zhytej në një libër, ajo nisi një bisedë.

Emri i vajzës ishte Van-a. Teksa po flisnin, Van-a i tha Abigailit se sapo kishte ardhur nga Kina, dhe këto ishin orët e saj të para në Amerikë. Abigaili e dallonte kur ishte në një takim hyjnor. Ajo donte ta ndihmonte Van-ën, por e dinte gjithashtu se duhej të tregohej e ndjeshme.

Teksa i mendonte gjërat që po ndodhnin në kishën e saj, iu kujtua që shumë shpejt do të kishin dasmën e një çifti besimtarësh të fortë. Ajo e dinte se aty do të prezantohej ungjilli. Kisha i inkurajon të gjithë anëtarët të vijnë dhe të sjellin miq, për të dëgjuar dëshminë e një dasme. Prandaj, Abigaili e pyeti: “A ke dëshirë të vish në një dasmë të krishterë?”. Van-a e pranoi menjëherë mundësinë. Ato shkëmbyen adresat e email-it dhe Abigaili i tha Van-ës se do ta merrte me makinë.

Vini re se Abigaili kishte besim në një kulturë të shëndetshme ungjillëzimi. Nuk kishte pse të telefononte pastorin dhe t’i bënte presion stafit, që të fillonin një program për ungjillëzimin e kinezëve. Ajo nuk kishte pse ta vriste mendjen nëse ungjilli do të ishte apo jo i qartë në dasmë. Në një kishë me kulturë të shëndetshme ungjillëzimi, ungjilli i përshkon

të gjitha shërbesat. Abigaili zgjodhi një dasmë, por ajo mund ta kishte ftuar Van-ën në çfarëdolloj takimi tjetër.

Sigurisht që kështu ndodhi, dasma u fokusua po aq shumë te Dhëndri i qiellit, sa edhe te dhëndri dhe nusja mbi tokë. Por gjëja më e mirë që ndodhi, pasi përfundoi shërbesa dhe filloi koha e mikpritjes, ishte që Abigaili e nxori fëmijën e saj katërvjeçar në këndin e lojërave të kishës dhe Van-a shkoi me ta. Van-a nisi të bënte pyetje se çfarë e bënte të ndryshme një dasmë të krishterë nga një dasmë laike. Abigaili, duke qenë e mësuar mirë në lidhje me mesazhin e ungjillit, e shfrytëzoi mundësinë për t'ia shpjeguar Van-ës gjithë ungjillin përmes asaj që ndodhi në dasmë.

Pastaj Abigaili e pyeti Van-ën nëse dëshironte të kishte një Bibël. Përderisa kisha siguronte Bibla për studentët ndërkom-bëtarë në raftin e librave, të dyja u kthyen brenda dhe Abigaili i dha Van-ës një Bibël në gjuhën mandarine, dhe kjo ishte Bibla e parë që Van-a kishte parë në jetën e saj. Pastaj Abigaili i ofroi Van-ës që të takoheshin dhe të lexonin Biblën së bashku, dhe këtë bënë. Abigaili madje ftoi disa anëtarë të kishës të cilët flisnin mandarinisht, që të takoheshin me Van-ën dhe të tregonin dëshmitë e tyre gjatë takimeve për leximin e Biblës. Kur ata e bënë këtë, Van-a u prek thellë dhe bëri disa pyetje shumë të mira.

Abigaili dhe Van-a vazhduan ta lexonin Biblën dhe të flisnin për ungjillin derisa Van-a u largua për të studiuar në Boston disa javë më vonë. Mirëpo për Abigailin nuk mbaroi me kaq. Ajo kishte një shoqe në Boston, e cila vazhdoi ta lexonte Biblën me Van-ën. Kjo po vazhdon të ndodhë edhe tani që jam duke shkruar këto fjalë.

UNGJILLËZIMI

Abigaili nuk priti që kisha të bënte diçka. Ajo madje as që e mendoj një gjë të tillë. Ajo besoi se kisha do të jetonte në përputhje me identitetin e saj. Ajo u mbështet në fuqinë e ungjillit dhe i besoi Frymës së Shenjtë që të punonte përmes hapave të saj besnikë si ambasadore e Krishtit.

Kështu funksionon një kulturë ungjillëzimi në kishë. Ajo nuk bie në sy, nuk është një program, por është shumë më e mirë.

UNGJILLTARË TË QËLLIMSHËM NË NJË KULTURË UNGJILLËZIMI

Kelly, një gjashtëmbëdhjetëvjeçare, udhëtoi nga vendi i saj Brazili për të kryer shkollën e mesme në Portland të Oregonit. Connie dhe John-i, prindërit mikpritës amerikanë të Kelly-t, ishin njerëz të këndshëm dhe gazmorë që frekuentonin rregullisht një kishë me ungjillin në qendër. Kelly ishte një studente e mirë dhe, duke qenë se vinte nga një sfond japonez/brazilian, ndihej rehat me kultura të ndryshme, prandaj u ambientua kollaj në shkollën e mesme në Portland.

Connie dhe John-i u lutën për Kelly-n dhe e morën atë në kishë, por Kelly nuk dukej e interesuar për besimin e krishterë. Megjithatë, John-i dhe Connie u bënë shumë të dashur për Kelly-n. Prandaj, pasi ajo u kthye në shtëpinë e saj, ata i mbajtën lidhjet. Connie u lut për të gjatë viteve — vite të cilat nga pesë u bënë dhjetë dhe pesëmbëdhjetë.

Kohët e fundit, Leeann-ës dhe mua na u kërkua të flisnim në kishën e John-it dhe Connie-t, në Kishën Baptiste Hinson. Gjatë drekës pas shërbesës, Connie rastisi që u ul pranë

Leeann-ës. “Shumë kohë më parë”, i tha Connie Leeann-ës, “pritëm në shtëpi një studente të quajtur Kelly, e cila tani punon si stjuardesë me shoqërinë ajrore “Emirates”. Ajo është një vajzë shumë e dashur.” (Pavarësisht se tani ajo ishte një grua e rritur.) “Ajo jeton në Dubai. A mendon se mund të lidhesh me të? Ajo ndihet e vetmuar, pasi nuk ka shumë që është ndarë nga i dashuri.”

Leeann-a e kontaktoi Kelly-n me shumë kënaqësi, por ne do të ktheheshim në Dubai pas disa javësh. Prandaj, Connie dhe Leeann-a i shkruan të dyja Kelly-t dhe i treguan për kishën tonë, “Redeemer”. Me rekomandimin e Connie-t, Kelly e gjeti kishën “Redeemer” dhe shkoi atje para se të kthehej Leeann-a.

Kur Kelly hyri brenda, u përshëndet menjëherë nga Hetty, nga Filipinet, e cila qëndronte pranë tryezës së mikpritjes, dhe nga Kanta, nga India, te stenda e librave. Kelly dëgjoi teksa pas-tor Dave-i predikoi ungjillin dhe zemra iu ngroh çuditshëm. Më pas, Hetty dhe Kanta (të cilat nuk e dinin që ne e kishim kontaktuar Kelly-n gjatë udhëtimeve tona në Shtetet e Bashkuara) e ftuan atë për drekë. Kur Kelly u kthye në shtëpi, hapi çantën e mikpritjes nga kisha dhe aty gjeti dy libra: *Jeta me kryqin në qendër* (*The Cross Centered Life*) nga C. J. Mahaney dhe *Dy mënyra për të jetuar* (*Two Ways to Live*), një shpjegim i ungjillit nga Philip Jensen dhe Tony Payne. Ajo i përpiu të dy librat. Më vonë Hetty dhe Kanta e ftuan atë në një grup të vogël të studimit të Biblës, ku e mikpritën me shumë ngrohtësi.

Kur Leeann-a u kthye në Dubai, ajo dhe Kelly hëngrën një drekë bashkë. Kelly i tregoi Leeann-ës për jetën e saj dhe se sa shumë e donte kishën. Ajo i tha: “Dëshiroj të jem anëtare.” Pastaj e pyeti: “A ka kuota anëtarësie që duhet të paguaj?”

Leeann-a buzëqeshi dhe i tha: “Jo, nuk ka kuota anëtarësie për kishën tonë, por ka diçka shumë të rëndësishme të cilën duhet ta kuptosh në lidhje me të qenët anëtare. Ka të bëjë me diçka të cilën ne e quajmë ungjilli.”

“Oh, atëherë ma trego këtë ungjill”, i tha Kelly.

Kontinente të shumta, disa kisha, qytete të ndryshme, shumë gjuhë të ndryshme, etni të panumërta, personalitete të larmishme, vite të tëra lutjesh, komunikim gojor dhe me shkrim, dy dreka — një ungjill. Kur e pagëzova Kelly-n në pishinën e hotelit ku i bën kisha jonë pagëzimet, nuk kisha se si të mos qaja nga gëzimi për gjithçka që kishte orkestruar Perëndia për Kelly-n, bijën e tij të dashur.

Kelly ishte ajo që nuk e kishte fare idenë se Perëndia po orkestronte njerëz dhe ngjarje për ta sjellë atë pranë vetes së tij. Mirëpo tani ajo e dallon këtë gjë. Në fakt, ajo është bërë pjesë e ekipit të mikpritjes në kishë, pasi e tregon qartë se do që t’u afrohet atyre që nuk e njohin Perëndinë. Kohët e fundit Kelly takoi dy stjuardesa nga Brazili, të cilat erdhën në kishë për herë të parë. Kush e di se si ka punuar Perëndia në jetët e tyre për t’i sjellë deri në këtë pikë? Kush e di se çfarë mund të bëjë Perëndia?

Në një kulturë ungjillëzimi, njerëzit që e duan Jezusin punojnë bashkë si instrumente në simfoninë e veprës së Perëndisë. Nuk e dimë gjithmonë se cila do të jetë pjesa tjetër që do të luajmë — këtë e orkestron Fryma e Shenjtë. Mirëpo, nëse jemi të përqendruar tek ai dhe drejtimi i tij, do të jemi pjesë e punës së tij në jetët e njerëzve.

Është shumë e lehtë të luash melodinë që i pëlqen audiencës, në vend që të ndjekësh dirigjentin. Mbani mend, diri-

UNGJILLËZIMI

gjenti është Zoti. Tregohuni të qëllimshëm në ungjillëzim: ndiqni drejtimin e Krishtit. Ka shumë mënyra për t'u shpërqendruar dhe për të stonuar. Por në kulturën e ungjillëzimit që po piquet, njerëzit besojnë se Perëndia do të bëjë diçka më të madhe se ajo që shohin me sytë e tyre fizikë.

PJESË TË NDRYSHME, I NJËJTI SYNIM

Në një kulturë ungjillëzimi, ne u bëjmë thirrje besimtarëve të ecin me besim dhe të jenë të hapur ndaj punës së Perëndisë në njerëzit përreth tyre. Si pjesë e kësaj thirrjeje, anëtarët e kishës duhet të përqafojnë një pikëpamje afatgjatë. Njerëzit rreth Kelly-t besuan se Perëndia mund të punonte përmes tyre teksa ata ecnin me Krishtin. Prandaj, le të mendojmë për njerëzit e ndryshëm që u përfshinë në historinë e saj dhe të shohim se çfarë mund të mësojmë nga këta shembuj.

Connie nuk hoqi dorë nga miqësia me kalimin e kohës, por vazhdoi të lutej dhe po priste për një mundësi. Mundësia erdhi, edhe pse u deshën pesëmbëdhjetë vjet. Mos u mashtroni nga mendimi se njerëzit janë ata që duken. Mos e besoni këtë as edhe për një çast. Ne po u sjellim fjalët e jetës atyre që janë të zhytur në dëshpërim dhe duke vdekur, nuk ka rëndësi se si duken ata nga jashtë. Prandaj, lutuni dhe rrini zgjuar, personalisht dhe bashkërisht.

Kanta dhe Hetty nuk e shihnin veten si ungjilltare, por, në fakt, ishin. Ato u treguan ungjilltare disi të “kamuflluara”, të mirësjellshme dhe të kujdesshme, të cilat kishin mbathur këmbët me gatishmërinë e ungjillit (Efesianëve 6:15).

Pastor Dave-i e predikoi ungjillin me besnikëri, sikurse e bën javë pas javë. Njerëzit në bashkësi e dinë se kur sjellin

miqtë dhe anëtarët e familjes së tyre në kishë, ata do ta dëgjojnë ungjillin. Dave-i shpesh thotë nga podiumi: “Dua që, ju që jeni këtu me ne sot dhe vini nga sfonde të tjera besimi, ta dini se jemi shumë të gëzuar që keni ardhur. Ju inkurajoj të flisni në lidhje me predikimin me mua ose me një nga pleqtë tani, ose me njerëzit që ju sollën në kishë.”

Grupi i vogël i studimit të Biblës ku shkoi Kelly ishte një vend i ngrohtë dhe personal për të shqyrtuar Shkrimet.

Leeann-a nuk e shpërfilli mundësinë që iu paraqit. Do të kishte qenë e lehtë të mendonte se një marrëdhënie pesëmbëdhjetëvjeçare do të përfundonte si një rrugë pa krye, dhe nuk do t’ia vlente mundimi për të harxhuar kohën e saj. Mirëpo Leeann-a ishte pajisur për ta shpallur ungjillin, dhe pastaj për të shkuar më thellë duke bërë pyetje.

Askush nuk i kërkoi Kelly-t të bënte diçka të papranueshme. Nuk u përdorën teknika me trysni të lartë. Në një pikë të caktuar, kur Leeann-a po fliste me Kelly-n, Leeann-a konfirmoi se Kelly e kishte kuptuar dhe ia kishte kushtuar veten e saj ungjillit. Mirëpo, nëse do ta pyesnit Kelly-n se kush e udhëhoqi te Krishti, ajo mund të pështjellohej nga pyetja. Ajo mund të thoshte “Fryma e Shenjtë” ose “disa njerëz”.

Në një kulturë ungjillëzimi, synimi është që të gjithë të flasin, të luten dhe t’i shfrytëzojnë mundësitë ashtu siç u vijnë. Ne mund t’i sfidojmë njerëzit që të kthehen në besim, por nuk ka udhëzime në Besëlidhjen e Re për një lutje të mëkatarit. Ne i besojmë Perëndisë që t’i sjellë mëkatarët në pendim. Përgjegjësia jonë është të jemi dëshmitarë besnikë — së bashku.

Si mund të jemi pjesë e një kulture të gjallë ungjillëzimi si kjo? Si mund të bëhemi ungjilltarë të qëllimshëm që jetojnë

UNGJILLËZIMI

në kultura të qëllimshme ungjillëzimi? Çfarë lloj platformash kemi nevojë të krijojmë, që të jemi të përgatitur për ta shpallur ungjillin? Mendoj se ka gjashtë të tilla:

1. Të përgatitim zemrat, mendjet dhe këmbët tona;
2. Të kuptojmë një stil jete të formuar nga ungjilli;
3. Të heqim qafe supozimet tona;
4. Ta shohim ungjillëzimin si një disiplinë;
5. Të lutemi;
6. Kur të jetë e mundur, të sigurojmë udhëheqje në ungjillëzim.

1. TË PËRGATITIM PËR UNGJILLËZIM: ZEMRAT, MENDJET, KËMBËT

Në librin tim të parë mbi ungjillëzimin, *Të flasësh për Jezusin (Speaking of Jesus)*, vura në pah se ka tri zona në të cilat kemi nevojë ta kontrollojmë veten në ungjillëzim: A jemi të motivuar? A jemi të pajisur? A jemi të disponueshëm? Këto tri pyetje na ndihmojnë të sigurohemi që zemrat, mendjet dhe këmbët tona, sipas këtij rendi, janë gati për të shpallur besimin.

Për shembull, dikush mund të ketë shumë miq jobesimtarë dhe të jetë i motivuar për ta shpallur ungjillin, por mund të ndihet i pasigurt në lidhje me mesazhin e tij. Nga ana tjetër, dikush mund të jetë shumë i zoti në lidhje me njohjen e mesazhit të ungjillit, por nuk njeh asnjë jobesimtar. Ose dikush mund të njohë ungjillin dhe shumë jobesimtarë, por mund të jetë i pandjeshëm ndaj realitetit frymëror të gjykimit të përjetshëm, me të cilin përballen ata miq pa Krishtin.

Me kalimin e viteve, teksa kam qenë me njerëz të cilët kanë menduar thellë në lidhje me skemën “i motivuar”, “i pajisur”,

dhe “i disponueshëm”, kam zbuluar se ekzistojnë dy kategori kryesore njerëzish të cilët ndihen të penguar në shpalljen e besimit të tyre. Kategoria e parë janë ata që e shmangin shpalljen e besimit të tyre për shkak të frikës. Ka shumë gjëra të cilave ata u tremben: nuk dinë se çfarë të thonë; kanë frikë nga refuzimi ose se mos duken si të pamend; ose kanë merak se mos i bëjnë njerëzit të mos ndihen rehat.

Kategoria e dytë janë njerëzit që janë të izoluar nga jobesimtarët. Ka një larmi arsyesh për këtë izolim: ndoshta janë tërhequr brenda nënkulturës së ngrohtë të krishterë; ndoshta stili i jetës së jobesimtarëve u duket ofendues; ose, më ironikja, ndoshta janë tepër të zënë me shërbesën.

Pyetja nëse jemi të motivuar, të pajisur dhe të disponueshëm, na ndihmon që të diagnostikojmë dëshminë tonë personale. Mirëpo këto janë kritere të dobishme për të diagnostikuar edhe kulturat tona të ungjillëzimit. Sapo të kemi bërë njëfarë diagnoze, mund të shohim disa kura të mundshme.

Zemrat e motivuara në kishë

Ashtu sikurse i ekzaminojmë zemrat tona për motivimin personal, edhe kishat duhet ta shqyrtojnë motivimin e tyre të përbashkët. Ja disa pyetje të cilat mund të jenë të dobishme:

- A po kultivon kisha jonë dhembshuri për ata që nuk e njohin Krishtin?
- A kanë anëtarët tanë nevojë që të inkurajohen kur zemrat e jobesimtarëve duken shumë të ngurta?
- A janë të bindur anëtarët tanë dhe gjithë komuniteti se ungjilli është ai që prodhon ndryshimin më të madh të zemrave, mendjeve dhe jetëve që ka njohur bota ndonjëherë?

Ndonjëherë i motivojmë pa dashje bashkësitë me mjete të forta si puna e fajit. Por ne duam që anëtarët e kishës të jenë të motivuar nga ajo që jepet mësim në Shkrim, në mënyrë që ata ta shohin rolin e tyre si ambasadorë të Krishtit, të cilët ndër-mjetësojnë mes dy palëve që janë në luftë me ofertën e paqes dhe pajtimit.

Mendje të pajisura në kishë

Kishat, gjithashtu, duhet të sigurohen që t'i pajisin anëtarët e tyre me ungjillin. Ato duhet t'i përdorin takimet e tyre për ta përsëritur ungjillin dhe për të menduar rregullisht për të — në të gjitha nivelet.

Ungjilli duhet të jetë i pranishëm në këngët tona. Nusja e djalit tim, Stephanie-a, më tha se në diplomimin e saj këndoi një këngë e cila shpesh këndohet në takimet e kishave — “Zoti i këtij qyteti”. Gjysma e shokëve dhe shoqeve të klasës së saj ishin myslimanë, dhe nuk e kishin problem ta këndonin këngën me qejf. Nëse njerëz nga sfonte të tjera besimi mund ta këndojnë *me qejf* një këngë në diplomimin e një shkolle laike, mund të jemi mjaft të sigurt që në atë këngë nuk ka pikë ungjilli.

“Zoti i këtij qyteti” është një këngë shumë e mirë — sigurisht që ajo është më e mirë se pjesa më e madhe e këngëve në kulturën popullore — por në të nuk ka pikë ungjilli.

Kur mendoj për fjalët e disa prej këngëve që kam kënduar në kishë gjatë viteve, dalloj se edhe në to nuk kishte fare ungjill. Ja pse jam mirënjohës që udhëheqësi i muzikës në kishën tonë është shumë i kujdesshëm për të zgjedhur këngë

që përqendrohen te mesazhi i kryqit. Ai dëshiron që ungjilli të shpallet përmes këngëve.

Ungjilli duhet të jetë i pranishëm edhe në të gjithë predikimin tonë. Një shoku im pastor erdhi tek unë pasi predikova në kishën e tij. Ai tregoi historinë se si një nga pleqtë i bëri komplimente për një nga predikimet e tij para disa muajsh dhe i tregoi për disa nga mënyrat në të cilat ishte sfiduar prej mesazhit. Por pastaj plaku i tha: “Shqetësimi im i vetëm është që nuk e dëgjova ungjillin.” Pastaj miku im pastor tha: “Dëshiroj të bëj për ty atë që ai bëri për mua. Mack, më pëlqeu predikimi yt. Nga ana teknike ishte i shkëlqyer. Por nuk jam i sigurt nëse dikush mund të kthehej në besim përmes fjalëve që the sot.” Kishte të drejtë dhe jam shumë mirënjohës për gatishmërinë që tregoi ai vëlla për të ma vënë në dukje mangësinë time. A i ndihmojnë predikimet tona njerëzit që ta shohin mëkatën e tyre dhe ofertën e shpengimit nga ana e Krishtit?

Ka edhe zona të tjera të jetës sonë të përbashkët që duhet të shqyrtohen. Lutjet tona publike duhet të shpallin që ungjilli është burimi i shpresës sonë në mes të shqetësimeve që çojmë përpara Zotit. Ne mund t'i afrohem fronit të tij me guxim, për shkak se Jezusi është Kryepriifti ynë (Hebrenjve 4:14-16). Ne mund të përfshijmë mësim për ungjillin në klasat tona të së dielës, në intervistat e anëtarësisë dhe në grupet e dishepullimit. Ne mund t'i sfidojmë anëtarët e kishës që të mësojnë një përvijim të thjeshtë të ungjillit dhe t'u tregojmë atyre se si ta tregojnë dëshminë e tyre. Mund t'u tregojmë për libra dhe fletëpalosje që e shpjegojnë ungjillin, botime të cilat besimtarët mund t'i lexojnë vetë ose, më mirë akoma, me jobesimtarë.

Këto gjëra nuk janë të vështira për t'u bërë, mirëpo mund të harrohen lehtë. Për t'i pajisur bashkësitë, është e rëndësishme që ungjilli të jetë tërësisht i pranishëm në të gjitha aspektet e jetës së kishës.

Këmbë të gatshme në kishë

Kishat mund të shqyrtojnë nëse janë kolektivisht në dispozicion të jobesimtarëve, thjesht duke pyetur nëse bashkësitë e tyre janë mikpritëse ndaj tyre.

Këtu duhet të tregohemi të kujdesshëm. Është e lehtë të kalosh nga të qenët një kishë mikpritëse në një kishë që e minon ungjillin me dëshirën e saj për të qenë “miqësore”. Fatkeqësisht, shumë kisha bien pre e kësaj herezie kur shqetësimi i tyre kryesor bëhen jobesimtarët, në vend të besnikërisë ndaj ungjillit. Shtegu më i shpejtë drejt herezisë dhe gabimit është ungjillëzimi “modern”. Motivet zemërmira që përpiqen t'i japin kishës formën që kërkojnë nevojat e njeriut dhe jo lavdia e Perëndisë janë vdekja e kishave biblike.

Kisha është thirrur për të qenë një komunitet me kryqin në qendër, i fokusuar tek ungjilli dhe që përlëvdon Perëndinë për lavdinë e Krishtit. Nuk mund ta harrojmë faktin që synimi i kishës është në Jezusin si Krishti dhe jo te kërkuesit dhe rehatia e tyre. Lëvizja e vjetër e orientuar drejt jobesimtarëve të interesuar për kishën dhe zëvendësueset e saj moderne i kanë kapur gjërat së prapi: kishat janë thirrur për t'u përqendruar në Perëndinë, ndërsa individët janë thirrur për t'u treguar të ndjeshëm ndaj jobesimtarëve të interesuar.

Prandaj, a po e inkurajojmë njëri-tjetrin individualisht për të qenë syhapur për jobesimtarët që marrin pjesë në takimet

tona? A jemi të përgatitur t'i mirëpresim ata dhe t'i ndihmojmë të kuptojnë se për çfarë bën fjalë një shërbesë e krishterë adhurimi? A po krijojmë miqësi të qëllimshme me ungjillin në mendje? Është shumë e lehtë dhe e rrezikshme të hamendësojmë se të gjithë në kishë janë të krishterë.

Disponueshmëria nuk ka të bëjë vetëm me lëvizjen e këmbëve tona për të qenë me jobesimtarët, por ka të bëjë edhe me shqyrtimin e “qëndrimit të mendjes”. Prija jonë është që t'u heqim vizë njerëzve në mendjen tonë: miqve për të cilët mendojmë se nuk do të tregojnë kurrë interes për krishterimin; kolegëve që duken si mëkatarë shumë të mëdhenj, “sikur kanë shkuar tepër larg”; ose anëtarëve të familjes që thonë se bisedat për “fenë tënde” janë të papranueshme. Kur filloj të mendoj kështu, kam nevojë për miq që të më kujtojnë se asnjë zemër nuk është tepër e ngurtë për Frymën e Shenjtë.

Prandaj, në një kulturë ungjillëzimi, ne mendojmë me kujdes për tri gjëra: si i motivojmë zemrat tona, si i pajisim mendjet tona dhe si i lëvizim këmbët për t'u hedhur në veprim.

2. BOTËKUPTIMI YNË I UNGJILLIT: VENDI QENDROR I UNGJILLIT

Kishat duhet ta trajtojnë ungjillin si një stil jete. Për një kulturë ungjillëzimi është thelbësore që ungjilli të ketë vend qendror.

Kur apostulli i përulur dhe i ri, Pali, e qortoi apostullin e madh dhe shtyllën e kishës, Pjetrin, do t'i jetë dashur shumë guxim (Galatasve 2:11-14). Në fund të fundit, Pjetri kishte ecur me Jezusin për tre vjet në Palestinë. Ai kishte predikuar mesazhin e hirit të Veprat e Apostujve 2, për të hapur kështu dyert e kishës së parë. Ai kishte treguar guxim në mes të Sine-

drit, po asaj gjykate e cila disa javë më parë e kishte dënuar Krishtin me vdekje.

Mirëpo, te Galatasve, Pali na thotë se frika nga njerëzit e bëri Pjetrin që të pengojë. Ai po rrëshqiste pas te ligji dhe po e harronte faktin që hiri i Perëndisë u ishte ofruar të gjithëve. Çështja, në shikim të parë, ishte tryeza e darkës, mirëpo Pali e dalloi kuptimin më të thellë. Veprimet e Pjetrit binin ndesh me drejtësimin vetëm me anë të hirit.

Kjo ngjarje te Galatasve është e rëndësishme për t'i ndihmuar të krishterët që ta kuptojnë hirin e Perëndisë për ne në Krishtin. Madje te Galatasve 2:5 Pali thotë se “grindja familjare” mes tij dhe Pjetrit e ruajti ungjillin.

Pali përdor një shprehje që është jashtëzakonisht e dobishme për të kuptuar se si ta mbajmë jetën tonë të përqendruar tek ungjilli. Pali thotë këtë për Pjetrin: “Por kur pashë se nuk po ecnin drejt sipas së vërtetës së ungjillit...” (2:14). Kjo frazë e shkurtër na hap një horizont të tërë për ungjillin. Ajo na thotë se ungjilli nuk është vetëm një mesazh shpëtimi, por edhe një stil jete.

Kam zbuluar se ndërkohë që e jetojmë ungjillin, shpallja e tij bëhet një pjesë edhe më e madhe e jetëve tona. Megjithatë, të jetuarit e ungjillit nuk është e njëjta gjë si të jetuarit e moralshëm. Në sipërfaqe këto duken të ngjashme; ndoshta kjo është arsyeja pse edhe apostulli Pjetër mund të ngatërrohej. Mirëpo përpjekja për të jetuar një jetë të moralshme është e pamundur. Kurse të jetuarit e një jete sipas ungjillit është dhuratë nga Perëndia.

Si ta jetosh ungjillin

Të thuash se duhet ta jetojmë ungjillin dhe të dish se si funksionon kjo gjë janë dy gjëra të ndryshme. Fatmirësisht, Bibla na tregon se si ta bëjmë këtë. Besëlidhja e Re merr një temë të ungjillit dhe e zbaton atë në jetët tona.

Disa mund të argumentojnë se gjithçka që po bën Pali është një zbatim i ungjillit. Kjo është mënyrë e mirë për t'i kuptuar letrat e Palit: ai predikon ungjillin, pastaj flet për rrjedhojat e ungjillit në jetët tona. Një "rrjedhojë" nuk është vetë mesazhi i ungjillit, por është diçka që rrjedh prej ungjillit. Për shembull, Pali na thotë se falja jonë ndaj të tjerëve është e lidhur me ungjillin: "...duke falur njëri-tjetrin... sikundër Krishti ju ka falur" (Kolodianëve 3:13, Bibla ABS, 2009). Stili ynë i jetës është i lidhur me ungjillin: "Vetëm jetoni si qytetarë në mënyrë të denjë për ungjillin e Krishtit..." (Filipianëve 1:27). Madje edhe mënyra se si punojmë në pozita autoriteti lidhet drejtpërdrejt me ungjillin:

Por Jezusi, si i thirri pranë, tha: "*Ju e dini se krerët e kombeve ushtrojnë zotërim mbi to dhe të mëdhenjtë ushtrojnë pushtet mbi to. Nuk është kështu ndër ju; përkundrazi, cilido që të dojë ndër ju për t'u bërë i madh, duhet të jetë shërbëtori juaj, dhe cilido që të dojë ndër ju për të qenë i parë, duhet të jetë skllavi juaj; sikurse Biri i Njeriut nuk erdhi për të qenë i shërbyer, po për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e vet si shpërblës në vend të shumë vetave". (Mateu 20:25-28)*

Prandaj, për të krishterët, mënyra se si falim, si jetojmë, si punojmë dhe udhëheqim, dhe, në fakt, gjithçka në jetët tona duhet të jetë e rrënjësuar në ungjillin.

UNGJILLËZIMI

Çfarë lidhje ka kjo me një kulturë ungjillëzimi? E po, ka shumë lidhje.

Ta kuptosh ungjillin si një stil jete, do të thotë të sigurohemi që jetët tona përputhen me ungjillin në çdo pjesë të tyre. Kjo e ndihmon ungjillin që të dalë nga ne qoftë kur jemi me besimtarë apo me jobesimtarë. Nëse jetojmë jetë që e kanë ungjillin në qendër, do të shohim se do ta shpallim atë. Nëse bashkësitë tona e dinë se si ta zbatojnë ungjillin në çdo fushë të jetës, ato do të shpërthejnë në ungjillëzim që realisht e ka ungjillin në qendër.

3. HEQJA QAFE E SUPOZIMEVE TONA

Hamendësimi i ungjillit është vdekjeprurës. Po e them këtë gjë me sa më shumë qartësi dhe sa më hapur që mundem. Kur ungjilli hamendësohet, ne fillojmë të mendojmë se të gjithë ata që vijnë në kishë janë të krishterë.

Pavarësisht se sa e pazakontë që mund të jetë kjo, shumë njerëz nëpër kisha sillen sikur kjo të ishte e vërtetë.

Ai hamendësim i gabuar na çon te hamendësimi tjetër: nuk ka pse ta shpallim, ta mësojmë apo ta predikojmë ungjillin. Me kalimin e kohës, pësjtjellimi në lidhje me ungjillin shtohet: veprimet e jashtme ngatërrohen me besimin e vërtetë të krishterë. Morali kthehet në një pritshmëri dhe jo në një reagim dashurie. Kryqi trajtohet thjesht si një shembull dhe jo si vendi unik ku u takuan zemërimi dhe dashuria e Perëndisë. Në fund, ungjilli humbet krejtësisht.

Kjo është fatkeqësi në komunitetin e krishterë. Ja pse Pali e udhëzoi Timoteun që ta ruante ungjillin dhe ta përcillte atë me shumë kujdes; ai e dinte se ungjilli mund të humbej.

Mos lejoni që supozimet tuaja ta vrasin dëshminë tuaj si komunitet — hiqini ato qafe që tani. Nëse e keni humbur interesin për ungjillin, keni nevojë t'i hidhni një vështrim ngultas mëkatit në zemrën tuaj. E thënë më saktë, nëse ungjilli nuk jehon në zemrën tuaj, kontrolloni dhe shihni nëse jeni vërtet të kthyer në besim.

Andrei erdhi në bashkësinë tonë si student i vitit të dytë në universitet. Ishte tundim që ta bënim pjesë të udhëheqjes, pasi ai tashmë kishte pasur eksperiencë të madhe në shërbesë. Ai kishte qenë udhëheqës në grupin e tij të të rinjve, dhe të rinjtë e donin shumë. Ishte i talentuar në kitarë. Ishte tërheqës, i pashëm dhe djalë shumë i mirë. Si djalë pastori, ai dinte lloj-lloj shprehjesh të krishtera dhe vargje të Biblës të cilat i shërbenin shumë mirë.

E po, ato i shërbyen mirë derisa filluam të bënim një studim të thellë Bible. Po studionim Librin e Markut. Andrei ishte i mërzhitur. Ai i dinte të gjitha historitë për Jezusin dhe çdo sesion dukej si përsëritje. Por ai filloi të kishte një ndjesi të parehatshme dhe nuk e mbante vendi — Fryma e Shenjtë po punonte. Teksa po lexonim nga Marku 8, kapitull i cili tregon se si Jezusi e shëroi një të verbër me një prekje të dytë, Andrei papritur erdhi në vete nga të kuptuarit se, edhe pse kishte qenë afër Jezusit për shumë vjet, ai nuk mund ta “shihnte” Jezusin. Ashtu sikurse edhe i verbri në fillim i shihnte njerëzit “si pemë duke ecur” (vargu 24) dhe kishte nevojë për një prekje të dytë, kështu edhe Andrei, i cili kishte kaluar kaq shumë kohë në komunitetin e krishterë, nuk ishte një ndjekës i vërtetë i Krishtit.

Andrei u pendua për mëkatin, për më të ligun dhe më zemërngurtësuesin mëkat, për mëkatin më të vështirë për

t'u shkukur, mëkatin që Jezusi e dënoi më ashpër: krenarinë frymërore dhe arrogancën fetare. Kthimi i Andreit në besim është një nga kthimet më të mrekullueshme që kam parë ndonjëherë, pasi jeta e tij e mëparshme dukej shumë afër me të qenët një jetë e vërtetë e krishterë. Megjithatë, kur Andrei e vendosi gjithë besimin e tij në Jezusin, ndryshimi ishte i dukshëm. Ai e kishte të qartë ungjillin. Nëse më parë ishte thjesht ambicioz, tani kishte gëzim. Tani Andrei mund të shprehet qartë në lidhje me atë që i ndodhi atij.

Megjithatë, mendoni pak se çfarë mund të kishte ndodhur nëse komuniteti do ta kishte marrë ungjillin për të mirëqenë. Andrei do të ishte përfshirë në udhëheqje. Njerëzit përreth tij do të vazhdonin të hamendësonin se ai ishte i krishterë. Si jobesimtar ai do t'u jepte mësim fëmijëve në kishë dhe studentëve në bashkësi. Më e keqja është se Andrei do të kishte humbur në mëkatin e tij, ndërkohë që komuniteti e afirmonte besimin e tij.

Në kishat tona do të ketë gjithmonë njerëz që duken si besimtarë, dhe kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme që të vazhdojmë ta shpallim ungjillin. Pikërisht ata janë njerëzit që rezistojnë dhe thonë se sa e mërzitshme dhe përsëritje është që të flasim për ungjillin.

Kishte një kohë kur ankesa të tilla do të më kishin tunduar për t'i bërë edhe më interesante takimet e kishës sonë. Por tani, kur dikush më thotë se ungjilli është i mërzitshëm ose që duhet të kalojmë te mësimet më të përshtatshme, këtë e shoh si një tregues që më thotë se duhet të këmbëngul dhe të zbuloj se çfarë do të thotë ai person. Ka shumë njerëz që shtiren sikur besojnë. Ka edhe shumë më tepër të cilëve u është dhënë një

siguri e rreme që janë të krishterë, për shkak të mënyrës se si u rritën, për shkak se ishin të përfshirë në kishë ose për shkak se kishin standarde të larta morale. Duke e ditur këtë, nuk tundohem më që të bëj lëshime.

Do të flas fare hapur: mos hamendësoni më se të gjithë njerëzit në takimet tuaja të krishtera janë realisht të krishterë. Hamendësoni se aty *ka* jobesimtarë.

Kohët e fundit fola në një nga takimet në Seminarin Teologjik Baptist Jugor (Southern Baptist Theological Seminary). Ky është një seminar me një përkushtim të fortë ungjillor. E admiroj fort stafin administrativ dhe fakultetin. Kam besim se studentët e tyre janë thellësisht të përkushtuar ndaj shërbesës. Megjithatë, unë ende dëshiroja që ungjilli të ishte i qartë në mesazhin tim, edhe sikur të shërbente vetëm si model për ata që do të bëheshin pastorë, por edhe për ndonjë mik që mund të ishte i pranishëm. Singerisht, kam jetuar mjaft gjatë dhe kam parë shumë njerëz që ishin në shërbesë, të cilët ose janë rrëzuar, ose janë kthyer në besim, saqë mendoj se mes tyre kishte disa që shtireshin: studentë seminari të cilët, në fakt, nuk e njihnin Krishtin.

Çfarë mund të themi për fëmijët tanë? Shumë fëmijë e bëjnë lutjen e mëkatarit kur janë pesë vjeç, por kam parë se shumë nga po ata fëmijë kthehen te Krishti kur shkojnë në universitet. Kam qarë bashkë me shumë prindër, fëmijët e rritur të të cilëve janë larg besimit, edhe pse silleshin si të krishterë kur po rriteshin. Vazhdoni t'u flisni fëmijëve tuaj për ungjillin si në shtëpi, ashtu edhe në kishë.

Më herët vumë në dukje se ungjilli duhet të jetë i qartë në gjithçka që bëjmë si komunitete kishe, në mënyrë që anëtarët

UNGJILLËZIMI

të mund të pajisen për të shpallur ungjillin. Mirëpo ungjilli duhet të jetë gjithashtu i pranishëm në gjithçka që bëjmë, në mënyrë që jobesimtarët të mund të kthehen në besim në Krishtin.

Prandaj, ne e shpallim ungjillin në këngët tona. U kush-tojmë shumë vëmendje fjalëve, për t'u siguruar që ato shpallin të vërtetat për Jezusin. Njoh një grua në kishën tonë e cila, në fakt, u kthye në besim teksa po këndonte një këngë për veprën shpenguese të Krishtit.

Ne e shpallim ungjillin në lutjet tona. Edhe kur lutemi para vakteve, ne mund ta pranojmë këtë gjë, që, edhe pse jemi mirënjohës për forcën fizike, jemi edhe më tepër mirënjohës për ushqimin që marrin shpirtrat tanë përmes ungjillit.

Ne e predikojmë ungjillin. Ne tashmë e kemi përmendur se predikimet kanë nevojë që ta përfshijnë ungjillin dhe se kemi nevojë që të shohim nëse dikush mund të kthehet në besim duke dëgjuar predikimin. Por a inkurajohen njerëzit që të flasin për predikimin pas shërbesës nëse kanë pyetje? Isha në një takim familjar ku babai tha: “Dakord, dua që të gjithë të më thoni një gjë që ju inkurajoi nga predikimi i sotëm.” Kemi nevojë për më tepër diskutime të tilla.

Kërkojeni ungjillin në studimet tuaja të Biblës. Gjendet aty në tekst. Besojini Jezusit kur ai thotë se i gjithë Shkrimi dëshmon për të (Luka 24:27). Mos hamendësoni kurrë se të gjithë e dinë lajmin e mirë të Jezu Krishtit. Shumë njerëz po hyjnë dhe po dalin nga kishat pa e dëgjuar ungjillin. Le të mos rrezikojmë në këtë pikë.

4. UNGJILLËZIMI SI DISIPLINË

Disiplinat frymërore si lutja, studimi i Biblës, takimet si komunitet i kishës, janë mjete të hirit në jetën tonë.

Të krishterët që i mësojnë këto parime qysh herët në ecjen e tyre me Krishtin, rriten në besim. Perëndia i përdor disiplinat frymërore për shëndetin tonë frymëror. Kur i praktikojmë ato, ne rritemi. Kur nuk i praktikojmë ato, jetët tona të krishtera bëhen të çrregullta.

Por a e keni menduar ndonjëherë ungjillëzimin si një disiplinë frymërore?

Don Whitney ka shkruar një libër të shkëlqyer në lidhje me disiplinat frymërore. Ai më tha se ky është libri i vetëm që ai njeh dhe që thotë specifikisht se ungjillëzimi duhet të trajtohet si një disiplinë frymërore. Ja se çfarë shkruan ai:

Ungjillëzimi është rezultati i natyrshëm i jetës së krishterë. Të gjithë duhet të jemi në gjendje të flasim për atë që Zoti ka bërë për ne dhe për rëndësinë që Ai ka për ne. Mirëpo ungjillëzimi është gjithashtu një *Disiplinë* për faktin që duhet ta disiplinojmë veten për të hyrë në kontekstin e tij, domethënë, nuk duhet që thjesht të presim që mundësitë për të dëshmuar të ndodhin.

Te Mateu 5:16, Jezusi tha: “Kështu *duhet* të rrezatojë drita juaj përpara njerëzve, me qëllim që të shikojnë veprat tuaja të mira dhe të lëvdojnë Atin tuaj që *është* në qiej.” Ta “lësh” dritën tënde të shkëlqejë përpara njerëzve, do të thotë shumë më tepër se thjesht “Mos bëj asgjë që e pengon dritën tënde të shkëlqejë”. Mendoje nxitjen e Tij kështu: “Le të shkëlqejë në jetën tënde drita e veprave të mira, le të shkëlqejë prej teje prova e ndryshimit, gjë që e nderon Perëndinë. Lëre të fillojë të shkëlqejë! Krijohapësirë për këtë gjë.”¹

UNGJILLËZIMI

Më pas Whitney thotë: “Nëse nuk e disiplinojmë veten për ungjillëzim, është shumë e lehtë që ta justifikojmë veten për faktin që kurrë nuk ia shpallim ungjillin dikujt.”² Whitney beson se qëllimi i disiplinimit të vetes sonë për ungjillëzim është që të planifikojmë për këtë gjë — në mënyrë që të krishterët ta përfshijnë realisht ungjillëzimin në agjendën e tyre.

Perëndia i përdor disiplina të tilla. Ndoshta jo herën e parë që na del një mundësi për të dëshmuar, por ndërkohë që e disiplinojmë vazhdimisht veten tonë, vjen një ditë kur e gjejmë veten në një diskutim ngazëllues për Jezusin me një jobesimtar, ku po flasim për fuqinë e tij shpëtuese dhe për atë që ai mund të bëjë për ata që me të vërtetë dëshirojnë ta njohin atë dhe faljen e tij.

5. VENDI I LUTJES

Më pëlqen shumë citati që i atribuohet Charles H. Spurgeon-it: “Zot, shpëto të zgjedhurit dhe zgjidh edhe disa të tjerë!”. Më pëlqen shumë kjo lutje dhe ky qëndrim. Lutja që të tjerët të shpëtohen, na mban të vetëdijshëm për këtë gjë.

U luta për motrën time, Lindën, për njëzet vjet, dhe pothuajse sa nuk u dorëzova. Mirëpo Perëndia, në mëshirën e tij, e tërhoqi atë pranë vetes. Kjo gjë më jep shpresë që edhe anëtarët e tjerë të familjes dhe miqtë për të cilët jam lutur për shumë vjet, ende mund të kthehen në besim.

Unë lutem rregullisht: “Zot, mos lejo që të kalojë asnjë vit kur unë të mos jem i përfshirë drejtpërdrejt në të parët e dikujt që kthehet në besim.” Perëndia ka qenë besnik ndaj asaj lutjeje. Nëse Perëndia do të më japë më tepër vite mbi tokë, kur

të shkoj në qiell mund të ketë pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë njerëz në jetët e të cilëve pata një rol të rëndësishëm për t'i parë të ktheheshin në besim. Sa gëzim i madh që do të jetë ky!

Bëjeni disiplinën tuaj që të luteni rregullisht për ata që nuk e njohin Krishtin, që të kthehen në besim dhe ta njohin atë. Lutuni në takimet e kishës, në grupet e vogla, në takimet nëpër shtëpi, në takime të veçanta dhe si pjesë të kohës suaj të përkushtimit. Kam një shok që thotë se përpiqet të bëjë lutje si ato të puritanëve, lutje të cilave “Perëndia nuk heziton t’u përgjigjet”. Tregojuni njerëzve përreth jush se Perëndia është dëshmitar që e keni në zemër shpëtimin e të humburve.

6. UDHËHEQJA FRYMËRORE

Një nga elementet kyç të një kulture ungjillëzimi është udhëheqja e kishës ose bashkësisë. Nëse është e rëndësishme që anëtarët të jenë “të përfshirë”, është dyfish e rëndësishme që pleqtë dhe pastorët të udhëheqin duke dhënë mësim dhe duke e modeluar ungjillëzimin.

Dave-i, pastori im, jeton në një apartament në një ndërtesë të lartë afër një qendre tregtare. Ai u flet me emër rojeve të sigurisë dhe stafit të mirëmbajtjes. Ai i ka takuar të gjithë arkëtarët në dyqanin ushqimor dhe të gjithë kamerierët në restorantin “Tex-Mex” (që është i preferuari i tij). Ai i qeth flokët shpesh, në mënyrë që të ketë mundësi për të kultivuar një marrëdhënie me berberin e tij.

Dave-i është një burrë miqësor, por thjesht miqësia nuk është motivi i tij parësor në gjithë këto kontakte. Ai është i motivuar nga shqetësimi i tij për këta njerëz dhe nga një dëshirë për të folur me ta për ungjillin, gjë që e bën shpesh. Ai më

UNGJILLËZIMI

prezanton rregullisht me njerëz nga kompleksi i tij i apartamenteve, të cilët vijnë bashkë me të në kishë dhe e dëgjojnë të predikojë. Pastaj të dy kemi mundësi për t'u folur atyre për ungjillin. Gjithmonë jam i inkurajuar pas këtyre bisedave për ta shpallur besimin tim.

Përveç mësimit dhe modelimit, një nga gjërat më të rëndësishme që mund të bëjnë udhëheqësit është që thjesht të flasin për ungjillëzimin. Nëse je pastor, është e rëndësishme që në takimet e stafit dhe të pleqve të veçosh një pjesë kohe për të folur në lidhje me përpjekjet e tua personale për ta shpallur besimin tënd. Kërko mënyra për t'u lutur dhe për ta inkurajuar ungjillëzimin në takimet e tjera të udhëheqjes së kishës.

Po udhëhiqja një seminar mbi ungjillëzimin në një kishë. Pastori më pyeti se cila mendoja unë se ishte pjesa më e dobishme e trajnimit për njerëzit. Unë i thashë: "Thjesht të folurit për ungjillëzimin është gjëja më e dobishme."

Ai më pa çuditshëm.

"Jo", i thashë, "e kam me gjithë mend. Nuk ka të bëjë shumë me atë që them unë, pavarësisht se ajo është e rëndësishme. Fakti që ke kaluar kohë duke menduar për ungjillëzimin ka rëndësi. Inkurajimi i njerëzve që të veçojnë një gjysmë dite për t'u lutur për miqtë e tyre jobesimtarë dhe për të menduar se çfarë kanë nevojë të bëjnë për të ungjillëzuar, është shumë më i dobishëm se secila nga pikat që kam diskutuar unë. Fakti që ti si udhëheqës në këtë kishë e ke planifikuar këtë seminar, në njëfarë kuptimi, është deklarata më e rëndësishme."

Pastor Pete-i u kërkon rregullisht njerëzve të ndryshëm që të flasin për mundësitë ungjillëzuese që kanë pasur anëtarët në bashkësinë e tyre gjatë javës së kaluar. Kur njerëzit e kup-

tuan se kjo gjë do të ndodhte çdo javë, ata jo vetëm që filluan të vinin në takim gati për të folur për mënyrat se si Perëndia i kishte përdorur, por gjatë javës u bënë edhe më të ndjeshëm ndaj mundësive përreth tyre. Kjo është një mënyrë e thjeshtë për ta ruajtur përqendrimin tek ungjillëzimi.

Nëse ungjillëzimi duhet të jetë një çështje e rëndësishë parësore në kishat tona, kërkohet inkurajim konstant, trajnim i vazhdueshëm dhe udhëheqje e përqendruar dhe afatgjatë, si ajo që këta pastorë po sigurojnë në bashkësitë e tyre.

Në këtë kapitull kemi qenë duke parë përgatitjet e rëndësishme për ta shpallur besimin tonë. Këto janë shumë thelbësore. Mirëpo synimi nuk është që të jemi të përgatitur — synimi është që të përfshihemi në biseda me njerëzit e tjerë, biseda në të cilat të shqiptojmë vetë fjalët e jetës. Tema e kapitullit vijues janë idetë për të pasur biseda të tilla.

TA SHPALLIM REALISHT BESIMIN TONË

Disa vjet pasi u martuam, bleva një libër në lidhje me martesën. Ishte një libër të cilin duhej ta kisha lexuar para se të ishim martuar dhe sigurisht që më nevojitej edhe më herët në martesën tonë. Megjithatë, kur e mora për herë të parë, lexova pasqyrën e lëndës dhe shkova direkt te kapitulli që më interesonte.

Kapitulli fillonte me diçka të tillë: “Ky është kapitulli ku kanë shkuar direkt shumë prej jush, para se t’i lexonin kapitujt pararendës, mirëpo unë dëshiroj t’ju inkurajoj që t’ia nisni nga fillimi.” Autori më mbërtheu në vend.

Nga e dinte autori se do të shkoja menjëherë tek ai kapitull? Ky ishte kapitulli që fliste për seksin.

E pranoj se ai kapitull për seksin ishte më tërheqës se ky kapitull që flet se si ta shpallim realisht besimin tonë, por mendoj se ka shumë njerëz të cilët do të shkojnë direkt te ky kapitull, pa i lexuar kapitujt pararendës. Nëse jeni njëri prej tyre, e po, dakord. Nuk do t’ju them të ktheheni dhe të lexoni kapitujt e tjerë.

E vlerësoj faktin që dëshironi t’i futeni punës së dësh-

UNGJILLËZIMI

mimit për besimin. Besoj se jeni të aftë të përkufizoni ungjillëzimin, ungjillin dhe kthimin biblik në besim.

Ju e keni refuzuar ungjillëzimin pragmatik dhe përmes programeve, dhe e dalloni thirrjen bindëse për një kulturë ungjillëzimi. Ju e shihni kishën si planin madhështor të Perëndisë për ungjillëzimin dhe se kultivimi i një kulture ungjillëzimi në kontekstin e kishës është gjëja më e mirë që mund të bëjmë për shpalljen e ungjillit. Kam besim se e keni përgatitur veten për të qenë një ungjilltar i qëllimshëm, pasi e shihni ungjillëzimin si një disiplinë frymërore dhe jeni duke u lutur për miqtë tuaj që nuk e njohin Jezusin. Ju që jeni në udhëheqje, udhëhiqni edhe në ungjillëzim, duke dhënë mësim për të dhe duke e praktikuar vetë.

Kjo është e mrekullueshme. Sigurisht që nëse ndonjëra nga këto pika është koncept i ri për ju ose nëse jeni paksa të paqartë në mendjen tuaj, atëherë mund të jetë mirë që të nisni nga fillimi. Pavarësisht nga këto, kemi arritur te ky kapitull — kapitulli që na tregon se si të flasim realisht për Jezusin.

TË FLASËSH SI NJË AMBASADOR

Për mua nuk ka ndonjë udhëzim më të mirë për mënyrën se si të flasim për Jezusin, sesa shembulli i Palit për punën e ambasadorëve te II Korintasve 5:20-21:

Prandaj, *ne* jemi emisarë për Krishtin, si *të ishte* Perëndia duke bërë thirrje nëpërmjet nesh; *ju* përgjërohemi në këmbë të Krishtit: Pajtohuni *me* Perëndinë! Atë që nuk njihte mëkat, *Perëndia* e bëri mëkat për ne, me qëllim që ne të bëheshim drejtësi e Perëndisë në atë.

Pali na bën thirrje që të kujtojmë se cila është fuqia pas mesazhit: vetë Krishti. Na tregohet në lidhje me përgjegjësinë tonë të madhe për të qenë përfaqësues të mbretërisë së Perëndisë. Ne jemi ambasadorët e Krishtit. Jemi thirrur që t'i shohim njerëzit ndryshe — të heqim dorë nga pikëpamja njerëzore dhe e botës, dhe t'i njohim e t'i duam ata, duke kup-tuar se janë mëkatarë të humbur që kanë nevojë të pajtohen me Perëndinë.

Ne duhet ta kapim saktë mesazhin. Në fund të fundit, ambasadorët nuk janë të lirë ta ndryshojnë mesazhin; puna e tyre është që ta përcjellin mesazhin me vërtetësi. Po kështu edhe ne nuk duhet t'i shtojmë dhe as t'i heqim ndonjë gjë mesazhit të Krishtit. Ne duhet ta përcjellim mesazhin si duhet, në mënyrë që mëkatarët të mund të pajtohen me Perëndinë e shenjtë, Krijuesin e gjithësisë, atë që na zotëron ne dhe gjithë njerëzit rreth nesh. Pavarësisht nga fakti që mëkati ynë është i lig para tij, ai hapi një udhë shpëtimi, duke bërë që ai i cili nuk njihte mëkat, *të ishte mëkat* — domethënë, të merrte mbi vete mëkatin tonë — dhe të merrte dënimin e drejtë të Perëndisë në vendin tonë në kryq. Kjo ndodhi që, në Jezusin, ne të mund të bëhemi drejtësia e Perëndisë. Ne mund të ripërtërihemi në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë thjesht duke besuar në Krishtin, duke u penduar për mëkatin dhe duke u kthyer tek ai me besim. Ky është mesazhi që na është dhënë të shpallim.

Ne duhet ta shpallim mesazhin pavarësisht nga parehatia që mund të shkaktojë, përpjekjet që mund të kërkojë dhe turpi që duhet të durojmë. Ambasadorët *ekzistojnë* për të përcjellë mesazhe. Prandaj, ne thërrasim: “Pajtohuni me Perëndinë!”. Mund të mos ndihemi si përfaqësues të mbretërisë së

UNGJILLËZIMI

Perëndisë, por këta jemi realisht. Kështu shihemi në sferat frymërore dhe kjo është një e vërtetë e jashtëzakonshme.

Sigurisht, ne mund të jemi ambasadorë të mirë ose të këqij. Nëse po e lexoni këtë libër, hamendësoj se dëshironi që ta luani mirë këtë rol, prandaj le të mendojmë për disa mënyra se si mund të përmirësohemi në bërjen e asaj që jemi thirrur për të bërë.

AMBASADORËT DHE QASJA E TYRE: LE TË MENDOJMË PËR KTHIMET NË BESIM

Ja një letër që kam marrë, e cila më ka prekur zemrën. Ndërsa e lexoni, mendoni se si mund të ishit përgjigjur ju:

I dashur Mack,

Kam qenë duke u lutur për njëfarë kohe për Candice-ën — që të më jepen mundësi për t'ia shpallur ungjillin. Ja pak informacion: Candice-a ishte rritur si katolike, por aktualisht nuk shkon në ndonjë kishë. Ajo jeton një stil jete homoseksual në kontekstin e një familjeje me katër fëmijë. Fëmijët janë të partneres së saj, por ajo luan rolin parësor si kujdestarja e tyre. Nëna e Candice-ës vuan nga kanceri dhe jeton më shumë se një mijë e gjashtëqind kilometra larg saj. E kam njohur Candice-ën për më tepër se njëzet e pesë vjet dhe kam punuar për të gjatë dy viteve të fundit. Ajo e di se jam serioze në lidhje me besimin tim dhe, në përgjithësi, do të thosha se ajo më vlerëson shumë. I kam ofruar të lutem për të, gjë që ajo e vlerëson, dhe ajo madje më ka mbështetur financiarisht për të shkuar në udhëtime afat-shkurtra misionare.

Dje, teksa po më tregonte për vizitën te nëna e saj, u lëshua në të qara. Nuk e kam parë kurrë të qajë. Duke qenë se isha ulur përballë saj, në mendjen time po përpiqesha ta sillja ungjillin

në situatën e saj dhe të gjeja një mënyrë për t'i komunikuar diçka me vlerë të përrjetshme, por pa tingëlluar sikur më mungonte dhembshuria. Në fund, nuk arrita të thosha ndonjë gjë me vlerë për përrjetësinë. Thjesht u përpoqa ta bëja atë të ndihesh rehat për të qarë në praninë time dhe t'i pohoja faktin që kisha ndjeshmëri për situatën e saj. Mendoj se mund të kisha bërë diçka më mirë.

Ndërkohë që po reflektoja për atë situatë më vonë, do të doja t'i kisha thënë diçka të tillë: "Dhimbja që po ndien është normale në një botë të thyer dhe të sëmurë nga mëkati. Kjo botë është e thyer dhe nuk është ashtu siç do të jetë kur Perëndia t'i pajtojë të gjitha gjërat me veten e tij." Mendoj se hezitova t'ia thosha diçka të tillë, pasi nuk doja që ajo të hamendësonte, siç bëjnë shumica e njerëzve, se nga ana e tyre nuk kërkohet asgjë për t'u përfshirë në pajtimin e Perëndisë. A do kishte qenë mirë ta kisha thënë, pavarësisht nga meraku që kisha? A duhej t'i kisha thënë diçka tjetër?

Kim-i

Këto janë pyetje të vështira në një botë reale. Ja se si iu përgjigja unë:

E dashur Kim,

Si fillim, mendoj se, ta lejosh dikë të ndihet rehat për të qarë në praninë tënde, vlen shumë, por e kuptoj se si ndihesh — është ajo ndjesia që na thotë se kemi diçka shumë të çmuar për të ofruar dhe me një fuqi të madhe ngushëlluese, saqë, në mes të dhimbjes së zemrës, nëse mundemi t'i rrëzojmë të gjitha muret mbrojtëse që janë ngritur në zemrat e njerëzve kundër Krishtit, ata mund ta njohin atë që një ditë do t'ua fshijë të gjitha lotët. Si për t'i bërë gjërat më keq, ne e dimë se sa afër janë ata me të vërtetën — "E vërteta është në zemrën time dhe unë jam këtu përkrah teje" — por ata thjesht nuk mund ta shohin dot.

Le të flasim më shumë për Candice-ën: ndoshta Perëndia po i prish pengesat kundër Krishtit në zemrën e saj përmes dëshmisë sate. Sigurisht, nuk e di se çfarë po bën Fryma e Shenjtë, por ndoshta thjesht ngushëllimi i saj ishte gjëja më e mirë për t'u bërë në atë çast, në sërën e gjatë të gjërave të mira që ajo ka parë në ty.

Ajo që mendoj se duhet bërë tani, është një bisedë pasuese. A është e mundur që ta ftosh Candice-ën për një kafe dhe për të biseduar? Unë mund t'i thosha diçka të tillë: "Candice-a, dëshiroj që gjatë kafes të bisedoj me ty për gjërat frymërore; a do të të ofendonte kjo gjë?". Nga përvoja ime, kur u japim njerëzve sigurinë që e dimë se besimi mund të jetë ofendues, ata kanë prirjen për të qenë më të hapur.

Gjatë një kafeje ose një vakti, do t'i thosha atë që the ti (më pëlqen shumë mënyra se si e kishe formuluar): "Dhimbja që po ndien është normale në një botë të thyer dhe të sëmurë nga mëkati." Sigurisht që do të të inkurajoja t'ia thoshe këtë, por, në atë çast, sërish do t'i kërkoja leje për t'i treguar se si Perëndia e pajton botën e thyer me veten e tij: "Candice-a, a mund të më japësh leje për të të treguar se si mendoj unë se punon një Perëndi i dashur në botën e thyer?". Dhe pastaj thuaji: "Candice-a, lotët e tu më prekën thellë, dhe teksa kam qenë duke menduar për këtë gjë, nuk më vjen në mendje diçka tjetër më e rëndësishme sesa mesazhi i Krishtit për t'u ditur në situatën tënde"; ose "E di se feja mund të jetë shkak përçarjesh, por, Candice-a, për dy mijë vjet njerëzit kanë përjetuar se si mesazhi i Jezusit ka qenë çelësi për të kuptuar jetën dhe vdekjen, dhe dëshiroj të të tregoj për këtë"; ose, "Candice-a, ti e di se unë i besoj një Perëndie në një kryq, domethënë, në një Perëndi që u identifikua me vdekjen tonë. Kjo gjë lidhet aq shumë me situatën tënde, sa që dëshiroj të ta shpjegoj mesazhin e Jezusit" — diçka të tillë ose ndoshta një kombinim të gjithë sugjerimeve të mësipërme. Ti e di më mirë se si ta thuash në kontekstin tënd dhe

të Candice-ës, por synimi është që të japësh një prezantim të sinqertë të ungjillit, i cili të jetë plot me domethënie të përjetshme dhe ta ndihmojë atë për të njohur nevojën e saj më të madhe: të pendohet për mëkatin dhe të reagojë me besim.

Në njëfarë kuptimi, unë do të isha më i shqetësuar që nëna e saj të dëgjonte një prezantim të qartë të ungjillit, nëse nuk e ka dëgjuar tashmë, por tani po shkoj përtej asaj që më kërkove. Meqë ra fjala, libri *A është Perëndia kundër homoseksualëve? (Is God Anti-Gay?)* nga Sam Allberry mund të jetë i dobishëm nëse e lexon.

Vëllai yt,
Mack-u

Ky letërkëmbim zbulon disa nga parimet bazë sipas të cilave veproj në bisedat që bëj me njerëzit për besimin. Këtu përfshihen parimet e mëposhtme:

- Tregojini vetes hir kur e shpallni besimin. Kam vënë re se shpesh kam frikë nga ungjillëzimi, pasi ka shumë mënyra për ta bërë gabim. Unë mund ta kap gabim mesazhin. Mund të rri në heshtje kur duhet të flas. Mund të them gjëra për të cilat më vonë mendoj se ishin pa mend. Mirëpo është mirë që t'i kujtoni vetes se edhe gabimet mund t'ju ndihmojnë të bëheni ambasadorë më të mirë.
- Takojini njerëzit aty ku janë.
- Shihni për dyer të hapura. Një kulturë ungjillëzimi ndihmon shumë në këtë pikë. Kur anëtarët e kishës tregojnë për dyert e hapura që kanë parë rreth tyre, anëtarët e tjerë mund të dëgjojnë për mundësi në të cilat mund të përfshihen.
- Tregohuni të dhembshur dhe ruani një zemër të butë ndaj të tjerëve. Kini kujdes të mbani mend që edhe ju jeni një mëkatar. Përlësia e lartëson ungjillin.

UNGJILLËZIMI

- Mbani mend që ne kemi përgjigjet për pyetjet më të mëdha të jetës. Kjo është diçka të cilën mund ta ofrojmë. Kur realiteti i jetës i rrëzon pengesat që i mbajnë njerëzit larg Perëndisë, atje është vendi ku mund të ndriçoni dritën e ungjillit. Mos e vini dritën nën magje.
- Përqendrohuni te ndarja e njerëzve nga Perëndia, jo te të qenët i drejtë nga ana morale.
- Tregohuni të qëllimshëm në bisedat tuaja. Planifikoni atë që do të thoni. Kjo gjë ju ndihmon të thoni gjërat që janë të dobishme, dhe të mos i thoni gjërat e sikletshme ose ofenduese.
- Pranoni atë që e dimë dhe atë që nuk e dimë. Shprehja e Kim-it, një “botë e sëmurë nga mëkati”, pranon të vërtetën që shohim rreth nesh. I krishteri jeton mirë në atë mjedis, pasi ai ose ajo e di se si u bë kështu. Gjithashtu, më duket e dobishme t’u them njerëzve se nuk i di gjithmonë arsyet për atë që bën Perëndia, megjithatë i besoj atij si ai që ka kuptim në një botë të thyer.
- Është mirë (edhe pse jo e detyrueshme) të kërkonti leje për ta shpallur mesazhin e ungjillit.
- Bëni shumë pyetje. Jini dëgjues të mirë.
- Përfundimisht, nëse prisni të hasni ndonjë çështje të caktuar në jetën e një personi, është mirë të informoheni duke lexuar një libër ose duke folur me dikë që e njeh atë çështje.

AMBASADORËT DUHET TË JENËTË GUXIMSHËM DHE TË QARTË:

Nëse do të isha në burg për ungjillëzim, jam i sigurt që do t’u kërkoja miqve të mi të luteshin që Perëndia të “më nxirrte nga burgu!”. Mirëpo kërkesat e lutjeve të Palit, kur ishte në burg, ishin për guxim dhe qartësi në shpalljen e ungjillit (Efesianëve 6:19; Kolosianëve 4:3-4).

Opinionimi im është që guximi është elementi më i nevoj-

shëm i ungjillëzimit për komunitetin e krishterë, të paktën në Amerikën e Veriut. Ky është vendi ku mund të mësojmë nga vëllezërit dhe motrat tona që jetojnë në vende ku nuk ekziston liria fetare.

Iraniani i parë që kam njohur, ishte një djalë i quajtur Farshid, kur ai erdhi në shtëpinë tonë në Dubai për një takim studentësh. Ne u ulëm bashkë ndërkohë që Nisin-i mbajti një fjalim. Në dhomë kishte ndoshta tridhjetë studentë. Ndërsa Nisin-i po fliste, vura re se Farshid-i nuk ndihej rehat. Më në fund, ai u përkul nga unë dhe më tha: “Mack, ai është një folës shumë i mirë, por kur do të dalë tek ungjilli?”

Më në fund e kuptova përse nuk po e mbante më vendi. Farshid-i donte që ungjilli të ishte i qartë për studentët. “Mos u shqetëso, vëlla”, i thashë unë, “nuk kam parë kurrë që Nisin-i të mos e përcjellë mesazhin e jetës — do ta thotë.” Dhe kështu ndodhi: Nisin-i e shpalli historinë e mahnitshme që Krishti i shpëton mëkatarët. Teksa e bëri, Farshid-i u qetësua dhe sytë iu mbushën me lot. Kam zbuluar se ata që vijnë nga sfone ku shumë njerëz e urrejnë kryqin, kanë prirjen për ta dashur atë edhe më fort.

Vitin pasues hëngra një drekë me Farshid-in në Cape Town të Afrikës së Jugut, gjatë Kongresit të Lozanës. Ai tha se gjërat po bëheshin edhe më të vështira në Iran dhe se ai e dinte që nuk do të kalonte shumë kohë dhe do ta arrestonin — thjesht sepse po tregohej një dëshmitar i guximshëm dhe i qartë për ungjillin. Ai u largua nga bashkësia e sigurt në Cape Town për të shkuar në Teheran. Sa vëlla trim!

Ditën e Krishtlindjes Farshid-in e arrestuan; akuza ishte “tradhti kundër Shtetit Islamik të Iranit” ose, e thënë ndryshe,

për shkak se kishte qenë një dëshmitar besnik për Krishtin. Ai u dënua me gjashtë vjet burg. Gruaja dhe dy fëmijët e tij të vegjël u arratisën për të shkuar në një kamp refugjatësh, duke kaluar malet për në Turqi. Atë e kanë burgosur në burgun famëkeq “Evin” në Iran. Kur ka mundësi të dërgojë ndonjë letër nga burgu, Farshid-i u kërkon miqve të tij të luten që ai të tregohet i guximshëm dhe i qartë në shpalljen e ungjillit, dhe që të vazhdojë të gëzohet në Krishtin.

Shumica prej nesh nuk përballen me vështirësi të tilla për faktin se janë besnikë. Mirëpo Farshid-i e do Jezusin dhe ungjillin e tij. Sikurse Pali, ai i konsideron të *gjitha se janë humbje, për shkak të epërsisë së njohjes së Krishtit Jezus, Zotit tim* (Filipianëve 3:8). Prandaj, me guxim dhe qartësi, ai vazhdon t’u tregojë njerëzve përreth tij për shpëtimin që gjendet në Krishtin.

Merrni zemër nga historia e Farshid-it dhe jini të guximshëm dhe të qartë në shpalljen e ungjillit në vendin tuaj. Bibla na bën thirrje të kujtojmë ata që janë treguar guximtarë dhe besnikë, dhe të ndjekim shembullin e tyre.

AMBASADORËT DUHET TA PËRCJELLIN MESAZHIN DHE T’I BESOJNË KRISHTIT PËR REZULTATET:

Katër prej nesh u takuan në zonën e marrjes së bagazheve në aeroportin “O’Hare”. Kishim ardhur në Çikago për një takim të rëndësishëm biznesi. Në fakt, takimi kishte filluar shumë kohë para se ne të arrinim në hotelin tonë: ishim zhytur thellë në diskutim teksa i hipëm taksisë, shoferi i së cilës ishte Ibrahimimi.

Teksa po vlonte diskutimi mbi rrjedhojat e ndryshme të politikës, Ibrahimimi më tha: “E di çfarë? Kjo botë është e mahnit-

shme!”. I hodha një vështrim të shpejtë duke u përpjekur të ndiqja atë që po më thoshte.

“Allahu i ka krijuar të gjitha”, tha ai duke bërë një gjest me duart drejt qendrës së Çikagos, gjest ky që e bëri makinën të ndryshonte korsi. Unë pohova me kokë pa thënë asgjë dhe përbrenda më lindi dëshira që do të kishte qenë më mirë të isha ulur në ndenjësën e pasme.

“Mirëpo gjëja e mahnitshme në lidhje me Allahun është që ai e mban shënim çdo gjë që bëjmë.”

“Po, jam dakord”, i thashë unë, duke u përpjekur të dilja nga qëndrimi im që thoshte: “I di të gjitha këto.” “Jam i krishterë dhe besoj se Perëndia regjistron gjithçka.”

“E di cili është ndryshimi mes teje dhe meje?”, vazhdoi Ibrahim. Ndihesha i sigurt që kjo nuk ishte një pyetje e sinkertë.

“Ti beson se Jezusi ishte Perëndi”, vazhdoi ai, “ndërsa unë besoj se ai ishte thjesht profet.” Ibrahimit nuk i mungonte guximi si dëshmues mysliman.

“E vërtetë, Ibrahim”, ia ktheva unë. Kjo u duk sikur e inkurajoi, dhe ai filloi një monolog teologjik që zgjati pothuajse derisa arritëm te hoteli.

Mirëpo në vendmbërritjen tonë, Ibrahim ra në qetësi teksa unë po plotësoja të dhënat e kartës së kreditit. Më në fund, kisha mundësinë të flisja: “Të të them diçka, Ibrahim? Bie dakord që myslimanët dhe të krishterët besojnë se të gjitha mëkatet tona janë mbajtur shënim, por myslimani beson se mëkatet vihen në peshore bashkë me veprat e mira, kurse i krishteri beson se Jezusi i ofron faljen për mëkatin përmes besimit. Ky mendoj unë se është ndryshimi më i madh. Ja pse

e dua Jezusin: ai nuk i peshon mëkatet tona me veprat tona të mira; ai na i fal mëkatet, pasi ai vetë pagoi për to.”

Ibrahimi hodhi vështtrimin drejt tavanit të taksisë së tij. “Hëm”, tha ai. Pastaj më ndihmoi me valixhet e mia. Ndërsa ai i dha makinës për t’u larguar, po vrisja mendjen nëse fjalët e mia kishin arritur të depërtonin tek ai. A duhej t’i kisha dhënë një bakshish më të madh? Papritur, pashë që dritat e frenave të tij u ndezën, dhe ai e ktheu makinën. “Ndoshta fjalët e mia depërtuan tek ai!” mendova unë. “Them se ai do që të më pyesë për Jezusin — ose ndoshta për faljen!” U bëra gati që ta udhëhiqja këtë burrë te Krishti.

Por nuk ishte kjo, unë thjesht kisha harruar të merrja kartën e kreditit. Ibrahimi më buzëqeshi teksa ma zgjati atë nga dritarja e makinës. Jam i gëzuar që ai ishte një mysliman i mirë dhe i ndershëm. Mirëpo teksa po e shihja të largohej për herë të dytë, sërish e përjetova ndjesinë e njohur të dështimit për ta shpallur besimin tim. Dëshiroja të kisha thënë më shumë për ungjillin ose ndoshta ta kisha thënë në një mënyrë më të mirë.

Mirëpo, teksa mendoja për këtë gjë, e kuptova se çështja reale nuk ishte ajo që mund të kisha thënë. Ajo që unë thashë *realisht* ishte e vërtetë, dhe i besoj Perëndisë që ta përdorë — jo vetëm për Ibrahimin, por edhe për mua. Ai më do dhe i pëlqen fakti që unë bëra një përpjekje për të dëshmuar për besimin tim. Ai, në fakt, nuk e llogarit mëkatin tim — ose dështimet e mia dhe as përpjekjet e mia të sikletshme — kundër meje. Nëse ai zgjedh që ta thërrasë Ibrahimin në besim, kjo nuk do të ndodhë për shkak se unë e thashë gjithçka si duhet, por vetëm për shkak të hirit të tij.

M'u desh pak kohë që ta riktheja mendjen te takimi i biznesit, pasi po ngazëlloja për faljen dhe dashurinë e Perëndisë. Pasuria e Krishtit në jetën time m'u duk më reale, pasi e kisha shpallur besimin tim. Nuk e di nëse biseda që pata me Ibrahimin e ndryshoi atë, por sigurisht që ajo më kujtoi se çfarë ka me të vërtetë rëndësi: jeta në Jezusin është më e mirë se një takim për hartim politikash. Më kujtoi gjithashtu hirin e Perëndisë në jetën time. A e dija se isha i falur para se të flisja me Ibrahimin? Sigurisht. Por të folurit për hirin me dikë që në të vërtetë beson në drejtësinë me anë të veprave, e nguliti atë hir edhe më thellë në zemrën time. Kjo nuk është diçka që e di vetëm nga ana intelektuale. Lutem që një ditë Ibrahimimi të njohë të njëjtën shpresë dhe gëzim.

Për ne është mirë të kujtojmë që shpëtimi është një vepër e Frymës. Ne përpiqemi të tregohemi të matur, të guximshëm dhe të qartë në mënyrën se si u tregojmë të tjerëve për ungjillin, por është Perëndia ai që sjell rezultatet. Në këtë njohuri mund të prehemi të qetë.

AMBASADORËT NUK DUHET TË LIGËSHTOHEN:

Te II Korintasve 4:1, Pali thotë: “Për këtë arsye, meqenëse kemi këtë shërbim, siç morëm mëshirë nga Perëndia, nuk ligësohemi.” Ne kemi nevojë që t’ia kujtojmë vetes këtë gjë atëherë kur tundohemi të ndihemi sikur përpjekjet tona për të ungjillëzuar janë të kota.

Ndërkohë që po udhëtoja, unë takova Craig-un në aeroportin e Cincinnati-t. Craig-un e njihja nga kisha. Ai e identifikoi veten si jo i krishterë që po e eksploronte krishterimin, por nga vëzhgimi im nga distanca, ai dukej se ishte më tepër i

interesuar për komunitetin e kishës sesa për besimin. U duk si një rastësi e pazakontë që u takova me të, prandaj e ftova të uleshim bashkë.

Craig-u dukej si një violinist klasik: flokët e tij të gjata dhe të bardha i dilnin anash kokës si stili i Ajnshtajnit, dhe në atë çast i kishte ngulur sytë diku larg me një shprehje melankolike dhe lodhjeje. Ai më tha se kohët e fundit kishte humbur të ëmën nga një sëmundje e gjatë. Kjo ma konfirmoi ndjesinë që takimi ynë nuk ishte një aksident: Perëndia po punonte në jetën e Craig-ut, dhe unë u përgatita t'i flisja atij për Jezusin. “Kush e di”, mendova unë, “ndoshta kjo është koha e tij.”

Bëra gjërat që duhen bërë. Shpreha ngushëllimin tim për vdekjen e nënës së tij dhe e pyeta se si ishte ai vetë. Nuk e sforcova bisedën dhe, teksa dëgjoja, po lutesha duke pasur ndjesinë se koha jonë i kishte të gjithë treguesit e një takimi hyjnor. Por teksa nisa të pyesja për të kuptuar reagimin e Craig-ut ndaj Jezusit, ai i ngriti mburojat. Ai tha se ishte mirë dhe më falënderoi. Ishte një bisedë me mirësjellje dhe e pranueshme nga ana shoqërore, por në dukje e pafrytshme në nivelin frymëror.

Teksa e pashë të largohej, e pranova përbrenda se edhe unë ndihesha i lodhur. Isha i lodhur nga bisedat me njerëz të lodhur në lidhje me një thesar që atyre u nevojitej, por që ata dukej se nuk e donin. Isha i lodhur nga frikërat e mia qesharake prej refuzimit. Por, mbi të gjitha, isha me të vërtetë i lodhur nga ndjesia që nuk duhej të ndihesha ashtu; një ndjenjë kjo që ndonjëherë *më bënte të dëshiroja që të hiqja dorë nga shpallja e besimit tim.*

Para se kjo lodhje të më pushtonte krejtësisht, Perëndia më

drejtoi me hirin e tij te një varg në Letrën drejtuar Filemonit, të cilin nuk e kisha dalluar më parë: “...*dhe lutem që pjesëmarrja e besimit tënd të bëhet vepruese në njohjen e plotë të çdo të mire që është në ne për Krishtin*” (Filemonit 6).

Këtu Pali po mendon për shumë më tepër se ungjillëzimin, por jo për më pak se kaq. Mirëpo vini re se arsyeja nuk është as reagimi ynë dhe as efektshmëria jonë. Pali po thotë diçka të cilën rrallëherë e dëgjoj: që shpallja e besimit tonë është edhe për të mirën tonë, në mënyrë që të mund të kemi një njohje edhe më të plotë të të gjitha të mirave që kemi në Krishtin. Bibla thotë se mes gjithë arsyeve të mira për ta shpallur besimin tonë, njëra prej tyre është ajo që ndodh në ne. Mendoj se kjo është e rëndësishme jo vetëm për ne si të krishterë individualë, por edhe për të mirën e komunitetit.

Pjesë e lodhjes sime në ungjillëzim është përqendrimi i vazhdueshëm tek ajo që duhet të ndodhë te *të tjerët*. Kur kjo bëhet fokusi im dhe nuk duket se po ndodh diçka tjetër, unë ligësh tohem. Mirëpo të diturit që Perëndia punon në mua kur unë e shpall besimin në mënyrë aktive, më jep shpresë edhe atëherë kur askush nuk reagon pozitivisht ndaj përpjekjeve të mia.

Në fakt, unë jam i bindur se shpallja e besimit, pavarësisht nga reagimi, është çelësi i shëndetit frymëror për individin dhe për komunitetin. Po, sigurisht që dëshirojmë të jemi të efektshëm në dëshminë tonë. Po, shumë të krishterë bëjnë gjëra pa mend, të cilat e pengojnë mesazhin e ungjillit — dakord, *unë kam bërë* gjëra pa mend, të cilat e pengojnë ungjillin — dhe ne duhet të hedhim hapa për t’i ndryshuar ato gjëra. Por, nëse duam që ta kuptojmë edhe më thellë pasurinë e Krishtit, ende kemi nevojë që ta shpallim besimin tonë në mënyrë aktive.

Craig-u vazhdoi të vinte në takimet e kishës sonë të re pas takimit tonë në aeroport. Për disa muaj, ai u ul dhe dëgjoi dëshmi që përlëvdonin Perëndinë, si dhe prezantime të qarta të ungjillit pa treguar ndonjë reagim të dukshëm. Por një ditë, të dielën e parë që u ktheva në kishë pas një udhëtimi të gjatë, Craig-u më tronditi kur u çua dhe më tha se ishte kthyer te Krishti. Zemra ime u ngrit peshë kur e dëgjova Craig-un të tregonte se çfarë kishte bërë Perëndia në jetën e tij.

Craig-u na tha se kishin kaluar shumë muaj para se të kuptonte se dëshmitë që kishte dëgjuar, nuk ishin drama. Ai, në fakt, i kishte menduar ato si aktrime të ndodhive frymërore nga aktorë profesionistë. Fakti që njerëzit të tregonin se si e kishin kuptuar ungjillin në mënyra kaq të thella dhe intime, nuk ishte pjesë e përjetimit të Craig-ut. Megjithatë, me kalimin e kohës, Craig-u kuptoi se këta njerëz po flisnin për jetët *e tyre*.

“E po, ja ku jam unë”, tha ai, “duke qëndruar përpara jush dhe po ju tregoj se çfarë ndodhi që më sollti në besim... Tani e kuptoj ungjillin.” Ndoshta është thjesht imagjinata ime, por në zërin e Craig-ut nuk dëgjohej më tingulli i lodhjes. Ai më dukej ndryshe: plot me jetë.

Ndërsa Craig-u i tha kishës sonë atë të diel në mëngjes se si e kishte kuptuar atë që Jezusi kishte bërë për të, ndjeva se edhe lodhja ime u largua. Nuk e udhëhoqa unë Craig-un te Jezusi, mirëpo unë isha aktiv në shpalljen e besimit tim para tij; edhe unë pata një rol. Unë isha pjesë e një kishë që kishte një kulturë ungjillëzimi. Të paktën në këtë kohë, Perëndia më lejoi të shihja se ç’rol luajti pjesa ime e vogël.

Shumicën e kohës nuk e shohim këtë gjë; ne duhet t’i besojmë Perëndisë. Por kjo është një gjë *e mirë*. Perëndia po

punon përmes nesh ndërsa e shpallim besimin tonë — edhe nëse nuk e shohim këtë gjë këtu mbi tokë. Ndoshta ai punon përmes një kohe të shkurtër që e kalojmë në sallën e pritjes në restorant; ndoshta përmes një bisede të shkurtër në të cilën shpallim ungjillin brenda një minute ose ndoshta përmes një vëzhgimi teologjik në lidhje me faljen. Kushedi, ndoshta është diçka të cilën ju do ta bëni sot?

Prandaj, merrni zemër në mes të shkurajimit. Të jeni të bindur që Perëndia është duke punuar përmes jush dhe në ju. Atij mund t'i zini besë. Mos iu dorëzoni tundimit për të hequr dorë.

Pasi Craig-u e tregoi historinë e besimit të tij në kishë, disa jobesimtarë iu afruan atij për të folur më tepër për Jezusin. Craig-u u habit nga reagimi i tyre. Ai priste që njerëzit të mendonin se ai ishte i çmendur. Por më vonë ai na tha se gjëja për të cilën po mendonte vazhdimisht, ishte dëshira në zemrat e tyre, të cilën vetëm Jezusi mund ta përmbushte. “Nuk e di se si mund t’i bëni ballë”, tha ai, “ta shihni atë lloj nevojë në shpirtin e njerëzve.”

E di se çfarë do të thotë: ndonjëherë as unë nuk e di nëse mund ta përballoj. Në fakt, këtë nevojë e pashë te Craig-u dhe isha i tunduar që të hiqja dorë. Ndoshta ata njerëz të lodhur rreth jush ju bëjnë të vrisni mendjen nëse edhe ju mund ta përballoni. Ndoshta përpjekjet e pafrytshme për t’ia shpallur besimin tuaj një fqinji që e takoni ditë pas dite ose një shoferi taksie që e takoni një herë në jetë, ju kanë bërë të mendoni nëse vërtet ia vlen. Ndoshta në fshehtësi edhe ju jeni të tunduar që të dorëzoheni.

Merrni zemër. Ungjillëzimi është shumë më i madh nga

UNGJILLËZIMI

sa shohim ne. Mbani mend premtimin e Perëndisë: ai po ju jep një kuptim edhe më të plotë për gjërat e mira që kemi në Krishtin. Ai po ju jep sytë e tij për t'i parë njerëzit ashtu siç i sheh ai. Ai po ju ndihmon ta rrokni kuptimin e thellë të mesazhit që përcjellim dhe po ju ndihmon të mbështeteni tek ai për punën që ai po bën në jetët e njerëzve.

Këto janë arsye të mjaftueshme për të vazhduar me qëndrueshmëri, por gjërat bëhen edhe më mirë se kaq. Ndonjëherë Perëndia na lejon që t'i shohim njerëzit e lodhur të transformohen në njerëz të mbushur me dritë. Kjo është diçka e lavdishme, plot me mahnitje dhe shpresë.

SHTOJCË

NJË SHPJEGIM I UNGJILLIT

Perëndia ynë Krijues është i shenjtë, i drejtë dhe i dashur. Ne jemi populli i tij, i krijuar në shëmbëllimin e tij. Edhe pse dikur ishim në bashkësi me Perëndinë dhe e donim atë, tani jemi të ndarë prej tij. Kjo ndarje mes Perëndisë dhe popullit të tij filloi me një rebelim nga paraardhësit tanë. Në thelb, rebelimi ishte zgjedhja jonë për të mos i besuar Perëndisë dhe përpjekja për ta bërë veten tonë perëndi. Ai rebelim tradhtie dështoi, dhe gjykimi ishte vdekja e përjetshme. Fatkeqësisht, mëkati i rebelimit trashëgohet si mallkim nga një brez në tjetrin: të gjithë njerëzit trashëgojnë si mëkatin, ashtu edhe gjykimin. Natyra jonë mëkatore e bën të pamundur që ndonjëri nga ne ta fitojë vetë rrugën e rikthimit te Perëndia.

Megjithatë, edhe pse nuk jemi në gjendje ta blejmë apo ta fitojmë shpëtimin tonë, për t'u shpenguar nga mallkimi, Perëndia, në dashurinë e tij, siguroi një udhë shpëtimi për t'u kthyer në një marrëdhënie të dashur dhe me falje tek ai. E gjithë Bibla profetizon, regjistron dhe shpjegon ardhjen e një Shpëtimtari për ta bërë këtë, dhe ky është Jezusi, Biri i Perëndisë.

Jezusi, i cili ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri, jetoi në tokë si dikush që bënte mrekulli dhe mësonte udhët e Perëndisë. Ai jetoi një jetë të përsosur dhe u bë flijimi i përsos-

sur, për të na shpenguar nga mallkimi i mëkatit dhe vdekjes. Përmes vdekjes së tij në kryq, Jezusi pagoi dënimin për mëkatet tona. Ai u ngrit nga varri, e mposhti vdekjen dhe kështu vërtetoi se ajo që tha ishte e vërtetë. Përmes vdekjes së tij, ai bleu të drejtën për të na ofruar faljen e mëkateve, si dhe të drejtën që kushdo që kthehet tek ai, të bëhet fëmijë i Perëndisë.

Kushdo që e dëgjon këtë mesazh të lajmit të mirë dhe reagon ndaj Jezusit, nuk do të dëbohet. Jezusi na bën thirrje të kthehemi nga jeta jonë mosbesuese dhe nga mëkati që e shoqëron atë dhe që na skllavëron, dhe ta vendosim besimin tonë të plotë vetëm tek ai, që të na shpëtojë nga mallkimi. Prandaj, për t'u bërë ndjekës të Jezusit, ne ia ofrojmë jetën tonë atij me besim dhe përkushtohemi që ta ndjekim atë si Zotin e gjithë jetës sonë.

PËRKUFIZIME

- *Ungjillëzimi* — Dhënia mësim ose predikimi i ungjillit me synimin apo qëllimin për ta bindur dikë apo për ta kthyer në besim.
- *Ungjilli* — Mesazhi i gëzueshëm nga Perëndia që na çon në shpëtim.
- *Mesazhi nga Perëndia* — Shpjegimi se kush është Perëndia, gjendja serioze njerëzore në mëkat dhe humbje, vepra e Krishtit për shpëtimin tonë dhe reagimi që duhet të tregojnë njerëzit për të fituar një marrëdhënie të ripërtërirë me Perëndinë; e gjitha kjo përmbledhet në katër pjesët e përvijimit të ungjillit: Perëndia, Njeriu, Krishti dhe Reagimi.
- *Mëkati* — Një gjendje rebelimi kundër Perëndisë, e karakterizuar nga egoizmi dhe mosbesimi.
- *Mëkatet* — Simptomat dhe shprehjet e (gjendjes së) rebelimit dhe mosbesimit.

- *Pendimi* — Braktisja e jetës së mosbesimit.
- *Kthimi në besim* — Kalimi nga vdekja në jetë, nga faji në falje.
- *Besimi* — Besimi dhe mbështetja e plotë në Perëndinë dhe në hirin e tij shpëtues përmes Krishtit.

PASAZHE NGA SHKRIMI PËR PËRVIJIMIN E UNGJILLIT

Ekzistojnë vargje të Shkrimit të Shenjtë të cilat duhet t'i dini. Vargjet e mëposhtme sigurojnë faktet bazë për Perëndinë, Njeriun, Krishtin dhe Reagimin, si dhe për çmimin e ndjekjes së Jezusit:

Perëndia

- Isaia 6:1-3. Perëndia është i shenjtë.
- Kolosianëve 1:16-17; Psalmi 8:1-4. Perëndia është Krijuesi.
- Gjoni 3:16. Perëndia është i dashur.
- Romakëve 1:18. Perëndia është i zemëruar me mëkatin.

Njeriu

- Zanafilla 1:26-27. Ne jemi krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë.
- Romakëve 3:9-12. Ne të gjithë jemi mëkatarë.
- Efesianëve 2:1-3. Ne jemi të vdekur në shkeljet tona.
- Isaia 53:6. Ne jemi në rebelim kundër Perëndisë.
- Isaia 59:2. Ne jemi të ndarë nga Perëndia.
- Romakëve 6:23. Vdekja është dënimi për rebelimin tonë.

Krishti

- Gjoni 3:16. Jezusi është udha për te Perëndia.
- Romakëve 5:6-8. Jezusi vdiq për ne.
- Romakëve 6:23. Dhurata e jetës së përjetshme nga ana e Perëndisë është përmes Krishtit.
- Efesianëve 2:4-9. Perëndia na jep hir në Krishtin.

SHTOJCË

- Kolosianëve 1:19-23. Perëndia na pajton me veten në Krishtin.
- I e Pjetrit 2:22. Krishti jetoi një jetë të përsosur.
- I Korintasve 15:3-4. Krishti u ngjall prej të vdekurish.
- Gjoni 10:10. Krishti erdhi për të na dhënë jetë.

Reagimi

- Romakëve 10:9-11. Ne duhet të rrëfejme me gojën tonë dhe të besojmë në zemrën tonë.
- Mateu 4:17; Veprat 2:38. Ne duhet të pendohemi.
- Gjoni 8:12. Ne duhet ta ndjekim Jezusin.
- Gjoni 5:24-25. Ne duhet ta dëgjojmë fjalën e Jezusit.
- Gjoni 1:12. Ne duhet të besojmë në emrin e Jezusit.

Çmimi

- I e Pjetrit 1:18-19. Krishti na shpengoi me anë të gjakut të tij.
- Efesianëve 2:8-9. Perëndia na shpëtoi me anë të hirit të tij.
- Luka 9:23-24. Ne duhet ta mohojmë veten dhe ta marrim kryqin tonë.

SHËNIME

Kapitulli 1: Daljet para altarit dhe dritat e lazerit

1. J. I. Packer, *Ungjillëzimi dhe sovraniteti i Perëndisë* (Fondacioni ZGG-Albania, Tiranë, 2019).
2. Tim Keller, *Paul's Letter to the Galatians: Living in Line with the Truth of the Gospel* (New York: Redeemer Presbyterian Church, 2003), 2.
3. Fjala që normalisht përkthehet si “ungjill” në Besëlidhjen e Re, zakonisht përkthehet si “lajm i mirë” në Besëlidhjen e Vjetër (p.sh., Isaia 52:7).

Kapitulli 2: Një kulturë ungjillëzimi

1. Barna Group, “Evangelism Is Most Effective Among Kids”, 11 tetor 2004. <https://www.barna.org/barna-update/article/5-barna-update/196-evangelism-is-most-effective-among-kids#.UjmEo-AXd3g>.

Kapitulli 3: Lidhja e kishës me një kulturë ungjillëzimi

1. Rrjeti “Acts 29” është i përkushtuar ndaj mbjelljes së kishave. Emri i këtij rrjeti vjen nga fakti që Libri i Veprave të Apostujve në Besëlidhjen e Re ka njëzet e tetë kapituj. Prandaj, “Acts 29” (Veprat 29) mund të kuptohet si “kapitulli pasues” dhe i vazhdueshëm në historinë e kishës. http://en.wikipedia.org/wiki/Acts_29.
2. Për të mësuar më tepër rreth anëtarësisë së kishës shihni librin e Jonathan Leeman-it, *Anëtarësia e kishës: Si e kupton bota se kush e përfaqëson Jezusin* (IGNIS, Tiranë, 2026).
3. Ky libër është pjesë e një serie mbi doktrinat dhe praktikatat biblike që i ndihmojnë kishat të jenë të shëndetshme dhe jo të sëmura, të lulëzojnë në vend që thjesht të mbijetojnë. Ne kemi zgjedhur nëntë shenja të të cilat të përqendrohemi në veçanti, edhe pse mund të shtohen edhe shumë të tjera. “Shenja” e parë e një kishë të shëndetshme që

diskutojmë, është përshkrimi i punës parësore të pastorit: predikimi shtjellues, predikimi në të cilin pika kryesore e tekstit biblik është pika kryesore e predikimit. Predikimet që i trajtojnë librat e Biblës në mënyrë kronologjike, duhet të nxitin dhe duhet të mbështeten në një të kuptuar të integruar të të gjithë historisë dhe mesazhit të Shkrimit të Shenjtë. Prandaj, një shenjë e dytë është teologjia biblike. Mesazhi thelbësor i Shkrimit të Shenjtë, ungjilli, është ai që u jep jetë kishave tona, dhe atë duhet ta kuptojmë biblikisht. Kjo është shenja e tretë. Prej kësaj shenje rrjedhin kuptimi biblik për kthimin në besim dhe ungjillëzimin, shenja e katërt dhe e pestë. Sapo njerëzit kthehen në besim, ata duhet t'i shtohen kishës: këtu flasim për anëtarësinë e kishës. Ana tjetër e anëtarësisë është disiplina, pra, ajo që bën kisha kur anëtarët nuk po vazhdojnë të pendohen për mëkatin. Kështu që kemi arritur në shtatë shenja. Shenja e tetë është kuptimi biblik për rritjen dhe shenja e nëntë është udhëheqësia biblike e kishës.

Kapitulli 4: Ungjillëzimi i qëllimshëm në një kulturë ungjillëzimi

1. Donald S. Whitney, *Spiritual Disciplines for the Christian Life* (Colorado Springs: NavPress, 1991), 106.
2. Po aty, 108.

TREGUESI I SHKRIMEVE

Zanafilla

1:26-27 129

Gjyqtarët

21:25 74

Psalmet

8:1-4 129

96:2-3 54

Isaia

6:1-3 129

53:6 129

59:2 129

Ezekieli

33:30-32 53

Mateu

4:17 130

5:16 103

18:15-17 74

20:25-28 97

28:18-20 11, 76

28:19 57

Marku

6:34-44 31

8 99

8:24 99

Luka

9:10-17 31

9:23-24 130

24:27 102

Gjoni

1:1 30

1:12 130

3 38

3:1-8 76

3:16 129

5:24-25 130

8:12 130

10:10 130

13:34-35 76

13:35 67

17:20-21 67

Veprat e Apostujve

2 95

2:18 117

2:41 76

2:47 26

2:46-47 65

6 80

6:2-4 81

14:23 76

18:26 24

Romakëve

1:16 52

1:18 129

TREGUESI I SHKRIMEVE

3:9-12	129
5:6-8	129
6:23	129
10:9-11	130

I Korintasve

12:12-26	76
15:3-4	130

II Korintasve

4:1	121
4:1-2	26
4:2	26
5:11	38
5:11-15	26
5:14-15	51
5:16	54
5:17	56
5:20-21	110
10:4-5	63

Galatasve

1:6-7	29
2:5	96
2:11-14	95
2:14	89

Efesianëve

2:1-3	129
2:4-9	129
2:8-9	130
3:10	76
6:15	88
6:19	116

Filipianëve

1:3-5	57
1:7-8	43

1:12-13	63
1:13	64
1:17-18	24
1:27	97
2:19-22	61
3:8	118
4:22	60

Kolosianëve

1:3-4	62
1:7	62
1:16-17	129
1:19-23	130
3:13	97
3:16	76
4:3-4	116

I Timoteut

2:7	31
-----	----

II Timoteut

1:11	31
1:13	58
2:2	59
3:16-17	76

Filemonit

6	123
---	-----

Hebrenjve

4:14-16	93
10:24-25	76

I e Pjetrit

1:18-19	130
2:22	130
3:15	37, 58

IX 9Marks

Seria “Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme”

A ËSHTË KISHA JOTE E SHËNDETSHME?

9Marks ekziston për të pajisur udhëheqësit e kishave me një vizion biblik dhe me burime praktike, për ta shfaqur lavdinë e Perëndisë ndër kombe përmes kishave të shëndetshme.

Për këtë qëllim, ne duam t'i ndihmojmë kishat të rriten në nëntë shenjat e shëndetit, të cilat shpesh lihen pas dore:

1. Predikimi shtjellues
2. Doktrina e ungjillit
3. Një kuptim biblik i kthimit në besim dhe i ungjillëzimit
4. Anëtarësia biblike në kishë
5. Disiplina biblike në kishë
6. Interesimi biblik për dishepullimin dhe rritjen
7. Udhëheqësia biblike e kishës
8. Një kuptim biblik i praktikës së lutjes
9. Kuptimi dhe praktika biblike e misioneve

Në organizatën “9Marks”, ne shkruajmë artikuj, libra, vlerësime librash, si dhe një revistë “online”. Ne organizojmë konferenca, regjistrojmë intervista dhe prodhojmë materiale të tjera për t'i pajisur kishat që ta shfaqin lavdinë e Perëndisë.

Vizitoni faqen tonë të internetit për të gjetur materiale në më shumë se 60 gjuhë të ndryshme dhe për t'u abonuar për revistën tonë falas “online”. Shihni një listë të plotë të të gjitha faqeve tona në gjuhë të huaja në adresën: www.9marks.org/international/.

Shqip: al.9marks.org | Anglisht: 9marks.org

Kam dëshirë të dëgjoj nga ju:
mackstiles@gmail.com

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Stiles, J. Mack

Ungjillëzimi: si flet e gjithë kisha për Jezusin /
J. Mack Stile.

përkth. Asim Hamza ; red. Rudina Boçe-Le Clus.

- Tiranë : IGNIS, 2026.

138 f. ; 12,7 x 17,78 cm. - (Si të ndërtojmë
kisha të shëndetshme).

ISBN 9789928488374

1. Feja kristiane 2. Evangjelizmi

UNGJILLËZIMI ËSHTË SHUMË MË TEPËR SE NJË PROGRAM.

Çdo tre-katër vjet kishat përfshihen në programin më të ri ungjillëzues. Udhëheqësit administrojnë programin e ri dhe anëtarët hidhen në sulm. Por përfytyroni një kishë në të cilën ungjillëzimi është thjesht pjesë e kulturës së saj. Udhëheqësit e shpallin vazhdimisht dhe hapur besimin e tyre. Anëtarët ndjekin shembullin e tyre, duke e inkurajuar njëri-tjetrin që ta bëjnë ungjillëzimin stilin e vazhdueshëm të jetës.

Kjo është mënyra se si ungjillëzimi paraqitet nga ky libër i shkurtër dhe bindës. Këtu nuk ka programe. Përkundrazi, ky libër mund t'i japë kishës suaj një mënyrë të re për ta jetuar dhe për ta shpallur ungjillin së bashku.

“Libri më i mirë mbi ungjillëzimin do të ishte një libër që shkon drejt e në zemër të çështjes dhe që është shkruar nga dikush që është vetë ungjilltar. E thënë ndryshe, ky është ai libër.”

R. ALBERT MOHLER JR., president dhe profesor i teologjisë së krishterë në katedrën “Joseph Emerson Brown”, The Southern Baptist Theological Seminary

“Jam vërtet i ngazëlluar për këtë libër. Librat e Mack Stiles-it për ungjillëzimin janë të shkëlqyer, pasi ata ndërthurin ndihmën praktike me pjekurinë teologjike. Ai, në fakt, e praktikon vetë atë që na mëson.”

KEVIN DEYOUNG, pastor kryesor, University Reformed Church, East Lansing, Michigan

“Ndryshe nga çdo libër tjetër, ky është një libër mbi ungjillëzimin që lartëson Krishtin dhe është i zhytur në ungjill. Në vend që t'ju japë një metodologji personale, ky libër ju motivon që, si bashkësi kishë, të shpallni lajmin revolucionar të Jezusit dhe të jepni frytin e tij në jetën tuaj.”

RICHARD CHIN, drejtor kombëtar, Australian Fellowship of Evangelical Students

J. MACK STILES është drejtori ekzekutiv i Gulf Digital Solutions dhe sekretar i përgjithshëm i Fellowship of Christian UAE Students (FOCUS) në Emiratet e Bashkuara Arabe. Përveçse ka punuar si kishëmbjellës për shumë vjet, ai tani shërben edhe si plak në kishën “Redeemer” në Dubai. Ai është autor i librave *Marks of the Messenger* dhe *Speaking of Jesus*.

*Ky vëllim është pjesë e serisë “9Marks: Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme”.